



DRAFT LIGJ

Nr. _____, date _____ 2025

PËR

**KONTROLLET ZYRTARE DHE AKTIVITETE TË TJERA ZYRTARE TË
KRYERA PËR TË GARANTUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT MBI
USHQIMIN DHE USHQIMIN PËR KAFSHË, RREGULLIMEVE MBI SHËNDETIN
DHE MIRËQENIEN E KAFSHËVE SI DHE MBI SHËNDETIN E BIMËVE DHE
PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE NË REPUBLIKËNSHQIPËRISË¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

TITULLI I

OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIMET

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

¹ This Ky ligj është përafuar pjesërisht me Rregulloren (BE) 2017/625 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 15 mars 2017 “Për kontrollet zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin e kafshëve, të normave mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e shëndetit të bimëve”, duke ndryshuar Rregulloret (KE) Nr. 999/2001, (KE) Nr. 396/2005, (KE) Nr. 1069/2009, (KE) Nr. 1107/2009, (BE) Nr. 1151/2012, (BE) Nr. 652/2014, (BE) 2016/429 dhe (BE) 2016/2031 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1/2005 dhe (KE) Nr. 1099/2009 dhe Direktivat e Këshillit 98/58/KE, 1999/74/KE, 2007/43/KE, 2008/119/KE dhe 2008/120/KE, dhe duke shfuqizuar Rregulloret (KE) Nr. 854/2004 dhe (KE) Nr. 882/2004 të Parlamenti Evropian dhe Këshillit, Direktivat e Këshillit 89/608/KEE, 89/662/KEE, 90/425/KEE, 91/496/KEE, 96/23/KE, 96/93/KE dhe 97/78/KE dhe Vendimi i Këshillit 92/438/KEE (Rregullorja e Kontrolleve Zyrtare), Numri CELEX 32017R0625, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L datë 07.04.2017, faqe 1-142;

Ky ligj përcakton rregullat e përgjithshme dhe të veçanta, parimet dhe kërkesat që lidhen me kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare, si dhe përcakton përgjegjësitë, financimin dhe procedurat për kryerjen e kontrolleve zyrtare për të garantuar një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve në Republikën e Shqipërisë

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj përcakton rregullat për:

- a) kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare nga autoritetet kompetente;
- b) financimin e kontrolleve zyrtare;
- c) miratimin dhe zbatimin e kushteve që duhet të përmbushin kafshët dhe mallrat që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ç) ngritjen e një sistemi informacioni të kompjuterizuar për të menaxhuar informacionin dhe të dhënat që i përkasin kontrolleve zyrtare;

2. Ky ligj zbatohet për kontrollet zyrtare që kryhen për verifikimin e përpuethshmërisë së rregullave në fushat e mëposhtme:

- a) ushqimit dhe sigurisë ushqimore, integritetit dhe cilësisë (shëndeti) në çdo fazë të prodhimit, përpunim dhe shpërndarjes së ushqimit, duke përfshirë rregullat që synojnë garantimin e praktikave të ndershme tregtare, mbrojtjen e interesave dhe informimin e konsumatorit, si dhe prodhimit dhe përdorimit të materialeve dhe artikujve që janë të destinuara të vijnë në kontakt me ushqimin;
- b) lëshimit të qëllimshëm në mjedis të Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ) me qëllim prodhimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë;
- c) ushqimit për kafshë dhe sigurisë së ushqimeve për kafshë në çdo fazë të prodhimit, përpunimit e shpërndarjes dhe të përdorimit të ushqimit për kafshë, duke përfshirë rregullat që synojnë garantimin e praktikave të ndershme tregtare dhe mbrojtjen e shëndetit, interesave dhe informimin e konsumatorit;
- ç) kërkesave për shëndetin e kafshëve;
- d) parandalimit dhe minimizimin e risqeve shëndetësore, për njerëzit dhe kafshët, që rrjedhin nga nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor dhe produktet e prejardhura prej tyre;
- dh) kërkesave për mirëqenien e kafshëve;
- e) masave mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve;
- ë) kërkesave për vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve, me përjashtim të pajisjeve për aplikimin e pesticideve;
- f) prodhimit organik dhe etiketimin e produkteve organike;

g) përdorimit dhe etiketimit të emërtimeve të mbrojtura të origjinës, treguesve gjeografikë të mbrojtur dhe specialiteteve tradicionale të garantuara

3. Ky ligj zbatohet edhe për kontrollet zyrtare të kryera për verifikimin e përpuethshmërisë së kërkesave të përcaktuara në rregullat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, për kafshët dhe mallrat që hyjnë ose eksportohen nga territori i Republika e Shqipërisë.

4. Ky ligj nuk zbatohet për kontrollet zyrtare të kryera për verifikimin e përputhshmërisë me:

a) legjislacionin për organizimin e tregut të produkteve bujqësore, përveç rasteve kur ato kontrole identifikojnë praktika të mundshme manipuluese ose mashtruese në lidhje me standardet e marketingut të referuara në legjislacionin për organizimin e tregut të produkteve bujqësore;

b) legjislacionin për mbrojtjen e kafshëve të përdorura për qëllime shkencore;

c) legjislacionin për produktet mjeksore veterinarë.

5. Nenet 4, 5, 6, 8, neni 12 pika 2 dhe 3, nenet 15, 16 deri 25, 29 deri 32, 35 deri 40 dhe 73, nenet 81 deri 101, pika (b) e nenit 92, neni 102 dhe nenet 103 deri në 112 zbatohen edhe për aktivitete të tjera zyrtare të kryera nga autoritetet kompetente në përputhje me këtë ligj ose me rregullat e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Auditim” nënkupton një kontroll sistematik dhe të pavarur për të përcaktuar nëse aktivitetet dhe rezultatet e këtyre aktiviteteve përputhen me marrëveshjet e planifikuara dhe nëse këto marrëveshje zbatohen në mënyrë efektive dhe janë të përshtatshme për të arritur objekt
2. “Autoriteti i kontrollit organik” nënkupton një institucion publik përgjegjës për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, të cilit ministria përgjegjëse për bujqësinë i ka caktuar tërësisht ose pjesërisht kompetencat e tyre në lidhje me zbatimin e legjislacionit për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, autoritetin përkatës të një shteti tjetër ose që vepron në një shtet tjetër;
3. Aktivitete të tjera zyrtare” nënkupton aktivitetet, përveç kontrolleve zyrtare, të cilat kryhen nga institucionet përgjegjëse, ose nga organet e autorizuar ose personat fizikë të cilëve u janë caktuar disa aktivitete të tjera zyrtare në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin e përmendur, në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, duke përfshirë aktivitetet që synojnë verifikimin e pranisë së sëmundjeve të kafshëve ose dëmtuesve të bimëve, parandalimin ose frenimin e përhapjes së këtyre sëmundjeve të kafshëve ose dëmtuesve të bimëve, çrrënjosjen e këtyre sëmundjeve të kafshëve

- ose dëmtuesve të bimëve, dhënien e autorizimeve ose miratimeve, dhe lëshimin e certifikatave zyrtare ose vërtetimeve zyrtare;
4. “autoritete kompetente” përfshijnë:
 - a) autoritetin kompetent qendrorë për organizimin e kontrolleve zyrtare dhe veprimtarive të tjera zyrtare, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e përmendura në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji;
 - b) çdo autoritet kompetent tjetër të cilit i është dhënë kjo përgjegjësi;
 - c) autoritetet kompetente përkatëse të shteteve të tjera.
 5. “Bimë” nënkupton bimën e gjallë dhe pjesë të veçanta të gjalla të bimës që përfshin:
 - a) farat, në kuptimin botanik, përveç atyre që nuk janë të destinuara për mbjellje;
 - b) frutat, në kuptimin botanik;
 - c) perimet;
 - ç) tuberët, zhardhokët, bulbet, rizomat, rrënjët, nënshartesat, stolonet;
 - d) lastarët, trungjet, kërcejtë;
 - dh) lule të prera;
 - e) degë me ose pa gjethe;
 - ë) pemë të prera që mbajnë gjethe;
 - f) gjethet;
 - g) kulturat e indeve bimore, duke përfshirë kulturat qelizore, germplazmët, meristemmat, klonet nga organizmat kimerë, materiale të vogla shumëzues;
 - gj) polenet e gjalla dhe sporet;
 - h) sythat, sythat drunorë, kalemata, shermendet, shartimet;
 6. “Çertifikatë zyrtare” është një dokument në formatin letër ose elektronik i nënshkruar nga zyrtari certifikues dhe që garanton përmbushjen e një ose më shumë kërkesave të përcaktuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.
 7. “Çertifikim zyrtar” është procedura me të cilën garantohet përpunueshmëria në lidhje me një ose më shumë kërkesa të përcaktuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.
 8. “Dëmtuesit e bimëve” është kërpudha, bakteri, virusi, insekti, nematoda, fitoplazma, bima e dëmshme, si dhe çdo organizëm tjetër i dëmshëm ose potencialisht i dëmshëm për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera;
 9. “Hyrja ose Futja në territorin e Republikës së Shqipërisë” nënkupton veprimin e sjelljes së kafshëve dhe mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë nga jashtë territorit të saj;
 10. “Inspektim para therjes” nënkupton verifikimin, përpara aktivitetit të therjes, të kërkesave për shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe mirëqenien e kafshëve, duke përfshirë, sipas rastit, ekzaminimin klinik të çdo kafshe individualisht dhe verifikimin e informacionit të zinxhirit ushqimor në lidhje me të gjitha kafshët, përveç kafshëve të egra të gjahut, të dërguara ose të destinuara për t'u dërguar në thertore siç përmendet në legjislacionin përkatës;
 11. “Inspektim pas therjes” nënkupton verifikimin në thertore ose në stabilimentin e trajtimit të kafshëve të gjahut, të përputhjes me kërkesat e aplikueshme për:

- a) karkasat siç përcaktohet në legjislacionin për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, për të përcaktuar nëse mishi është i përshtatshëm për konsum njerëzor;
 - b) heqjen e sigurt të materialit të rrezikshëm të specifikuar, dhe
 - c) shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve
12. Kafshët” nënkupton kafshët kurrizore dhe jovertebrore;
 13. “Kontroll zyrtar” nënkupton aktivitetet e kryera nga institucionet përgjegjëse, trupat e deleguara ose personat fizikë të cilëve u janë caktuar detyra të caktuara që i përkasin kontrollit zyrtar në përputhje me këtë ligj, me qëllim verifikimin:
 - a) e respektimit nga operatorët të këtij ligji dhe të legjislacionit të përmendur në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji; dhe
 - b) kafshët ose mallrat plotësojnë kërkesat e përcaktuara në legjislacionin e përmendur në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, duke përfshirë edhe lëshimin e një certificate zyrtare ose vërtetimi zyrtar;
 14. “Kontroll fizik” nënkupton një kontroll mbi kafshët ose mallrat dhe, sipas rastit, mund të përfshijë kontrollet e ambalazheve, mjetet e transportit, etiketave dhe temperaturës, marrjen e mostrave për analizë, testim ose diagnostikim dhe çdo kontroll tjetër të nevojshëm për të verifikuar përputhjen me rregullat e pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji.
 15. “Kontroll i dokumentacionit” është ekzaminimi i certificateve zyrtare, vërtetimeve zyrtare dhe dokumenteve të tjera, përfshirë dokumente të karakterit tregtar, të cilat kërkojnë të shoqërojnë ngarkesën, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, duke paraqitur informacionin e nevojshëm për identifikimin e menjëhershëm dhe të plotë të ngarkesës dhe destinacionit të saj.
 16. “Kontroll i identitetit” nënkupton një inspektim vizual për të verifikuar se përmbajtja dhe etiketimi i një ngarkese, duke përfshirë shenjat e identifikimit të kafshëve, vulat dhe mjetet e transportit, korrespondojnë me informacionin e dhënë në certificatet zyrtare, vërtetimet zyrtare dhe dokumentet e tjera që e shoqërojnë atë.
 17. “Kontroll nga autoritetet doganore” nënkupton kontrollet doganore të përcaktuara në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.
 18. “Legjislacioni i ushqimit” përfshin legjislacionin që rregullon fushën e ushqimit në përgjithësi, dhe sigurinë ushqimore në veçanti, që përfshin çdo fazë të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit, si dhe të ushqimit të prodhuar për kafshë, ose që përdoret për të ushqyer kafshët që prodhojnë ushqim;
 19. “Legjislacioni për ushqimin për kafshë” përfshin legjislacionin që rregullon fushën e ushqimit për kafshët në përgjithësi dhe sigurinë e ushqimit për kafshë në veçanti, në çdo fazë të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes ose përdorimit të ushqimit për kafshë;
 20. “Mallra” nënkupton gjithçka që i nënshtrohet një ose më shumë legjislacioneve të referuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, me përjashtim të kafshëve;
 21. “Materiali riprodhues” nënkupton:
 - a) spermën, ovocitet dhe embrionet që përdoren për riprodhim artificial;

b) vezët për çelje;

22. “Material i rrezikshëm i specifikuar” nënkupton indet e përcaktuara në legjislacionin për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e disa encefalopative spongiforme të transmetueshme, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe. Ai nuk përfshin produktet që përmbajnë ose rrjedhin nga këto inde;
23. “Mbikëqyrja nga autoriteti doganor” nënkupton mbikëqyrjen doganore të përcaktuar në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë
24. “Ministër” nënkupton ministrin përgjegjës për çështjet e bujqësisë.
25. “Ministria” nënkupton ministrinë përgjegjëse për çështjet e bujqësisë.
26. “Mishi dhe të brendshmet e mishit të ngrënë”, për qëllim të kontrolleve fizike në pikat e kontrollit kufitar, nënkupton produktet e përfshira në nën-kapitujt 0201 deri 0208 të Kreut 2 të Seksionit I, të Pjesës II të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave
27. “Ngarkesë” nënkupton një numër kafshësh ose sasi mallrash të mbuluara nga e njëjta certifikatë zyrtare, vërtetim zyrtar ose ndonjë dokument tjetër, të transportuar nga i njëjti mjet transporti dhe që vjen nga i njëjti territor, dhe, me përjashtim të mallrave që janë subjekt i rregullave të përcaktuara në shkronjën e) të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji, të të njëjtit lloj, klase ose përshkrim;
28. “Nënprodukte me origjinë shtazore” nënkupton trupa të plotë ose pjesë të trupit të kafshëve, produkte me origjinë shtazore ose produkte të tjera të përfituara nga kafshët, që nuk janë të destinuara për konsum nga njerëzit, përfshirë ovocitet, embrionet dhe spermën;
29. “Ndihmës Zyrtar” nënkupton një përfaqësues të autoriteteve kompetente, të trajnuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji dhe i punësuar për kryerjen e detyrave të caktuara të kontrollit zyrtar ose detyrave të caktuara që lidhen me aktivitete të tjera zyrtare;
30. “Ndalimi zyrtar” nënkupton procedurën me të cilën autoritetet kompetente sigurojnë që kafshët dhe mallrat që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare të mos zhvendosen ose të manipulohen në pritje të një vendimi për destinacionin e tyre, duke përfshirë magazinimin në ruajtje nga operatorët në përputhje me udhëzimet dhe nën kontrollin e autoriteteve kompetente;
31. “Nën përgjegjësinë e veterinerit zyrtar” nënkupton se veterineri zyrtar ia ngarkon kryerjen e një veprimi një ndihmësi zyrtar;
32. “Nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar” nënkupton se një veprim kryhet nga një ndihmës zyrtar nën përgjegjësinë e veterinerit zyrtar dhe veterinari zyrtar është i pranishëm në objekt gjatë kohës së nevojshme për kryerjen e atij veprimi;
33. “Objekte të tjera” nënkupton çdo material ose objekt, përveç bimëve ose produkteve bimore, të aftë për të strehuar ose përhapur dëmtuesit, duke përfshirë tokën ose mjedisin e rritjes.
34. “Operator” nënkupton çdo person fizik ose juridik që i nënshtrohet një ose më shumë detyrimeve të parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.

35. “Pajisje për aplikimin e pesticideve” nënkupton çdo pajisje të destinuar posaçërisht për aplikimin e pesticideve, duke përfshirë aksesoret që janë thelbësorë për funksionimin efektiv të pajisjeve të tilla, të tilla si hundëzat, manometrat, filtrat, kulluesit dhe pajisjet e pastrimit të rezervuarëve.
36. “Plani i kontrollit” nënkupton një përshkrim të vendosur nga autoriteti kompetent që përmban informacion mbi strukturën dhe organizimin e sistemit të kontrollit zyrtar, funksionimin e tij dhe planifikimin e detajuar të kontrolleve zyrtare që kryhen në një periudhë kohore të caktuar, në secilën prej fushave që rregullohet nga legjislacioni i referuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.
37. “Pikë dalje” nënkupton një pikë kontrolli kufitar ose çdo vend tjetër të caktuar nga autoriteti kompetent qëndror, ku kafshët të transportuara largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar transportin e kafshëve që nuk kryhet në lidhje me një aktivitet ekonomik dhe për transportin e kafshëve drejtpërdrejt në ose nga klinikat veterinare, sipas këshillës së një veterineri.
38. “Pikë e kontrollit kufitar” nënkupton një vend dhe ambjentet që i përkasin atij, të përcaktuara nga autoriteti kompetent qëndror për kryerjen e kontrolleve zyrtare në pikën e kontrollit kufitar të mbërritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, për çdo ngarkesë të kategorive të kafshëve dhe mallrat që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare në pikat e kontrollit kufitar.
39. “Procedurat e verifikimit të kontrollit” nënkupton rregullat e vendosura dhe veprimet e kryera nga autoritetet kompetente për të siguruar që kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare janë të qëndrueshme dhe efektive.
40. “Produkte bimore” nënkupton materialin e papërpunuar me origjinë bimore dhe ato produkte të përpunuara që, nga natyra e tyre ose nga përpunimi i tyre, mund të krijojnë rrezik për përhapjen e dëmtuesve karantinorë. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, druri do të konsiderohet si produkt bimor vetëm nëse plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:
- a) ruan të gjithë ose një pjesë të sipërfaqes natyrore të rrumbullakët, me ose pa lëvore;
 - b) nuk e ka ruajtur sipërfaqen e tij natyrore të rrumbullakët për shkak të sharrimit, prerjes ose këputjes;
 - c) është në formën e ashklave, grimcave, tallashit, mbeturinave të drurit, copëzave ose skrapit dhe nuk i është nënshtruar përpunimit që përfshin përdorimin e ngjitësit, nxehtësisë apo presionit ose kombinimit të tyre për të prodhuar paleta, briketa, kompensatë ose dërrasa grimcash;
 - ç) përdoret ose synohet të përdoret si material paketimi, pavarësisht nëse është në përdorim apo jo për transportin e mallrave;
41. “Produkte për mbrojtjen e bimëve” nënkupton produktet, në formën në të cilën i furnizohen përdoruesit, të përbëra nga ose që përmbajnë lëndë vepruese, mbrojtëse ose sinergjike dhe të destinuara për një nga përdorimet e mëposhtme:

- a) për mbrojtjen e bimëve ose produkteve bimore kundër të gjithë organizmave të dëmshëm ose parandalimin e veprimit të këtyre organizmave, përveç kur qëllimi kryesor i këtyre produkteve konsiderohet të jetë për arsye higjienike dhe jo për mbrojtjen e bimëve ose produkteve bimore;
 - b) për të ndikuar në proceset jetësore të bimëve, të tilla si substanca që ndikojnë në rritjen e tyre, përveçse si lëndë ushqyese;
 - c) ruajtja e produkteve bimore, për aq sa këto substanca ose produkte nuk i nënshtrohen rregulloreve të veçanta për konservuesit;
 - d) ç) për shkatërrimin e bimëve të padëshiruara ose pjesëve të bimëve, me përjashtim të algave, përveç rasteve kur produktet aplikohen në tokë ose në ujë për të mbrojtur bimët;
 - e) për kontrollin ose parandalimin e rritjes së padëshiruar të bimëve, me përjashtim të algave, përveç rasteve kur produktet aplikohen në tokë ose në ujë për të mbrojtur bimët;
42. “Produkte të prejardhura” nënkupton produkte të përfituara nëpërmjet një ose me shumë trajtimeve, transformimeve ose fazave të përpunimit të nënprodukteve me origjinë shtazore;
43. “Regjistri i udhëtimit” është një dokument i vulosur dhe i nënshkruar, i përgatitur nga personi që planifikon një udhëtim të gjatë, që përbëhet nga seksionet mbi planifikimin, vendin e nisjes, vendin e destinacionit, deklaratën nga transportuesi dhe raportin e anomalive të mostrës.
44. “Risk” nënkupton mundësinë e një efekti të kundërt në shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose mjedisin dhe ashpërsia e këtij efekti, si rrjedhojë e prezencës së një rreziku.
45. “Rrezik” nënkupton çdo agjent ose gjendje me potencial për të pasur një efekt të kundërt në shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose mjedisin.
46. “Sëmundje e kafshëve” nënkupton shfaqjen e infeksioneve apo e infestimeve në kafshë, me ose pa shfaqje të shenjave klinike ose patologjike, të shkaktuara nga një ose më shumë agjentë patogjenë.
47. “Sistemi i kontrollit” nënkupton një sistem organizativ që përfshin autoritetet kompetente dhe burimet, strukturat, marrëveshjet dhe procedurat për të garantuar që kontrollet zyrtare kryhen në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e përcaktuara në nenet 16 – 25;.
48. “Shenjë identifikuese e shëndetit të kafshës” nënkupton shenjën e aplikuar pas kryerjes së kontrolleve zyrtare para dhe pas vdekjes dhe e cila dëshmon se mishi është i përshtatshëm për konsum njerëzor.
49. “Transit” është lëvizja nga një shtet i huaj në tjetrin, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore;

50. “Trupë e deleguar” nënkupton një person juridik të veçantë të cilit autoritetet kompetente i kanë caktuar detyra të caktuara të kontrollit zyrtar ose detyra të caktuara që lidhen me aktivitete të tjera zyrtare.
51. “Udhëtim i gjatë” nënkupton një udhëtim që zgjat mbi 8 orë, duke filluar nga momenti kur zhvendoset kafsha e parë e ngarkesës;
52. “Ushqim ose produkt ushqimor” nënkupton çdo substancë ose produkt të përpunuar, pjesërisht të përpunuar ose të papërpunuar, të përcaktuar, ose për ndonjë arsye parashikohet, të jetë i konsumueshëm për njerëz. Termi “ushqim” përfshin pijet, çamçakëzin dhe çdo substancë, duke përfshirë ujin, të bashkuar në mënyrë të qëllimshme në ushqim gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit. Ai përfshin ujin pas pikës së përpunueshmërisë me kriteret e cilësisë së ujit të pijshëm sipas legjislacionit në fuqi për cilësinë e ujit të pijshëm. Termi “ushqim” nuk përfshin:
- a) ushqimin për kafshë;
 - b) kafshët e gjalla, me përjashtim të rasteve kur janë përcaktuar për konsum njerëzor;
 - c) bimët dhe frutat, përpara korrijës ose vjeljes;
 - ç) produktet mjekësore;
 - d) produktet kozmetike;
 - dh) duhanin dhe cigaret;
 - e) substancat narkotike dhe psikotrope në kuptimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Droga Narkotike, 1961, dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara për Substancat Psikotrope, 1971;
 - ë) mbetjet dhe kontaminuesit;
 - f) pajisjet mjekësore.
53. “Ushqim për kafshë ose produkt ushqimor për kafshë” nënkupton çdo substancë ose produkt, përfshirë aditivët, qofshin të përpunuara, pjesërisht të përpunuara ose të papërpunuara, të përcaktuar për t'u përdorur për ushqimin nga goja të kafshëve.
54. “Veterinar zyrtar” nënkupton veterinerin e emëruar nga një autoritet kompetent, që është ose jo pjesë e stafit, i kualifikuar në mënyrë të përshtatshme për të kryer kontrole zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare në përputhje me këtë ligj dhe rregullat përkatëse të parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.
55. “Vërtetim zyrtar” nënkupton çdo etiketë, shenjë ose formë tjetër vërtetimi të lëshuar nga operatorët nën mbikëqyrje, nëpërmjet kontrolleve zyrtare të dedikuara të autoriteteve kompetente ose nga vetë autoritetet kompetente, dhe që garanton përputhshmërinë me një ose më shumë kërkesa të përcaktuara në këtë ligj ose në rregullat e referuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.
56. “Vlerësim” nënkupton një klasifikim të operatorëve bazuar në një vlerësim të përputhshmërisë së tyre me kriteret e vlerësimit.
57. “Zyrtar Çertifikues” nënkupton:
- a) çdo zyrtar i autoriteteve kompetente i autorizuar për të nënshkruar certifikatat zyrtare nga këto autoritete; ose

b) çdo person tjetër fizik që është i autorizuar nga autoritetet kompetente për të nënshkruar certifikatat zyrtare, në përputhje me pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.

58. “Zyrtar përgjegjës për shëndetin e bimëve” nënkupton një person të emëruar nga një autoritet kompetent, që është ose jo pjesë e stafit, i trajnuar në mënyrë të përshtatshme për të kryer kontrolle zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës të përcaktuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.

TITULLI II

KONTROLLET ZYRTARE DHE AKTIVITETET E TJERA ZYRTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

KREU I

Autoritetet Kompetente

Neni 4

Përcaktimi i Autoriteteve Kompetente

1. Për secilën nga fushat që rregullohen nga rregullat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, caktohen autoritetet kompetente për organizimin ose kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare, si më poshtë:

- a. autoriteti kompetent për kryerjen e kontrollit zyrtar është institucioni përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar, këtu e në vijim IPKZ;
- b. autoriteti kompetent për kryerjen e aktiviteteve të tjera është institucioni përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të tjera, këtu e në vijim IPAT;
- c. autoriteti kompetent për kryerjen e kontrollit zyrtar në pikat e kontrollit kufitar është institucioni përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar në pikat e kontrollit kufitar, këtu e në vijim IPKPKK.

2. Kur, për të njëjtën fushë, përgjegjësia për të organizuar ose kryer kontrolle zyrtare ose aktivitete të tjera zyrtare bie mbi më shumë se një autoritet kompetent, në nivel kombëtar, rajonal ose lokal, garantohet një koordinim efikas dhe efektiv ndërmjet të gjitha autoriteteve të përfshira si dhe qendrueshmëri dhe efektivitet në kontrollet zyrtare ose aktivitetet e tjera zyrtare në të gjithë territorin.

3. Autoritetet kompetente përgjegjëse për verifikimin e përputhshmërisë me rregullat e përmendura në shkronjën f) të pikës 2 të nenit 2 mund t’ë japin përgjegjësi të caktuara në lidhje me kontrollet zyrtare ose aktivitete të tjera zyrtare për një ose më shumë autoritete të kontrollit organik. Në raste të tilla, ata do t’i japin një numër kodi për secilin prej tyre.

4. Ministria është autoriteti kompetent qëndror i përcaktuar si autoriteti i vetëm përgjegjës për koordinimin e bashkëpunimit dhe kontakteve me Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera.
5. Detyrat e autoriteteve kompetente përcaktohen në ligjet sektoriale për fushat e përcaktuara në nenin 2 pika 2 e këtij ligji.
6. Kudo në ligj ku citohet “autoriteti kompetent” nënkupton të gjitha autoritetet kompetente të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, me përjashtim të IPKPIK.
7. Organizimi dhe funksionimi i autoriteteve kompetente të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Detyrime të përgjithshme në lidhje me autoritetet kompetente dhe autoritetet e kontrollit organik

1. Autoritetet kompetente dhe autoritetet e kontrollit organik:
 - a) ndjekin procedura ose rregulla për garantimin e efektivitetit dhe përshtatshmërisë së kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare;
 - b) ndjekin procedura ose rregulla për garantimin e paanshmërisë, cilësisë dhe konsistencës së kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare në të gjitha nivelet;
 - c) ndjekin procedura ose rregulla për të garantuar që personeli që kryen kontrolle zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare nuk paraqet asnjë konflikt interesi;
 - ç) disponojnë ose kanë akses në laboratore me kapacitet të përshtatshëm për kryerjen e analizave, testeve dhe diagnostikimeve;
 - d) disponojnë ose kanë akses me një numër të mjaftueshëm personeli të kualifikuar dhe me përvojë në mënyrë që kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare të mund të kryhen në mënyrë efikase dhe efektive;
 - dh) kanë ambjente dhe pajisje të përshtatshme dhe të mirëmbajtura për të garantuar që personeli kryen kontrolle zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare në mënyrë efikase dhe efektive;
 - e) kanë kompetencat ligjore për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare për të ndërmarrë veprimet e parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin e referuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji;
 - ë) ndjekin procedura ligjore për të garantuar që personeli të ketë akses në mjediset e operatorëve dhe dokumentet e mbajtura prej tyre, në mënyrë që të jenë në gjendje të përmbushin siç duhet detyrat e tyre;
 - f) disponojnë plane kontigjence dhe janë të përgatitur për t'i zbatuar këto plane në rast emergjence nëse nevojitet, në përputhje me pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.

g) ndjek rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit të parashikuara në ligjin 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", përveç kur parashikohet shprehimisht në këtë ligj.

2. Çdo emërim i një veterineri zyrtar bëhet me shkrim dhe përcakton kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare dhe detyrat për të cilat është kryer emërimi. Kërkesat e vendosura për personelin e autoriteteve kompetente që parashikohen në këtë ligj, si dhe kërkesën për shmangien nga çdo konflikt interesi, zbatohen për të gjithë veterinerët zyrtarë;

3. Çdo emërim i një zyrtari përgjegjës për shëndetin e bimëve bëhet me shkrim dhe përcakton kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare dhe detyrat për të cilat është kryer emërimi. Kërkesat e vendosura ndaj personelit të autoriteteve kompetente që parashikohen në këtë ligj, duke përfshirë kërkesën për shmangien nga çdo konflikt interesi, zbatohen për të gjithë zyrtarët e shëndetit të bimëve.

4. Personeli që kryen kontrole zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare:

a) ka trajnimin e duhur, për fushën e tij të kompetencës, për t'u mundësuar kryerjen e detyrave të tyre me kompetencë dhe të kryejë kontrole zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare në mënyrë të qëndrueshme;

b) është i përditësuar në fushën e tij të kompetencës dhe merr trajnime të rregullta shtesë sipas nevojës; dhe

c) trajnohet për çështjet e përcaktuara në kreun I të Shtojca I të këtij ligji dhe kur është e nevojshme, për detyrimet e autoriteteve kompetente që rrjedhin nga ky ligj;

Autoritetet kompetente, autoritetet e kontrollit organik dhe trupat e deleguara zhvillojnë dhe zbatojnë programe trajnimi me qëllim që të garantojnë që personeli që kryen kontrole zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të marrë trajnimin e parashikuar në shkronjat a), b) dhe c) të pikës 4 të këtij neni;

5. Kur, brenda shërbimeve të një autoriteti kompetent, më shumë se një njësi është kompetente në kryerjen e kontroleve zyrtare ose aktiviteteve të tjera zyrtare, titullari i autoritetit kompetent garanton koordinim dhe bashkëpunim efikas dhe efektiv ndërmjet këtyre njësive.

Neni 6

Auditimi i autoriteteve kompetente

1. Për të siguruar përputhshmërinë e tyre me këtë ligj, brenda tre viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, autoritetet kompetente kryejnë auditime të brendshme ose auditime per vetveten dhe marrin masat e nevojshme në varësi të rezultateve të këtyre auditimeve.

2. Auditimet e përcaktuara në pikën 1 i nënshtrohen një shqyrtimi të pavarur dhe kryhen në mënyrë transparente.

Neni 7

E drejta e ankimit

1. Çdo person gëzon të drejtën e ankimit, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, kundër vendimeve të marra nga autoritetet kompetente në përputhje me nenin 53, nenin 64 pika 3 dhe 6, nenin 65, të nenit 109 pika 3 gërma b) dhe nenit 110 pika 1 dhe 2.
2. E drejta e ankimit nuk ndikon në detyrimin që kanë autoritetet kompetente për të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të eliminuar ose kufizuar rreziqet për shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve, për mirëqenien e kafshëve ose për sa i përket OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, si dhe për mjedisin, në përputhje me këtë ligj.

Neni 8

Detyrimet e konfidencialitetit të autoriteteve kompetente

1. Autoritetet kompetente garantojnë që informacioni i marrë gjatë kryerjes së detyrave të tyre për sa i përket kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare të mos u bëhet e ditur palëve të treta kur, sipas legjislacionit, ky informacion, nga natyra e tij, mbulohet nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale të subjektit të kontrollit zyrtar ose aktivitete të tjera kontrolli, përveç rasteve kur zbulimi i këtij informacioni është një interes publik.
2. Detyrimet lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, vlejnë edhe për autoritetet e kontrollit organik, trupat e deleguara dhe personat fizikë të cilëve u janë deleguar detyra specifike të kontrollit zyrtar, si dhe laboratorët zyrtarë.
3. Në rastet kur përcaktohet se ka një interes publik mbizotërues në zbulimin e informacionit të mbuluar nga sekreti profesional, siç përmendet në pikën 1 të këtij neni, autoritetet kompetente, ndër të tjera, duhet të marrin parasysh rrisqet e mundshme për shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve ose mjedisin, dhe natyrën, si dhe shkallën dhe shtrirjen e rrisqeve të tilla, nëse një informacion i tillë përfshin informacionin, zbulimi i të cilit do të dëmtojte:
 - (a) qëllimin e inspektimeve, hetimeve ose auditeve.
 - (b) mbrojtjen e interesave tregtare të një operatori ose ndonjë personi tjetër fizik ose juridik; ose
 - (c) mbrojtjen e proceseve gjyqësore.
4. Autoritetet kompetente garantojnë vendosjen e detyrime të përshtatshme lidhur me konfidencialitetin për personelin dhe individët e tjerë të punësuar gjatë ushtrimit të kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare.
5. Detyrimet lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit të parashikuara në këtë nen nuk pengojnë autoritetet kompetente të publikojnë ose të vënë në dispozicion të publikut informacion që lidhet me rezultatin e kontrolleve zyrtare të operatorëve të veçantë, pa paragjykuar situatat ku

zbulimi i informacionit diktohet nga legjislacioni në fuqi, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) operatorit në fjalë i është dhënë mundësia të komentojë mbi informacionin që autoriteti kompetent synon të publikojë ose të vërë në dispozicion të publikut, përpara publikimit të tij, sipas urgjencës së situatës; dhe
- b) informacioni i publikuar ose i vënë në dispozicion të publikut, ka marrë parasysh komentet e shprehura nga operatori në fjalë ose publikohet së bashku me komente e tij.

KREU II

Kontrollet Zyrtare

Seksioni I

Kërkesa të përgjithshme

Neni 9

Rregullat e përgjithshme për kontrollet zyrtare

1. IPKZ kryen rregullisht kontrolle zyrtare në të gjithë operatorët, mbi bazë të riskut dhe me frekuencën të përshtatshme, duke marrë parasysh:

- a) rrisqet e identifikuara që lidhen me:
 - i) kafshët dhe mallrat;
 - ii) aktivitetet nën kontrollin e operatorëve;
 - iii) vendndodhjen e aktiviteteve ose veprimtarisë të operatorëve;
 - iv) përdorimin e produkteve, proceseve, materialeve ose substancave që mund të ndikojnë në sigurinë e ushqimit, integritetin dhe cilësinë e ushqimit, ose sigurinë e ushqimit për kafshë, shëndetin ose mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve ose, në rastin e OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, që mund të kenë gjithashtu një ndikim negativ në mjedis;
- b) çdo informacion që tregon mundësinë që konsumatorët mund të mashtrohen, veçanërisht në lidhje me natyrën, identitetin, vetitë, përbërjen, sasinë, qëndrueshmërinë, shtetin e origjinës ose vendin e prejardhjes, metodën e përpunimit ose prodhimit të ushqimit;
- c) historikun e të dhënave të operatorëve në lidhje me rezultatet e kontrolleve zyrtare të kryera ndaj tyre dhe respektimin e rregullave të parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji;
- ç) besueshmërinë dhe rezultatet e kontrolleve të kryera nga vete operatorët, ose nga një palë e tretë me kërkesën e tyre, duke përfshirë, sipas rastit, skemat private të sigurimit të

cilësisë, me qëllim konstatimin e respektimit të rregullave të përmendura në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji; dhe

d) çdo informacion tjetër që mund të tregojë mospërputhje me rregullat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.

2. IPKZ kryen rregullisht kontrolle zyrtare, me frekuencë të përshtatshme, të përcaktuara në bazë të rrishtit, për të identifikuar shkeljet e mundshme, të kryera me qëllim, të rregullave të përcaktuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, të kryera nëpërmjet praktikave të padrejta ose mashtruese, dhe duke marrë parasysh historikun e të dhënave të operatorëve në lidhje me rezultatin e kontrolleve zyrtare të kryera mbi ta.

3. Kontrollat zyrtare që kryhen përpara hedhjes në treg, ose lëvizjes së kafshëve dhe mallrave të caktuara, për shkak të lëshimit të certifikatave zyrtare ose vërtetimeve zyrtare të përcaktuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, si kusht për vendosjen në treg ose lëvizjen e kafshëve ose mallrave zbatohen në përputhje me:

a) rregullat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji; dhe

(b) aktet nënligjore në fuqi të miratuara në bazë të këtij ligji.

4. Kontrollat zyrtare kryhen pa njoftim paraprak, përveç rasteve kur njoftimi paraprak është i nevojshëm dhe i justifikuar. Në kontrollat zyrtare me kërkesë të operatorit, autoriteti kompetent mund të vendosë nëse kontrolli zyrtar kryhet me ose pa njoftim paraprak. Kontrollat zyrtare me njoftim paraprak nuk përjashtojnë kontrollat zyrtare pa njoftim paraprak. Rregullat për kryerjen e kontrollit zyrtar ose aktiviteteve të tjera me paralajmërim përcaktohen me udhëzim të ministrit.

5. Kontrollat zyrtare kryhen, në mënyrë që kostot administrative dhe ndërprerja e veprimtarisë për operatorët të jetë në minimumin e nevojshëm, por pa ndikuar negativisht në efektivitetin e këtyre kontrolleve.

6. IPKZ kryen kontrolle zyrtare në të njëjtën mënyrë, sipas nevojës për të përshtatur kontrollat me situatat e veçanta, pavarësisht nga fakti që i përkasin kafshëve ose mallrave:

a) që janë të disponueshme në treg, pavarësisht nëse janë prodhuar në Shqipëri apo nga një shtet tjetër;

b) që do të eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë ose

c) që do të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 10

Operatorët, proceset dhe aktivitetet që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare

1. Për të përcaktuar, në masën e nevojshme, respektimin e rregullave të pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji, autoritetet kompetente kryejnë kontrolle zyrtare për:

a) kafshët dhe mallrat në çdo fazë të prodhimit, përpunimit, shpërndarjes dhe përdorimit;

b) substanca, materiale ose objekte të tjera që mund të ndikojnë në karakteristikat ose shëndetin e kafshëve dhe mallrave dhe respektimin e zbatimit të kriterëve të zbatueshme, në çdo fazë të prodhimit, përpunimit, shpërndarjes dhe përdorimit;

c) operatorët në lidhje me aktivitetet, duke përfshirë mbajtjen e kafshëve, pajisjeve, mjeteve të transportit, ambienteve dhe vendeve të tjera nën kontrollin e tyre dhe rrethinat e tyre si dhe dokumentacionin përkatës.

2. IPKZ harton dhe përditësojnë listën e operatorëve duke respektuar rregullat që kane të bëjnë me listat ose regjistrat ekzistues të krijuara në përputhje me pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji. Nëse një listë ose regjistër i tillë ekziston tashmë për qëllime të tjera, ai mund të përdoret edhe për qëllimet e këtij ligji.

3. Ministri me urdhër miraton kategoritë e operatorëve që përjashtohen nga lista e operatorëve të hartuar sipas pikës 2 të këtij neni, kur përfshirja e tyre në një listë të tillë, në krahasim me rriskun që lidhet me veprimtarinë e tyre, përbën një barrë administrative joproporcionale.

Neni 11

Transparenca e kontrolleve zyrtare

1. IPKZ kryen kontrolle zyrtare me një nivel të lartë transparence dhe, të paktën një herë në vit, vendosin në dispozicion të publikut, duke përfshirë edhe publikimin në faqen zyrtare, informacionin përkatës në lidhje me organizimin dhe kryerjen e kontrolleve zyrtare. Autoritetet kompetente garantojnë publikimin e rregullt dhe në kohë të informacionit për sa i përket:

a) llojit, numrit dhe rezultateve të kontrolleve zyrtare;

b) llojit dhe numrit të rasteve të konstatuara të mungesës së përputhshmërisë.

c) llojit dhe numrit të rasteve ku autoritetet kompetente kanë marrë masa në përputhje me nenin 110; dhe

ç) llojit dhe numrit të rasteve kur janë vendosur masat administrative.

2. IPKZ zbaton procedura për të garantuar që çdo pasaktësi në informacionin që i është vendosur në dispozicion të publikut të korrigjohet në mënyrën e duhur.

3. Autoritetet kompetente mund të publikojnë, ose të vendosin në dispozicion të publikut, informacion në lidhje me vlerësimin e operatorëve individualë bazuar në rezultatin e një ose më shumë kontrolleve zyrtare, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) kriteret e vlerësimit janë objektive, transparente dhe të disponueshme për publikun; dhe

b) janë vendosur masat e duhura për të garantuar drejtësinë, qëndrueshmërinë dhe transparencën e procesit të vlerësimit.

Neni 12

Procedurat e dokumentuara të kontrollit

1. Autoritetet kompetente kryejnë kontrolle zyrtare në përputhje me procedura të dokumentuara. Këto procedura mbulojnë fushat përkatëse të kontrollit të përcaktuara në Kapitullin II të Shtojcës I të këtij ligji dhe përmbajnë udhëzime për stafin që kryen kontrolle zyrtare.
2. Autoritetet kompetente zbatojnë procedurat e verifikimit të kontrollit dhe marrin masa korrigjuese kur evidentohen mangësi si dhe përditësojnë procedurat sipas nevojës.
3. Pika 1 dhe 2 e këtij neni zbatohen gjithashtu edhe për trupat e deleguara dhe autoritetet e kontrollit organik.

Neni 13

Raportet e Kontrolleve Zyrtare

1. Autoritetet kompetente hartojnë një raport të shkruar për çdo kontroll zyrtar që kryejnë. Ky raport mund të jetë në formë shkresore ose në formë elektronike dhe përfshin:
 - a) një përshkrim të qëllimit të kontrollit zyrtar;
 - b) metodat e zbatuara të kontrollit;
 - c) rezultatet e kontrollit zyrtar; dhe
 - ç) nëse është e nevojshme, përshkrimin e masave që autoritetet kompetente i kërkojnë operatorit të interesuar të marre mbi bazën e rezultateve të kontrollit zyrtar .
2. Përveç rasteve kur qëllimet e hetimeve ose proceseve gjyqësore kërkojnë ndryshe, operatorëve që i nënshtrohen një kontrolli zyrtar ju jepet, sipas kërkesës së tyre, një kopje e raportit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, me përjashtim të rastit kur është lëshuar një certifikatë ose një vërtetim zyrtar. Autoritetet kompetente informojnë me shkrim menjëherë operatorët për çdo rast të pa përputhshmërisë të identifikuar nëpërmjet kontrolleve zyrtare.
3. Nëse kontrollet zyrtare kërkojnë prezencën e vazhdueshme ose periodike të personelit ose përfaqësuesve të autoritetit kompetent në ambjentet e operatorit, raporti i përshkruar në pikën 1 të këtij neni hartohet me një frekuencë që i bën të mundur autoriteteve kompetente dhe operatorit:
 - a) informimin rregullisht mbi nivelin e përputhshmërisë; dhe

- b) njoftimin e menjëhereshëm për çdo rast të parregullsive të konstatuara nga kontrollet zyrtare.

4. Pika 1, 2, dhe 3 të këtij neni zbatohen edhe për trupat e deleguara, autoritetet e kontrollit organik dhe personat fizikë të cilëve u janë ngarkuar detyra të caktuara të kontrollit zyrtar.

Neni 14

Metodat dhe teknikat e kontrolleve zyrtare

Metodat dhe teknikat e kontrolleve zyrtare përfshijnë, sipas rastit:

- a) Ekzaminimin e kontrolleve të kryera nga vetë operatorët dhe rezultatet e tyre;
- b) inspektimin:
 - i) e mjeteve të punës, mjeteve të transportit, të ambjentëve dhe të vëndeve të tjera nën kontrollin dhe rrethinat e tyre;
 - ii) e kafshëve dhe mallrave, përfshirë produktet gjysmë të përpunuara, lëndët e para, përbërësit, mjeteve ndihmëse të përpunimit dhe produktet e tjera të përdorura për përgatitjen dhe prodhimin e mallrave, ose për ushqimin ose trajtimin e kafshëve;
 - iii) produktet dhe proceset e pastrimit dhe mirëmbajtjes;
 - iv) e gjurmueshmërisë, etiketimit, prezantimit, reklamimit dhe materialeve përkatëse të paketimit, duke përfshirë materialet që janë të destinuara të vijnë në kontakt me ushqimin;
- c) kontrollet e kushteve higjienike në ambientet e operatorëve;
- ç) një vlerësim të procedurave për praktikën e mira të prodhimit, praktikën e mira të higjienës, praktikën e mira bujqësore dhe të procedurave të bazuara në parimet e analizës së riskut dhe pikat kritike të kontrollit, këtu e në vijim HACCP;
- d) kontrollin e dokumentave, të dhënat mbi gjurmueshmërinë dhe të dhëna të tjera që mund të jenë të nevojshme për vlerësimin e përputhshmërisë me kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji, duke përfshirë nëse është e nevojshme, dokumentet që shoqërojnë ushqimet, ushqime për kafshët dhe çdo substance ose material që hyn dhe del nga një stabiliment;
- e) intervista me operatorët dhe stafin e tyre;
- ë) verifikimin e masave të marra nga operatori dhe rezultate të tjera të testimit;
- f) marrjen e mostrave, analizave, diagnostikimi and testet;
- g) auditmin e operatorëve;
- gj) çdo aktivitet tjetër të nevojshëm për të identifikuar rastet e shkeljeve;

Neni 15

Detyrimet e operatorëve

1. Operatorët, me kërkesë të autoriteteve kompetente, për aq sa është e nevojshme për kryerjen e kontrolleve zyrtare ose të aktiviteteve të tjera zyrtare, i japin akses personelit të autoriteteve kompetente në:

- a) pajisjet, mjetet e transportit, ambjentet dhe vendet e tjera nën kontrollin e tyre dhe rrethinat e tyre;
- b) sistemet e tyre të kompjuterizuara të menaxhimit të informacionit;
- c) kafshët dhe mallrat nën kontrollin e tyre;
- ç) dokumentet dhe në të gjitha informacionet e tjera që i përkasin kontrollit;

2. Gjatë kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare, operatorët ndihmojnë dhe bashkëpunojnë me stafin e autoriteteve kompetente dhe organeve të kontrollit organik në përmbushjen e detyrave të tyre.

3. Operatori përgjegjës për një ngarkesë që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç detyrimeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, vendos në dispozicion, pa vonesë, në formë shkresore ose elektronike të gjithë informacionin në lidhje me kafshët dhe mallrat.

4. Rregullat për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet operatorëve dhe autoriteteve kompetente në lidhje me mbërritjen dhe shkarkimin e kafshëve dhe mallrave që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare në pikat e kontrollit kufitar kur është e nevojshme të sigurohet identifikimi i plotë i tyre dhe kryerja efikase e kontrolleve zyrtare në kafshët dhe mallrat e tilla miratohen me udhëzim nga ministri përgjegjës për bujqësinë.

5. Për qëllime të pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji, operatorët që i nënshtrohen kontrollit zyrtar i vendosin në dispozicion autoriteteve kompetente të paktën informacionin e përditësuar si vijon:

a) emrin dhe statusin e tyre juridik; dhe

b) aktivitetet konkrete që ata kryejnë, duke përfshirë aktivitetet e ndërmarra nëpërmjet teknikave dhe metodave të komunikimit në distancë dhe vendet nën kontrollin e tyre.

6. Detyrimet e operatorëve të përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe në rastet kur kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare kryhen nga veterinerët zyrtarë, zyrtarët përgjegjës për shëndetin e bimëve, organet e deleguara, autoritetet e kontrollit dhe personat fizik të cilëve u janë caktuar detyra të caktuara të kontrollit zyrtar ose detyra të caktuara që lidhen me aktivitete të tjera zyrtare.

Seksioni II

Kërkesa plotësuese për kontrolle zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare në fusha të caktuara

Neni 16

Rregulla të veçanta për kontrollet zyrtare dhe për veprimet e ndërmarra nga autoritetet kompetente në lidhje me prodhimin e produkteve me origjinë shtazore të destinuara për konsum njerëzor

1. Kontrollet zyrtare të kryera për të verifikuar respektimin e legjislacionit të përmendur në nenin 2 pika 2 të këtij ligji në lidhje me produktet me origjinë shtazore të destinuara për konsum njerëzor përfshijnë, sipas rastit, verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin mbi higjienën e produkteve ushqimore, kërkesat specifike të higjienës së ushqimve me origjinë shtazore, rregullat shëndetësore në lidhje me nënproduktet e kafshëve dhe produktet e prejardhura që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor si dhe për mbrojtjen e kafshëve në momentin e vrasjes.

2. Kontrollet zyrtare të kryera në lidhje me prodhimin e mishit sipas pikës 1 të këtij neni përfshijnë:

- a) inspektimin para therjes të kryer në thertore nga një veteriner zyrtar, i cili, për sa i përket përzgjedhjes paraprake të kafshëve, mund të asistohet nga ndihmës zyrtarë të trajnuar për këtë qëllim;
- b) me përjashtim të shkronjës a) të pikës 2 të këtij neni, për sa i përket shpendëve dhe lagomorfëve, inspektimin para therjes të kryer sipas rastit nga një veteriner zyrtar, nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar ose, kur ka garanci të mjaftueshme, nën përgjegjësinë e veterinerit zyrtar;
- c) inspektimin pas therjes të kryer sipas rastit nga veterineri zyrtar, nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar ose, kur ka garanci të mjaftueshme, nën përgjegjësinë e veterinerit zyrtar;

ç) kontrollet e tjera zyrtare të kryera në thertore, stabilimente prerëse dhe stabilimentet për përpunimin e kafshëve të gjahut, të kryera sipas rastit nga një veteriner zyrtar, ose nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar ose, nëse ka garanci të mjaftueshme, nën përgjegjësinë e veterinerit zyrtar, për të verifikuar përputhshmërinë me kërkesat që aplikohen për:

(i) higjienën e prodhimit të mishit;

(ii) praninë e mbetjeve të produkteve mjeksore veterinare dhe ndotësve në produktet me origjinë shtazore të destinuara për konsum njerëzor;

(iii) auditimet e praktikave dhe procedurave të mira të higjienës bazuar në parimet e HACCP;

(iv) testet laboratorike për të zbuluar praninë e agentëve zoonotikë dhe sëmundjet e kafshëve si dhe për të verifikuar përputhjen me kriterin mikrobiologjik siç përcaktohet në legjislacionin për kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore;

(v) trajtimin dhe asgjësimin e nënprodukteve shtazore dhe të materialit të rrezikshëm të specifikuar;

(vi) shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve.

3. IPKV, në bazë të analizës së rrishtut, mund të lejojë stafin e thertoresh të asistojë në kryerjen e detyrave që lidhen me kontrollet zyrtare të përmendura në pikën 2 të këtij neni, në stabilimentet që therin shpendë ose lagomorfë, ose, në stabilimente që therin kafshë të llojeve të tjera, për të kryer detyra specifike të marrjes së mostrave dhe testimin në lidhje me kontrolle të tilla, me kusht që stafi:

- a) të veprojnë në mënyrë të pavarur nga stafi i repartit të prodhimit të thertoresh;
- b) të ketë marrë një trajnim të përshtatshëm për kryerjen e këtyre detyrave; dhe
- c) t'i kryejë këto detyra në praninë dhe duke ndjekur udhëzimet e veterinerit zyrtar ose të ndihmësit zyrtar

4. Kur në kontrollet zyrtare, të përmendura në shkronjat a) dhe c të pikës 2 të këtij neni, nuk identifikohet ndonjë mangësi që do ta bënte mishin të papërshtatshëm për konsum njerëzor, thundrakëve shtëpiake, gjitarëve të egër të kultivuar në fermë, përveç lagomorfëve dhe kafshëve të mëdha të egra të gjahut, u vendoset një shenjë identifikuese për shëndetin nga veterineri zyrtar, ose nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar, ose nën përgjegjësinë e veterinerit zyrtar, ose, nga stafi i thertoresh në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni,

5. Veterineri zyrtar është përgjegjës për vendimet e marra në vijim të kontrolleve zyrtare, të parashikuara në pikën 2 dhe 4 të këtij neni, edhe nëse kryerjen e një veprimi ja ka caktuar ndihmësit zyrtar.

6. Për qëllime të kontrolleve zyrtare të përmendura në pikën 1 të këtij neni, të kryera në lidhje me molusqet e gjalla bivalve, ekinodermat, tunikat dhe gastropodët detarë, IPKU klasifikon zonat e prodhimit dhe të rritjes.

7. Ministri me udhëzime të veçanta miraton rregullat specifike për kryerjen e kontrolleve zyrtare të përmendura në pikat 2 deri në 6 të këtij neni për:

- a) kriteret dhe kushtet, duke përjashtuar shkronjën a) të paragrafit 2 të këtij neni, për të përcaktuar rastet kur inspektimi para therjes në thertore të caktuara mund të kryhet nën mbikëqyrjen ose nën përgjegjësinë e një veterineri zyrtar, me kusht që ky përjashtim nuk cenon arritjen e objektivave të këtij ligji;
- b) kriteret dhe kushtet për të përcaktuar kur janë dhënë garanci të mjaftueshme për kryerjen e kontrolleve zyrtare nën përgjegjësinë e një veterineri zyrtar në lidhje me inspektimet para therjes sipas shkronjës b) të pikës 2 të këtij neni të shpendëve dhe lagomorfëve;
- c) kriteret dhe kushtet për të përcaktuar, me përjashtim të shkronjës a) të pikës 2 të këtij neni, kur inspektimi para therjes mund të kryhet jashtë thertoresh në rastin e therjeve të sforcuara;
- ç) kriteret dhe kushtet për të përcaktuar se kur mund të kryhet inspektimi para therjes në fermën e origjinës duke përjashtuar shkronjat a) dhe b) të pikës 2 të këtij neni.

d) kriteret dhe kushtet për të përcaktuar se kur janë dhënë garanci të mjaftueshme për kryerjen e kontrolleve zyrtare nën përgjegjësinë e një veterineri zyrtar në lidhje me inspektimin pas therjes dhe veprimeve audituese të përmendura në shkronjat (c) dhe (d) të pikës 2 të këtij neni;

dh) në rastin e therjes së sforcuar, kriteret dhe kushtet për të përcaktuar se kur inspektimi pas therjes duhet të kryhet nga veterineri zyrtar në ndryshim shkronja c) e pikës së 2 të këtij neni;

e) kriteret dhe kushtet, duke përjashtuar pikën 6 të këtij neni, për të përcaktuar kur zonat e prodhimit dhe të rritjes klasifikohen në lidhje me:

(i) Pectinidaet; dhe

(ii) kur nuk janë ushqyes filtri: ekinodermat dhe gastropodët detarë;

ë) përjashtime specifike në lidhje me *Rangifer tarandus tarandus*, *Lagopus lagopus* dhe *Lagopus mutus*, për të lejuar vazhdimësinë e zakoneve dhe praktikave të vjetra lokale dhe tradicionale, me kusht që përjashtimet të mos cenojnë arritjen e objektivave të këtij ligji;

f) kriteret dhe kushtet, duke përjashtuar shkronjën ç) të pikës 2 të këtij neni, për të përcaktuar kur kontrollet zyrtare në stabilimentet e prerjes mund të kryhen nga personeli i caktuar nga IPKZ për këtë qëllim dhe i trajnuar në mënyrë të përshtatshme;

f) kërkesat specifike minimale për personelin e IPKZ dhe për veterinerin zyrtar dhe ndihmësin zyrtar në mënyrë që të garantojnë kryerjen në formën e duhur të detyrave të tyre të parashikuara në këtë nen, duke përfshirë kërkesat specifike minimal të trajnimit;

g) kërkesat të përshtatshme minimale të trajnimit për personelin e thertores që ndihmon në kryerjen e detyrave që kanë të bëjnë me kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare në përputhje me pikën 3 të këtij neni.

8. Minisitri me udhëzime të veçanta miraton rregullat për masa praktike të unifikuara për kryerjen e kontrolleve zyrtare të përcaktuara në këtë nen lidhur me:

a) kërkesat specifike për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe frekuencën minimale të unifikuar të këtyre kontrolleve zyrtare, duke patur parasysh rreziqet dhe rrisqet specifike që ekzistojnë në lidhje me çdo produkt me origjinë shtazore dhe proceset e ndryshme që ai i nënshtrohet, ku një nivel minimal i kontrolleve zyrtare është i nevojshëm për t'iu përgjigjur reziqeve dhe risqeve uniforme të njohura që mund të paraqiten nga produktet me origjinë shtazore;

b) kushtet për klasifikimin dhe monitorimin e zonave të klasifikuara të prodhimit dhe bartjes të molusqeve të gjalla bivalvorë, ekinodermave, tunikateve dhe gastropodëve detarë;

c) rastet kur autoritetet kompetente në lidhje me shkelje specifike duhet të marrin një ose më shumë nga masat sipas kërkesave të neneve 109 pika 2 dhe 110 pika 3 të këtij ligji;

- ç) masat praktike të inspektimeve para dhe pas therjes (ante-mortem dhe post-mortem të përmendura në shkronjat a), b) dhe c) të pikës 2 të këtij neni, duke përfshirë kërkesa të unifikuara të nevojshme për të siguruar që ka garanci të mjaftueshme për rastet në të cilat kontrollet zyrtare kryhen nën përgjegjësinë e veterinarit zyrtar;
- d) specifikimet teknike të shenjës shëndetësore identifikuese dhe mënyrat praktike për aplikimin e saj;
- dh) kërkesat specifike për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe frekuencën minimale të unifikuar të këtyre kontrolleve zyrtare për qumështin e papërpunuar, produktet e qumështit dhe produktet e peshkimit, ku nevojitet një nivel minimal i kontrolleve zyrtare për t'iu përgjigjur reziqeve dhe risqeve uniforme të njohura që këto produkte mund të paraqesin.

9. Në përputhje me nenin 28 të këtij ligji (30 të Rregullores), disa detyra të kontrollit zyrtar të përcaktuara në këtë nen mund t'ju ngarkohet një ose më shumë personave fizikë.

Neni 17

Rregulla specifike për kontrollet zyrtare dhe për veprimet e ndërmarra nga autoritetet kompetente në lidhje me mbetjet e substancave përkatëse në ushqim dhe ushqimin për kafshë

1. Me qëllim verifikimin e përpuethshmërisë me rregulat e përmendura në shkronjat a) dhe c) të nenit 2, pika 2 të këtij ligji, kontrollet zyrtare, përfshijnë kontrollet që kryhen në çdo fazë të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes, mbi substancat përkatëse, përfshirë substancat që do të përdoren në materialet në kontakt me ushqimin, kontaminantët, substancat e paautorizuara, të ndaluara dhe të padëshiruara, përdorimi ose prania e të cilave në kulturat bujqësore, kafshë ose prodhimi apo përpunimi i ushqimit ose ushqimit për kafshë mund të rezultojë në mbetje të këtyre substancave në ushqim ose ushqimin për kafshë.
2. Ministri miraton me udhëzim rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare të përmendura në pikën 1 të këtij neni si dhe për veprimet që ndërmerren nga IPKZ në vijim të këtyre kontrolleve zyrtare. Këto rregulla përfshijnë:
 - a) kërkesat specifike për kryerjen e kontrolleve zyrtare, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, gamën e mostrave dhe fazën e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes ku mostrat do të merren në përputhje me metodat që përdoren për marrjen e mostrave dhe analizat laboratorike, duke pasur parasysh për rreziqet dhe rrisqet specifike që lidhen me substancat e përmendura në pikën 1 të këtij neni;
 - b) rastet kur IPKZ merr një ose më shumë nga masat e parashikuara në nenet 109 pika 2 dhe 110 pika 2 të këtij ligji si rezultat i shkeljeve ose dyshimit për shkelje.
 - c) rastet kur IPKZ marrin një ose më shumë nga masat e parashikuara nga nenet 63 deri në 70 të këtij ligji në lidhje me shkeljet ose dyshimin për shkelje për sa i përket kafshëve dhe mallrave nga shtete të tjera.
3. Ministri me urdhër miraton rregullat për masa praktike të unifikuara për kryerjen e kontrolleve zyrtare të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe për veprimet që ndërmerren nga IPKZ në vijim të këtyre kontrolleve zyrtare, në lidhje me:

a) frekuencën minimale të unifikuar të këtyre kontrolleve zyrtare, sipas rrisqeve që lidhen me substancat e përmendura në pikën 1 të këtij neni;

b) koordinime dhe përmbajtje specifike shtesë përveç atyre të parashikuara për përgatitjen e pjesëve përkatëse të Planit Kombëtar Shumëvjeçar të Kontrollit, këtu e në vijim PKSHK;

4. Në përputhje me nenin 28 të këtij ligji, disa detyra të kontrollit zyrtar të përcaktuara në këtë nen mund t'ju ngarkohet një ose më shumë personave fizikë.

Neni 18

Rregulla specifike për kontrollet zyrtare dhe për veprimet e ndërmarra nga IPKZ në lidhje me kafshët, produktet me origjinë shtazore, produktet embrionale, nënproduktet shtazore dhe produktet e prejardhura

1. Kontrollet zyrtare që kryhen për të verifikuar zbatimin e legjislacionit të parashikuar në shkronjat a), c), ç) dhe d) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji, përfshijnë kontrollet zyrtare që kryhen në çdo fazë të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes të kafshëve, produkteve me origjinë shtazore, produkteve embrionale, nënprodukteve shtazore dhe produkteve të prejardhura.

2. Ministri me urdhër miraton rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare për kafshët, për produktet me origjinë shtazore, për produktet embrionale, për nënproduktet shtazore dhe për produktet e prejardhura për të verifikuar zbatimin e legjislacionit të parashikuar në shkronjat d) dhe e) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji dhe për veprimet e ndërmarra nga IPKZ në vijim të kontrolleve zyrtare. Këto rregulla parashikojnë:

a) kërkesa specifike për kryerjen e kontrolleve zyrtare mbi kafshët, produktet me origjinë shtazore dhe produktet embrionale për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe rrisqeve të njohura për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve me anë të kontrolleve zyrtare të kryera për të verifikuar zbatimin e masave parandaluese dhe kontrollit të sëmundjeve të parashikuara në shkronjën ç) të nenit 2, pika 2 të këtij ligji;

b) kërkesa specifike për kryerjen e kontrolleve zyrtare mbi nënproduktet e kafshëve dhe produktet e prejardhura për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe rrisqeve specifike për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve me anë të kontrolleve zyrtare të kryera për të verifikuar zbatimin e legjislacionit të parashikuar në shkronjën d) të nenit 2, pika 2 të këtij ligji;

c) rastet kur IPKZ marrin një ose më shumë nga masat e parashikuara nga nenet 109 pika 2 deri në 110 pika 2 të këtij ligji në lidhje me shkeljet ose dyshimin për shkelje.

3. Ministri me udhëzim miraton rregullat për masa praktike të unifikuara për kryerjen e kontrolleve zyrtare të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, në lidhje me:

(a) Frekuencën minimale të unifikuar të kontrolleve zyrtare mbi kafshët, produktet me origjinë shtazore dhe produktet embrionale ku është i nevojshëm një nivel minimal i kontrolleve zyrtare për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe rrisqeve uniforme të njohura për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve me anë të kontrolleve zyrtare të kryera për të verifikuar zbatimin e masave për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të parashikuara në shkronjën d) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji; dhe

(b) Frekuencën minimale të unifikuar të kontrolleve zyrtare për nënproduktet shtazore dhe produktet e prejardhura ku është i nevojshëm një nivel minimal i kontrolleve zyrtare për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe rrisqeve specifike për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve me anë të kontrolleve zyrtare të kryera për të verifikuar zbatimin e rregullave të parashikuara në shkronjën d) të nenit 2 pika 2 e këtij ligji.

4. Në përputhje me nenin 28 të këtij ligji, disa detyra të kontrollit zyrtar të përcaktuara në këtë nen mund t'ju ngarkohen një ose më shumë personave fizikë.

Neni 19

Rregulla specifike për kontrollet zyrtare dhe për veprimet që ndërmerren nga autoritetet kompetente IPKZ në lidhje me kriteret për mirëqenien e kafshëve

1. Kontrollet zyrtare kryhen në të gjitha fazat përkatëse të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes përgjatë zinxhirit agroushqimor për të verifikuar respektimin e legjislacionit të parashikuar në shkronjën dh) të nenit 2, pika 2, të këtij ligji.

2. Kontrollet zyrtare për të verifikuar zbatimin e legjislacionit që përcakton rregullat për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve gjatë transportit të tyre, përfshijnë:

a) në rastin e udhëtimeve të gjata në shtete të tjera, kontrollet zyrtare të kryera para ngarkimit të kafshëve për të verifikuar përshtatshmërinë e tyre për transport;

b) në rastin e udhëtimeve të gjata në shtete të tjera të njëthundrakeve shtëpiake, me përjashtim të njëthundrakeve të regjistruar dhe kafshëve shtëpiake të llojeve gjedh, dhen, dhi dhe derra para udhëtimit kryhet:

(i) kontroll zyrtar i regjistrit të udhëtimit për të verifikuar që regjistri i udhëtimit është real dhe përputhet me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e kafshëve gjatë transportit; dhe

(ii) kontroll zyrtar për të verifikuar që transportuesi i shënuar në regjistrin e udhëtimit ka autorizim të vlefshëm transportuesi, certifikatën e miratimit për mjetet e transportit për udhëtime të gjata si dhe certifikatat e aftësisë për drejtuesit e mjeteve të transportit dhe shoqëruesit;

c) në pikat e kontrollit kufitar dhe në pikat e daljes kryhet:

(i) kontroll zyrtar për të verifikuar përshtatshmërinë e kafshëve që do të transportohen dhe mjeteve të transportit për të verifikuar përputhshmërinë me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e kafshëve gjatë transportit

(ii) kontroll zyrtar për të verifikuar që transportuesit respektojnë marrëveshjet ndërkombëtare ne fuqi dhe janë të pajisur me autorizime të vlefshme si transportues dhe certifikata të aftësisë për drejtuesit e mjeteve të transportit dhe shoqëruesit; dhe

(iii) kontroll zyrtar për të verifikuar nëse, njëthundrakët shtëpiake dhe kafshët shtëpiake të llojeve të gjedheve, dhenve, dhive e derrave, janë transportuar ose do të transportohen nëpërmjet udhëtimeve të gjata.

3. Gjatë kryerjes së kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare, IPKZ dhe IPAT marrin masat e nevojshme për të parandaluar ose minimizuar çdo vonesë ndërmjet ngarkimit të kafshëve, nisjes së tyre ose gjatë transportit.

Inspektori i IPKZ nuk ndalon kafshët gjatë transportit, përveç rasteve kur është rreptësisht e nevojshme për mirëqenien e kafshëve ose për arsye të shëndetit të kafshëve ose njerëzve. Nëse kafshët ndalohen gjatë transportit për më shumë se dy orë, inspektori i IPKZ siguron marrjen e masave të nevojshme për kujdesin e tyre dhe, nëse është e nevojshme, marrjen e masave për ti dhënë ushqim dhe ujë, si për ti shkarkuar dhe strehuar.

4. Nëse pas kontrolleve zyrtare të kryera në përputhje me shkronjën b) të pikës 2 të këtij neni, është konstatuar shkelje dhe organizatorinuk i ka korrigjuar dhe nuk ka bërë ndryshimet e nevojshme për modalitetet e transportit para udhëtimit të gjatë, inspektori i IPKZ pezullonë këtë udhëtim të gjatë.

5. Nëse, në vijim të kontrolleve zyrtare të kryera në përputhje me shkronjën c) të pikës 2 të këtij ligji konstatohet se kafshët nuk janë në gjendje për të përfunduar udhëtimin, inspektori i IPKZ urdhëron që kafshët të shkarkohen, t'ju jepet ujë, të ushqehen dhe të lihen që të pushojnë, deri kur të jenë në gjendje për të vazhduar udhëtimin e tyre.

6. Njoftimi për mosrespektim të rregullave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, bëhet tek:

- (a) vendi që kanë dhënë autorizimin për transportuesin;
- (b) vendi që ka dhënë certifikatën e miratimit të mjetit të transportit kur identifikohet mosrespektimi i ndonjërit prej rregullave që zbatohen për mjetin e transportit;
- (c) vendi që ka lëshuar certifikatën e aftësisë së drejtuesit kur identifikohet mosrespektimi i ndonjërit prej rregullave që zbatohen për drejtuesit.

7. Në përputhje me nenin 28 të këtij ligji, disa detyra të kontrollit zyrtar të përcaktuara në këtë nen mund t'ju ngarkohen një ose më shumë personave fizikë.

8. Ministri me udhëzim miraton rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare që kanë për qëllim verifikimin e zbatimit të legjislacionit të parashikuar në shkronjën dh) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji. Këto rregulla marrin parasysh rriskun e mirëqenies së kafshëve në lidhje me aktivitetet bujqësore dhe me transportin, therjen dhe vrasjen e kafshëve, dhe përcaktojnë rregullat për:

a) kërkesat specifike për kryerjen e këtyre kontrolleve zyrtare për t'iu përgjigjur riskut që lidhet me llojet e ndryshme të kafshëve dhe të mjeteve të transportit, si dhe nevojën për të parandaluar praktika të parregullta dhe për të kufizuar vuajtjen e kafshëve;

b) rastet kur IPKZ në lidhje me shkelje specifike duhet të marrin një ose më shumë nga masat e parashikuara në nenet 109 pika 2 dhe 110 pika 2 të këtij ligji;

c) verifikimin e plotësimit të kërkesave për mirëqenien e kafshëve në pikat e kontrollit kufitar dhe në pikat e daljes si dhe kërkesat minimale të zbatueshme për ato pika dalje;

ç) rastet dhe kushtet kur kontrollet zyrtare për të verifikuar zbatimin e kërkesave për mirëqenien e kafshëve mund të përfshijnë përdorimin e treguesve specifikë të mirëqenies së kafshëve bazuar në kritere të matshme të performancës dhe hartimin e treguesve të tillë mbi bazën e provave shkencore dhe teknike.

9. Ministri me udhëzim miraton rregullat për masa praktike të unifikuara për kontrollet zyrtare që ndërmerren për të verifikuar zbatimin e legjislacionit të parashikuar në shkronjën dh) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji, që përcakton kërkesat për mirëqenien e kafshëve dhe veprimet e ndërmarra nga autoritetet kompetente pas kryerjes së kontrolleve zyrtare, në lidhje me:

- a) frekuencën minimale të unifikuar të këtyre kontrolleve zyrtare, ku një nivel minimal i kontrollit zyrtar është i nevojshëm për t'iu përgjigjur rrezikut që lidhet me llojet e ndryshme të kafshëve dhe mjetet e transportit, dhe nevojën për të parandaluar praktikën e parregullta dhe për të kufizuar vuajtjet e kafshëve; dhe
- b) masat praktike për mbajtjen e dokumentacionit të shkruar të kontrolleve zyrtare të kryera dhe kohëzgjatjen e ruajtjes së tyre.

Neni 20

Rregulla specifike për kontrollet zyrtare dhe për veprimet e ndërmarra nga IPKZ në lidhje me shëndetin e bimëve

1. Kontrollet zyrtare për verifikimin e zbatimit të legjislacionit të parashikuar në shkronjën e) të nenit 2, pika 2, të këtij ligji, përfshijnë kontrollet zyrtare ndaj dëmtuesve, bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, si dhe ndaj operatorëve profesionistë dhe personave të tjerë që i nënshtrohen atij legjislacioni.
2. Ministri me udhëzim miraton rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare mbi bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera për të verifikuar zbatimin e legjislacionit të parashikuar në shkronjën e) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji, i zbatueshëm për këto mallra dhe për veprimet e ndërmarra nga IPKZ pas kryerjes së këtyre kontrolleve zyrtare. Këto rregulla parashikojnë:
 - a) kërkesat specifike për kryerjen e këtyre kontrolleve zyrtare për futjen dhe lëvizjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të bimëve të veçanta, produkteve bimore dhe objekteve të tjera që i nënshtrohen rregullave të parashikuara në shkronjën e) të nenit 2, pika 2 të këtij ligji, për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe rrisqeve të njohura për shëndetin e bimëve në lidhje me bimë të veçanta, produkte bimore dhe objekte të tjera me origjinë ose prejardhje të caktuar; dhe
 - b) rastet kur IPKZ në lidhje me shkelje specifike duhet të marrin një ose më shumë nga masat e parashikuara në nenet 109 pika 2 dhe 110 pika 2 të këtij ligji;
3. Ministri me udhëzim miraton rregullat për masa praktike të unifikuara për kryerjen e kontrolleve zyrtare mbi bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera për të verifikuar zbatimin e legjislacionit të parashikuar në shkronjën e) të nenit 2, pika 2 të këtij ligji, të zbatueshme për këto mallra dhe për veprimet e ndërmarra nga autoritetet kompetente pas kryerjes së kontrolleve të tilla zyrtare në lidhje me:
 - a) frekuencën minimale të unifikuar të këtyre kontrolleve zyrtare, ku një nivel minimal i kontrollit zyrtar është i nevojshëm për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe rrisqeve uniforme të njohura për shëndetin e bimëve në lidhje me bimë specifike, produktet bimore dhe objektet e tjera me origjinë ose prejardhje të caktuar;
 - b) frekuencën minimale të unifikuar të kontrolleve zyrtare të kryera nga IPKZ për operatorët e autorizuar për lëshimin e pasaportave të bimëve në përputhje me legjislacionin për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve, nëse këta operatorë kanë zbatuar një plan për menaxhimin e riskut nga dëmtuesit sikurse parashikohet në legjislacion për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera të prodhuara nga ato;

c) frekuencën minimale të unifikuar të kontrolleve zyrtare të kryera nga IPKZ ndaj operatorëve të autorizuar për të vendosur shenjën identifikuese në përputhje me legjislacionin për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve ose për të lëshuar vërtetimin zyrtar sipas kërkesave të parashikuara në këtë legjislacion.

4. Në përputhje me nenin 28 të këtij ligji, disa detyra të kontrollit zyrtar të përcaktuara në këtë nen mund t'ju ngarkohen një ose më shumë personave fizikë.

Neni 21

Rregulla specifike të kontrolleve zyrtare dhe veprimeve që merren në lidhje me organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ) për qëllime të prodhimit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë si dhe ushqimit dhe ushqimit për kafshë të modifikuar gjenetikisht

1. Kontrollet zyrtare për verifikimin e zbatimit të legjislacionit të parashikuar në shkronjat a), b) dhe c) të nenit 2 pika 2, të këtij ligji, përfshijnë kontrollet zyrtare ndaj OMGJ, për qëllime të prodhimit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë të modifikuar gjenetikisht të kryera në të gjitha fazat përkatëse të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes përgjatë zinxhirit agroushqimor.

2. Rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare të përmendura në pikën 1 të këtij neni dhe veprimet që ndërmerren nga IPKZ pas kryerjes së këtyre kontrolleve zyrtare miratohen me udhëzim të ministrit. Këto rregulla mjiratohen sipas nevojës për të siguruar një nivel minimal kontrollesh zyrtare për të parandaluar praktikatat që cenojnë legjislacionin e parashikuar në shkronjën b) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji dhe përcaktojnë:

a) kërkesat specifike për kryerjen e kontrolleve zyrtare për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe risqeve uniforme të njohura të:

i) pranisë në zinxhirin agroushqimor të OMGJ-ve për prodhimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë të modifikuara gjenetikisht, të cilat nuk janë autorizuar në përputhje me legjislacionin për lëshimin e qëllimshëm në mjedis të organizmave të modifikuar gjenetikisht ose legjislacionin për të modifikuar gjenetikisht ushqimin dhe ushqimin për kafshë;

(ii) kultivimit të OMGJ-ve për prodhimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe zbatimit të saktë të planit të monitorimit të parashikuar në legjislacionin për çlirimin e qëllimshëm në mjedis të organizmave të modifikuar gjenetikisht dhe në legjislacionin për ushqimin dhe ushqimin për kafshë të modifikuar gjenetikisht;

b) rastet kur IPKZ në lidhje me shkelje specifike duhet të marrin një ose më shumë nga masat e parashikuara në nenet 109 pika 2 dhe 110 pika 2 të këtij ligji;

3. Ministri me udhëzim miraton rregulla për masa praktike të unifikuara për kryerjen e kontrolleve zyrtare të përmendura në pikën 1 të këtij neni, duke marrë parasysh nevojën për të siguruar një nivel minimal kontrollesh zyrtare për të parandaluar praktikatat që shkelin këto rregulla në lidhje me frekuencën minimale të unifikuar të kontrolleve të tilla zyrtare ku një

nivel minimal i kontrollit zyrtar është i nevojshëm për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe rrisqeve uniforme të njohura të:

- a) pranisë në zinxhirin agroushqimor të OMGJ-ve për prodhimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë të modifikuara gjenetikisht, të cilat nuk janë autorizuar në përputhje me legjislacionin për lëshimin e qëllimshëm në mjedis të organizmave të modifikuar gjenetikisht dhe legjislacionin për ushqimin dhe ushqimin e modifikuar gjenetikisht;
- b) kultivimit të OMGJ-ve për prodhimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe zbatimit të saktë të planit të monitorimit të parashikuar në legjislacionin për çlirimin e qëllimshëm në mjedis të organizmave të modifikuar gjenetikisht dhe në legjislacionin për ushqimin dhe ushqimin për kafshë të modifikuar gjenetikisht;

4. Në përputhje me nenin 28 të këtij ligji, disa detyra të kontrollit zyrtar të përcaktuara në këtë nen mund t'ju ngarkohen një ose më shumë personave fizikë.

Neni 22

Rregulla specifike për kontrollet zyrtare dhe për veprimet e ndërmarra nga IPKZ në lidhje me produktet për mbrojtjen e bimëve

1. Kontrollet zyrtare për verifikimin e zbatimit të legjislacionit të parashikuar në shkronjën ë) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji, përfshijnë dhe kontrollet zyrtare për substancat aktive dhe mbrojtësit, sinergjikët, bashkëformuluesit dhe ndihmësit, sipas kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e bimëve.

2. Me qëllim të përcaktimit të frekuencës së kontrolleve zyrtare të bazuara në risk, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, IPKZ marrin parasysh edhe sa vijon:

- a) rezultatet e aktiviteteve përkatëse monitoruese duke përfshirë ato për mbetjet e pesticideve të kryera për qëllime të legjislacionit për nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në produktet me origjinë bimë dhe shtazore;
- b) informacionin mbi produktet e paautorizuara të mbrojtjes së bimëve, duke përfshirë tregtimin e paligjshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve, dhe rezultatet e kontrolleve përkatëse nga autoritetet përkatëse për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme; dhe
- c) informacion mbi helmimet në lidhje me produktet për mbrojtjen e bimëve, duke përfshirë informacionin e disponueshëm në përputhje me legjislacionin për vendosjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe informacionin mbi reagimet shëndetësore emergjente të disponueshme sipas legjislacionit për menaxhimin e kimikateve.

3. Rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare të përmendura në pikën 1 të këtij neni miratohen me udhëzim të ministrit. Këto rregulla parashikojnë:

- a) kërkesa specifike për kryerjen e këtyre kontrolleve zyrtare për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe rrisqeve uniforme të njohura që mund të paraqesin produktet e mbrojtjes së bimëve, në lidhje me prodhimin, vendosjen në treg, hyrjen në Republikën e Shqipërisë, etiketimin, paketimin, transportin, ruajtjen dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve për të siguruar përdorimin e tyre të sigurt dhe të qëndrueshëm dhe për të luftuar tregtinë e tyre të paligjshme; dhe

b) rastet kur IPKZ në lidhje me shkelje specifike duhet të marrin një ose më shumë nga masat e parashikuara në nenet 109 pika 2 dhe 110 pika 2 të këtij ligji;

4. Rregullat për masa praktike të unifikuara për kryerjen e kontrolleve zyrtare mbi produktet e përmendura në pikën 1 të këtij neni miratohen me udhëzim të ministrit dhe parashikojnë:

a) frekuencën minimale të unifikuar të këtyre kontrolleve zyrtare, ku një nivel minimal i kontrollit zyrtar është i nevojshëm për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe rrisqeve uniforme të njohura që mund të paraqiten nga produktet për mbrojtjen e bimëve, në lidhje me prodhimin, vendosjen në treg, hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë, etiketimin, paketimin, transportin, ruajtjen dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve për të garantuar përdorimin e tyre të sigurt dhe të qëndrueshëm dhe për të luftuar tregtinë e tyre të paligjshme;

b) mbledhjen e informacionit, monitorimin dhe raportimin për helmimet e dyshuara nga produktet për mbrojtjen e bimëve;

c) mbledhjen e informacionit, monitorimin dhe raportimin e produkteve të paautorizuara të mbrojtjes së bimëve, duke përfshirë tregtimin e paligjshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve.

5. Në përputhje me nenin 28 të këtij ligji, disa detyra të kontrollit zyrtar të përcaktuara në këtë nen mund t'ju ngarkohen një ose më shumë personave fizikë.

Neni 23

Rregulla specifike për kontrollet zyrtare dhe aktivitetet të tjera zyrtare për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike

1. Kontrollet zyrtare për verifikimin e zbatimit të legjislacionit të parashikuar në shkronjën f) të nenit 2, pika 2 të këtij ligji, përfshijnë kontrollet zyrtare mbi prodhimin organik dhe mbi operatorët dhe individë të tjerë që i nënshtrohen atij legjislacioni.

2. Ministri me udhëzim miraton rregullat për masa praktike të unifikuara lidhur me:

a) kërkesat specifike dhe përmbajtja shtesë në Planin Kombëtar Shumëvjeçar të Kontrollit (PKSHK) të përcaktuar në nenin 90 të këtij ligji, me qëllim përgatitjen e pjesëve përfundimtare të PKSHK sipas pikës 1, të nenit 89 të këtij ligji dhe përmbajtjen specifike shtesë të raporteve vjetore të përcaktuara në nenin 93 të këtij ligji që i paraqiten ministrit;

b) metodat që do të përdoren për marrjen e mostrave dhe për analizat dhe testet laboratorike, duke përfshirë çdo rregull që përfshin përcaktimin e limiteve.

Neni 24

Rregulla specifike për kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare të kryera nga autoritetet kompetente në lidhje me emërtimet e mbrojtura të origjinës, treguesit gjeografikë të mbrojtur dhe specialitetet tradicionale të garantuara

1. Përfshirë nga pika 3 e nenit 29, në lidhje me rregullat e përmendura në shkronjën g) të pikës 2 të nenit 2, ku autoritetet kompetente kanë deleguar vendimmarrjen lidhur me autorizimin për përdorimin e emrit të regjistruar të një produkti, ato mund të delegojnë gjithashtu zbatimin e masave të mëposhtme:

- a) urdhëron që disa aktivitete të operatorit t'i nënshtrohen kontrolleve zyrtare sistematike ose të shtuara;
- b) urdhëron operatorin për të shtuar frekuencën e kontrolleve që i kryen vetë ai;
- c) urdhëron ndryshimin e etiketës me qëllim që të jetë në përputhje me specifikimet e produktit dhe rregullat e parashikuara në shkronjën g) të nenit 2, pikës 2 të këtij ligji.

2. Ministri me udhëzim miraton rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare për verifikimin e zbatimit të legjislacionit të përmendur në shkronjën g) të nenit 2, pikës 2 të këtij ligji. Këto rregulla parashikojnë:

- a) kriteret, metodat dhe teknikat e cituara në nenin 12 dhe 14 për kontrollet zyrtare që kryhen për të verifikuar përputhshmërinë me specifikimet e produktit dhe kriteret e etiketimit;
- b) metodat dhe teknikat specifike të cituara në nenin 14 për kryerjen e kontrolleve zyrtare që synojnë garantimin e gjurmueshmërisë së mallrave dhe kafshëve që janë objekt i rregullave të parashikuara në shkronjën g) të nenit 2, pikës 2 të këtij ligji, në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes, si dhe për të garantuar zbatimin e këtyre rregullave;
- c) rastet kur autoritetet kompetente duhet të marrin një ose më shumë veprime dhe masa në lidhje me shkelje specifike referuar pikës 1 dhe 2 të nenit 110.

3. Ministri me udhëzim miraton rregullat për masa praktike të unifikuara për kryerjen e kontrolleve zyrtare për të verifikuar zbatimin e legjislacionit të parashikuar në shkronjën g), të nenit 2, pika 2 të këtij ligji, për detyrimet specifike raportuese të organeve të ngarkuara.

4. Në përputhje me nenin 28 të këtij ligji, disa detyra të kontrollit zyrtar të përcaktuara në këtë nen mund t'ju ngarkohen një ose më shumë personave fizikë.

Neni 25

Rregulla specifike për kontrollet zyrtare dhe për veprimet e ndërmarra nga IPKZ në rastet e rrisqeve të reja të identifikuara në lidhje me ushqimin dhe ushqimin për kafshë

1. Kontrollet zyrtare për disa kategori të caktuara ushqimesh ose ushqimesh për kafshë me qëllim verifikimin e zbatimit të legjislacionit të parashikuar në shkronjat a) deri në d) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji, adresojnë rrisqet e identifikuara rishtazi për shëndetin e njerzve ose të kafshëve që mund të lindin nga ushqimi ose ushqimi për kafshë tek njerëzit ose, në lidhje me OMGJ-të dhe produktet e mbrojtjes së bimëve, si edhe për mjedisin, ose çdo rrezik që del nga modelet e reja të prodhimit ose konsumit të ushqimit ose ushqimit për kafshë për t'i trajtuar ato në mënyrë efektive.

2. Ministri me udhëzim miraton rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare për disa kategori ushqimesh apo ushqimesh për kafshë për të verifikuar zbatimin e legjislacionit të parashikuar në shkronjat a) deri në d) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji, dhe për veprimet që duhen marrë nga IPKZ pas kryerjes së kontrolleve të tilla zyrtare. Këto rregulla parashikojnë:

a) kriteret specifike të unifikuara për kryerjen e kontrolleve zyrtare për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe rrisqeve specifike që ekzistojnë në lidhje me çdo kategori ushqimesh dhe ushqimesh për kafshë si dhe proceseve të ndryshme që ato i nënshtrohet; dhe

b) rastet kur IPKZ në lidhje me shkelje specifike duhet të marrë një ose më shumë nga masat e parashikuara në nenet 109 pika 2 dhe 110 pika 2 të këtij ligji;

3. Ministri me udhëzim miraton rregulla për masa praktike të unifikuara në lidhje me kontrollet zyrtare që kryhen në kategori të caktuara ushqimesh ose ushqimesh për kafshë për të verifikuar zbatimin e legjislacionit të parashikuar në shkronjat a) deri në d) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji, për të adresuar duhet të adresojnë rrisqet e identifikuara rishtazi për shëndetin e njerzve ose të kafshëve që mund të lindin nga ushqimi ose ushqimi për kafshë tek njerëzit ose, në lidhje me OMGJ-të dhe produktet e mbrojtjes së bimëve, si edhe për mjedisin, ose çdo rrezik që del nga modelet e reja të prodhimit ose konsumit të ushqimit ose ushqimit për kafshë për t'i trajtuar ato në mënyrë efektive dhe të parashikojë një frekuencë minimale uniforme të kontrolleve të tilla zyrtare, ku një nivel minimal i kontrollit zyrtar është i nevojshëm për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe rrisqeve specifike që ekzistojnë në lidhje me secilën kategori të ushqimit dhe ushqimit për kafshë si dhe proceseve të ndryshme që ato i nënshtrohen.

4. Në rastet e emergjencave të papritura dhe të justifikuara për rastet e rreziqeve serioze për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose mjedisin, ministri miraton akte nënligjore që janë menjëherë të zbatueshme.

KREU III

Delegimi i detyrave të caktuara të Autoriteteve Kompetente

Neni 26 (28)

Delegimi i detyrave të caktuara të kontrollit zyrtar nga IPKZ

1. IPKZ mund t'i delegojë detyra të caktuara që i përkasin kontrolleve zyrtare, një ose më shumë trupave ose personave fizikë në përputhje me kushtet e parashikuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji. IPKZ garanton që trupa ose personi fizik i deleguar, të cilit i janë deleguar këto detyra, kanë kompetencat e nevojshme për të kryer në mënyrë efektive këto detyra.

2. Kur IPKZ vendos t'i delegojë detyra të caktuara të kontrollit zyrtar një ose më shumë trupave të deleguara, që kanë për qëllim verifikimin e zbatimit të rregullave të parashikuara në shkronjën f) të pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji, i atribuon një kod numerik identifikimi për secilin trup të deleguar si dhe caktojnë autoritetin përkatës përgjegjëse për miratimin dhe mbikëqyrjen e tyre.

Neni 27

Kushtet për delegimin e detyrave të caktuara të kontrollit zyrtar tek trupat e deleguara

Delegimi i detyrave të caktuara të kontrollit zyrtar, trupës së deleguar të parashikuar në nenin 26 pika 1 e këtij ligji, një delegim i tillë do të jetë me shkrim dhe duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

(a) delegimi përmban një përshkrim të saktë të detyrave të ngarkuara të kontrollit zyrtar që organi i deleguar mund të kryejë dhe si kushtet në të cilat ai mund t'i kryejë ato detyra;

(b) trupa e deleguar duhet të:

(i) ketë aftësitë, pajisjet dhe infrastrukturën e nevojshme për të kryer detyrat e kontrollit zyrtar që i janë deleguar;

(ii) ketë një numër të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar dhe me përvojë;

(iii) jetë i drejtë/paanshëm dhe të mos ketë asnjë konflikt interesi dhe në veçanti nuk është në një situatë që mund të ndikohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në paanshmërinë e sjelljes së tij profesionale në lidhje me kryerjen e detyrave të kontrollit zyrtar që i janë deleguar;

(iv) ushtrojë veprimtarinë e saj dhe të jetë i akredituar në përputhje me standardet përkatëse për detyrat e deleguara, duke përfshirë standardin EN ISO/IEC 17020 "Kritere për funksionimin e llojeve të ndryshme të organeve që kryejnë inspektim";

(v) ketë kompetenca të mjaftueshme për të kryer detyrat e kontrollit zyrtar që i janë deleguar; dhe

(c) mbështetet me masa që sigurojnë koordinim efikas dhe efektiv ndërmjet IPKZ deleguese dhe trupës të deleguar.

Neni 28

Kushtet për delegimin e detyrave të caktuara të kontrollit zyrtar tek personat fizikë

IPKZ mund të delegojë detyra të caktuara që i përkasin kontrolleve zyrtare një ose më shumë personave fizikë, kur rregullat e parashikuara në nenet 16 deri në 25 të këtij ligji e lejojnë atë. Një delegim i tillë duhet të jetë në përputhje me kushtet e mëposhtme:

(a) delegimi përmban një përshkrim të saktë të detyrave të ngarkuara të kontrollit zyrtar që personi fizik mund të kryejë dhe si kushtet në të cilat ai mund t'i kryejë ato detyra;

(b) Personi fizik duhet të:

(i) ka aftësitë, pajisjet dhe infrastrukturën e nevojshme për të kryer detyrat e kontrollit zyrtar që i janë deleguar;

(ii) Kanë kualifikim dhe përvojë të përshtatshme;

(iii) është i drejtë/paanshëm dhe nuk ka asnjë konflikt interesi për kryerjen e detyrave të kontrollit zyrtar që i janë deleguar dhe

(c) mbështetet me masa që sigurojnë koordinim efikas dhe efektiv ndërmjet autoriteteve kompetente deleguese dhe organit të deleguar.

Neni 29

Kushtet për delegimin e detyrave të caktuara që lidhen me aktivitete të tjera zyrtare

1. IPAT mund të delegojë detyra të caktuara në lidhje me aktivitete të tjera zyrtare tek një ose më shumë trupa të deleguara, me kusht që të përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) rregullat e parashikuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji nuk e ndalojnë një delegim të tillë; dhe

(b) janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 27 të këtij ligji, me përjashtim atyre të parashikuara në nenin 27 shkronja (b) (iv) të këtij ligji,

2. IPAT mund të delegojë detyra të caktuara në lidhje me aktivitete të tjera zyrtare tek një ose më shumë persona fizike, me kusht që të përmbushen kushtet e mëposhtme

a) rregullat e referuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji lejojnë një delegim të tillë; dhe

b) janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 28 të këtij ligji, të zbatuara mutatis mutandis.

3. IPAT nuk i delegojnë një trupe të deleguar ose një personi fizik vendimin në lidhje me detyrat e parashikuara në shkronjën b) pika 1, të nenit 110 dhe pikës 2 dhe 3 të nenit 110 të këtij ligji.

Neni 30

Detyrimet e trupave të deleguara dhe të personave fizikë

Trupat e deleguara ose personat fizikë të cilëve u janë deleguar detyra të caktuara të kontrollit zyrtar në përputhje me nenin 26 pika 1 të këtij ligji, ose u janë deleguar detyra të caktuara që lidhen me aktivitete të tjera zyrtare në përputhje me nenin 29 të këtij ligji, duhet:

(a) të raportojnë rregullisht dhe sa here që të kërkohet nga autoritetet kompetente deleguese rezultatet e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare të kryera prej tyre;

(b) të informojë menjëherë autoritetet kompetente deleguese sa herë që nga kontrolleve zyrtare rezultojnë parregullsi/shkelje ose rreziku për shkelje të mundshme, përveç rasteve

kur masat specifike të vendosura ndërmjet autoritetit kompetent dhe trupës së deleguar ose personit fizik në fjalë parashikojnë ndryshe; dhe

(c) t'u lejojë autoriteteve kompetente akses në mjediset dhe objektet e tyre dhe të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë ndihmën e tyre.

Neni 31

Detyrimet e autoriteteve kompetente deleguese

Autoritetet kompetente që i kanë deleguar trupave të deleguara ose personave fizikë detyra të caktuara të kontrollit zyrtar në përputhje me nenin 28 pika 1 të këtij ligji, ose detyra të caktuara që lidhen me aktivitete të tjera zyrtare trupave ose personave fizikë të deleguar në përputhje me nenin 31 të këtij ligji:

(a) organizojnë auditime ose inspektime të trupave ose personave të tillë, kur është e nevojshme dhe duke shmangur mbivendosjen, duke marrë parasysh çdo akreditim të parashikuar në shkronjën (b) (iv) të nenit 27 të këtij ligji;

(b) revokojnë menjëherë plotësisht ose pjesërisht delegimin kur:

(i) ka prova që një trup ose person fizik i deleguar nuk i kryen siç duhet detyrat që i janë deleguar;

(ii) trupa e deleguar ose personi fizik nuk merr masat e duhura dhe të menjëhershme për të korrigjuar mangësitë e identifikuara; ose

(iii) është demonstruar se pavarësia ose paanshmëria e trupës së deleguar ose personit fizik është cënuar.

Kjo nuk cenon kompetencën e autoriteteve kompetente për të revokuar delegimin për arsye të tjera nga ato të përmendura në këtë ligj.

Kreu IV

Marrja e mostrave, analizat, testet dhe diagnozat

Neni 32

Metodat e përdorura për marrjen e mostrave, analizat, testet dhe diagnozat

1. Metodat e përdorura për marrjen e mostrave dhe për analizat laboratorike, testet dhe diagnozat gjatë kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare janë në përputhje me legjislacionin që përcakton këto metoda ose kriteret e performancës për ato metoda.

2. Në mungesë të legjislacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe në kuadër të kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare, laboratorët zyrtarë përdorin një nga metodat e mëposhtme sipas përshtatshmërisë për nevojat e tyre specifike analitike, testuese dhe diagnostikuese:

(a) metoda të disponueshme që përputhen me rregullat ose protokollet përkatëse të njohura ndërkombëtarisht, duke përfshirë ato që janë pranuar nga Komiteti Evropian për Standardizim (CEN); ose

metodat përkatëse të zhvilluara ose të rekomanduara nga laboratorët e referencës kombëtare ose laboratorët e referencës të Bashkimit Evropian dhe të vërtetuara në përputhje me protokollet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht;

(b) në mungesë të rregullave ose protokolleve të përshtatshme, sikurse parashikohet në shkronjën (a) të pikës 2 të këtij neni, metodat përkatëse të zhvilluara ose të rekomanduara nga laboratorët kombëtarë të referencës dhe të vërtetuara në përputhje me protokollet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht ose metodat përkatëse të zhvilluara dhe të vërtetuara me studime të vlefshmërisë së metodave ndër – laboratorike ose brenda laboratorit në përputhje me protokollet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht.

3. Në rastet kur nevojiten urgjentisht kryerja e analizave laboratorike, testeve ose diagnostikimi dhe nuk ekziston asnjë nga metodat e përmendura në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, laboratorit kombëtar përkatës i referencës ose, nëse nuk ekziston një laborator kombëtar reference, çdo laborator tjetër i caktuar në përputhje me nenin 35 pika 1 të këtij ligji mund të përdorë metoda të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 1 dhe 2 të këtij neni deri në vërtetimin e një metode të përshtatshme në përputhje me protokollet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht.

4. Metodatat e përdorura për analizat laboratorike duhet të karakterizohen, sa herë që të jetë e mundur, nga kriteret përkatëse të metodave të analizave të përcaktuara në Shtojcën II të këtij ligji.

5. Mostrat merren, trajtohen dhe etiketohen në mënyrë të tillë që të sigurohet vlefshmëria e tyre ligjore, shkencore dhe teknike.

6. Ministri, me udhëzim e miraton rregulla për:

(a) metodat që do të përdoren për marrjen e mostrave dhe për analizat laboratorike, testet dhe diagnostikat;

(b) kriteret e performancës, analizat, parametrat e testimit ose diagnostikimit, pasigurinë/tolerancën e matjes dhe procedurat për vërtetimin e këtyre metodave;

(c) interpretimin e rezultateve analitike, testuese dhe diagnostikuese.

Neni 33

Opinion i dytë i Ekspertit

1. IPKZ garantojnë që operatorët, kafshët ose mallrat e të cilëve i nënshtrohen procesit të marrjes së mostrave, analizës, testimit ose diagnostikimit në kontekstin e kontrolleve zyrtare, kanë të drejtën për një opinion të dytë të ekspertit, me shpenzimet e vetë operatorit. E drejta e opinionit të dytë të ekspertit i jep operatorit mundësinë të kërkojë një rishikim të dokumentacionit të marrjes së mostrave, analizës, testit ose diagnozës nga një ekspert tjetër i njohur dhe me kualifikimet e nevojshme.

2. Kur është e përshtatshme, e zbatueshme dhe teknikisht e realizueshme, duke pasur parasysh veçanërisht përhapjen dhe shpërndarjen e rrezikut tek kafshët ose mallrat, afatin e prishjes së mostrave ose mallrave dhe sasinë e substratit të disponueshëm, IPKZ duhet:

(a) të garantojnë që, gjatë marrjes së mostrës dhe nëse kërkohet nga operatori, të merret një sasi e mjaftueshme mostre për të bërë të mundur marrjen e një opinionit të dytë të ekspertit dhe për një rishikim sipas pikës 3 të këtij neni, nëse kjo është e nevojshme; ose

(b) të informojnë operatorin kur nuk është e mundur marrja e një sasive të mjaftueshme siç parashikohet në shkronjën (a) të pikës 2 të këtij neni.

Kjo pikë nuk zbatohet kur vlerësohet prania e dëmtuesve karantinorë në bimë, produkte bimore ose objekte të tjera me qëllim verifikimin e zbatimit të legjislacionit të parashikuar në shkronjën e) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji.

3. Në rastet kur ka mosmarrëveshje ndërmjet IPKZ dhe operatorëve që bazohet në opinionin e dytë të ekspertit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, operatorët mund të kërkojnë me shpenzimet e tyre rishikimin e dokumentacionit të analizës, testit ose diagnozës fillestare dhe nëse nevojitet kryerjen e analizës, testit ose diagnozës nga një laborator tjetër zyrtar.

4. Kërkesa nga operatori për një opinion të dytë eksperti sipas pikës 1 të këtij neni nuk heqin detyrimin e IPKZ për të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të eliminuar ose kufizuar riskun lidhur me shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve, ose riskun për mirëqenien e kafshëve ose në lidhje me OMGJ-të dhe produktet për mbrojtjen e bimëve, si dhe riskun ndaj mjedisit, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin e përmendur në nenin 2 pika 2 të këtij ligji.

Neni 34

Marrja e mostrave të kafshëve dhe mallrave të tregtuara nëpërmjet komunikimit në distancë

1. Në rastin e kafshëve dhe mallrave të tregtuara nëpërmjet komunikimit në distancë, mostrat që IPKZ porositin nga operatorët duke mos zbuluar identitetin e tyre mund të përdoren për qëllime të një kontrolli zyrtar.

2. Autoritetet kompetente, pasi kanë marrë në zotërim mostrat, duhet të ndërmarrin të gjitha hapat për të garantuar që operatorët nga të cilët janë porositur këto mostra në përputhje me pikën 1 të këtij neni:

(a) informohen se mostrat në fjalë janë marrë për qëllime të një kontrolli zyrtar dhe, sipas rastit, janë analizuar ose testuar për qëllimet e këtij kontrolli zyrtar; dhe

(b) kur mostrat e përmendura në pikën 1 janë analizuar ose testuar, mund të ushtrojnë të drejtën për një opinion të dytë, sipas nenit 33 pika 1 të këtij ligji.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni, zbatohen për trupat e deleguara dhe personat fizikë të cilëve u janë deleguar detyra të caktuara të kontrollit zyrtar.

Neni 35

Caktimi i laboratorëve zyrtarë

1. Ministri me urdhër cakton laboratorët zyrtarë për të kryer analizat laboratorike, testet dhe diagnostikimet e mostrave të marra gjatë kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare, në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi.

2. Ministri mund të caktojë si laborator zyrtar një laborator të vendosur në një shtet tjetër, me kusht që të përmbushen kushtet e mëposhtme:
- (a) janë përcaktuar masat e duhura sipas të cilave mundësohet kryerja e kontrolleve dhe inspektimeve të përmendura në nenin 37 pika 1 të këtij ligji ose delegimi i kryerjes së këtyre kontrolleve dhe inspektimeve tek autoritetet kompetente të një shteti tjetër, me të cilin është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, ku ndodhet laboratori; dhe
 - (b) ky laborator është caktuar si laborator zyrtar nga autoritetet kompetente të një shteti tjetër, në territorin e të cilit ndodhet.
3. Përcaktimi i një laborator zyrtar bëhet me shkrim dhe përmbanë një përshkrim të hollësishëm të:
- (a) detyrave që kryen laboratori si laborator zyrtar;
 - (b) kushteve në të cilat ai kryen detyrat e përmendura në shkronjën a) të pikës 3 të këtij ligji; dhe
 - (c) marrëveshjeve të nevojshme për të garantuar koordinim dhe bashkëpunim efikas dhe efektiv ndërmjet laboratorit dhe autoriteteve kompetente.
4. Ministri cakton si laborator zyrtar vetëm një laborator i cili:
- (a) ka përvojën, pajisjet dhe infrastrukturën e nevojshme për të kryer analiza ose teste ose diagnoza të mostrave;
 - (b) ka një numër të mjaftueshëm personeli të kualifikuar, të trajnuar dhe me përvojë;
 - (c) garanton që detyrat që i jepen, siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni, kryhen në mënyrë të drejtë/ paanshme dhe nuk ka asnjë konflikt interesi për sa i përket ushtrimit të detyrave të tij si laborator zyrtar;
 - (ç) jep në kohën e duhur rezultatet e analizës, testit ose diagnozës së kryer në mostrat e marra gjatë kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare; dhe
 - (d) vepron në përputhje me standardin EN ISO/IEC 17025 dhe është i akredituar në përputhje me këtë standard nga një organ kombëtar akreditimi që vepron në përputhje me rregullat kombëtare për akreditimin e organeve të vlerësimit të përputhshmerisë.
5. Fusha e akreditimit të një laborator zyrtar sipas shkronjës d) të pikës 4 të këtij neni:
- a) përfshinë ato metoda të analizës laboratorike, testimit ose diagnozës që kërkohen të përdoren nga laboratori për analiza, teste ose diagnoza, kur ai funksionon në cilësinë e laboratorit zyrtar;
 - b) përfshinë një ose më shumë metoda të analizës laboratorike, testimit ose diagnostikimit ose grupe metodash;
 - c) përcaktohet në një mënyrë fleksibël, në mënyrë që të lejojë që fusha e akreditimit të përfshijë versione të modifikuara të metodave të përdorura nga laboratori zyrtar kur është dhënë akreditimi ose metoda të reja përveç atyre metodave, mbi bazën e verifikimeve të kryera nga vetë laboratorit pa një vlerësim specifik nga organi kombëtar i akreditimit përpara përdorimit të këtyre metodave të modifikuara ose të reja.
6. Kur asnjë nga laboratorët zyrtar të caktuar në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet tjetër në përputhje me pikën 1 të këtij neni nuk ka ekspertizën, pajisjet, infrastrukturën dhe

personelin e nevojshëm për të kryer analiza, teste ose diagnoza laboratorike të reja ose veçanërisht të pazakonta, ministri mund të caktojë një laborator ose qendër diagnostifikimi që nuk plotëson një ose më shumë nga kërkesat e përcaktuara në pikën 3 dhe 4 të këtij neni për të kryer ato analiza, teste dhe diagnoza.

Neni 36

Detyrimet e laboratorëve zyrtarë

1. Kur rezultatet e një analize, testi ose diagnoze të kryer në mostrat e marra gjatë kontrolleve zyrtare ose aktiviteteve të tjera zyrtare tregojnë një rrezik për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose, për sa i përket OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu për mjedisin, ose ato tregojnë për mundësinë e mospërputhjes, laboratorët zyrtarë duhet të informojnë menjëherë autoritetet kompetente që i kanë caktuar për atë analizë, test ose diagnozë dhe, sipas rastit, trupat e deleguara ose personat fizikë të cilëve u janë deleguar detyrat. Megjithatë, marrëveshjet specifike ndërmjet autoriteteve kompetente, trupave të deleguara ose personave fizikë të cilëve u janë deleguar detyrat dhe laboratorëve zyrtarë mund të specifikojnë që ky informacion mund të mos kërkohet të jepet menjëherë.
2. Laboratori i referencës ose laboratori kombëtar i referencës dhe laboratorët zyrtarë marrin pjesë në testet krahasuese ndërlaboratorike ose në testet e aftësisë që organizohen për analizat, testet ose diagnozat që ata kryejnë në cilësinë e laboratorë zyrtarë.
3. Laboratorët zyrtarë, me kërkesë të autoriteteve kompetente, vënë në dispozicion të publikut emërtimet e metodave të përdorura për analiza, teste ose diagnoza të kryera në kuadër të kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare.
4. Me kërkesë të autoriteteve kompetente, laboratorët zyrtarë duhet të tregojnë përveç rezultateve edhe metodën e përdorur për secilën analizë, provë ose diagnozë të kryer në kontekstin e kontrolleve zyrtare dhe të aktiviteteve të tjera zyrtare.

Neni 37

Auditimi i laboratorëve zyrtarë

1. Ministria organizon rregullisht auditime të laboratorëve zyrtarë që janë caktuar në përputhje me nenin 35 pika 1 të këtij ligji dhe sa herë që ata vlerësojnë se një auditim është i nevojshëm, me përjashtim të rasteve kur konstatojnë se këto auditime janë të tepërta duke marrë parasysh vlerësimin e akreditimit. të përmendur në shkronjën e) të pikës 4 të nenit 35 të këtij ligji.
2. Ministri revokon menjëherë emërtimin si laborator zyrtar, tërësisht ose vetëm për detyra të caktuara, kur ai nuk merr masa korrigjuese të përshtatshme dhe të menjëhershme pas rezultateve të një auditimi të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, të cilat konstatojnë se:
 - a) nuk plotëson kushtet e parashikuara në pikat 4 dhe 5 të nenit 35 të këtij ligji;
 - b) nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji;
 - c) nuk kryen në nivelin e duhur testet krahasuese ndërlaboratorike të parashikuara në pikën 2 të nenit 36 të këtij ligji.

Përfshirje nga detyrimi për akreditim të detyrueshëm për disa laboratorë zyrtarë

1. Në ndryshim nga shkronja e) pika 4 të nenit 35 të këtij ligji, ministri mund të caktojë laboratorët e mëposhtëm si laboratorë zyrtarë, pavarësisht nëse ata nuk plotësojnë detyrimet e parashikuara në këtë pikë, si vijon:

(a) laboratorët që:

(i) kanë si aktivitet të vetëm të tyre zbulimin e *Trichinella* në mish;

(ii) përdorin vetëm metodat e detektimit të *Trichinella* referuar legjislacionit për rregullat specifike për kontrollin zyrtar të *Trichinella* në mish;

(iii) që kryejnë zbulimin e *Trichinella* nën mbikëqyrjen e IPKZ ose të një laboratorit zyrtar të caktuar në përputhje me pikën 1 të nenit 35 të këtij ligji dhe të akredituar në përputhje me standardin EN ISO/IEC 17025 për përdorimin e metodave të parashikuara deri në Pikën 1, shkronja a (ii) të këtij neni; dhe

(iv) që marrin pjesë rregullisht dhe kanë rezultate të kënaqshme në testet krahasuese ndërlaboratorike ose të testimit të aftësisë të organizuara nga laboratorët kombëtarë të referencës për metodat që përdorin për zbulimin e *Trichinellës*;

(b) laboratorë të cilët kryejnë vetëm analiza, teste ose diagnoza në kuadër të aktiviteteve të tjera zyrtare, me kusht që:

(i) përdor vetëm metodat e analizave laboratorike, testimit dhe diagnostikimit të parashikuara në pikën 1 të nenit 32 të këtij ligji dhe shkronjat (a) ose (b) të pikës 2 të nenit 32 të këtij ligji;

(ii) kryejnë analizat, testet ose diagnozat nën mbikëqyrjen e autoriteteve kompetente ose të laboratorëve kombëtarë të referencës në lidhje me metodat që përdorin;

(iii) marrin pjesë rregullisht dhe kanë rezultate të kënaqshme në testet krahasuese ndërlaboratorike ose të testimit të aftësisë të organizuara nga laboratorët kombëtarë të referencës në lidhje me metodat që përdorin; dhe

(iv) zbatojnë një sistem të sigurimit të cilësisë për të garantuar rezultate të sakta dhe të besueshme të metodave të përdorura për analizat, testimin dhe diagnozat laboratorike.

2. Kur metodat e përdorura nga laboratorët e përmendur në shkronjën (b) të pikës 1 të këtij neni kërkojnë konfirmimin e rezultatit të analizës, testit ose diagnozës laboratorike, ky konfirmim do të kryhet nga një laborator zyrtar. Në përputhje me kërkesat e parashikuara në shkronjën e) të pikës 4 të nenit 34 të këtij ligji.

3. Laboratorët zyrtarë të caktuar sipas pikës 1 të këtij neni duhet të jenë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kompetencat për të miratuar përjashtime nga kushti për akreditimin e detyrueshëm të të gjitha metodave të analizës, testimit dhe diagnostikimit laboratorik të përdorura nga laboratorët zyrtarë

Ministri miraton me udhëzim rastet dhe kushtet kur mund të caktohenë si laboratorë zyrtarë, në përputhje me pikën 1 të nenit 35 të këtij ligji, laboratorë që nuk i plotësojnë kushtet e përmendura në shkronjën e) të pikës 4 të nenit 35 të këtij ligji, në lidhje me të gjitha metodat që përdorin për kryerjen e kontrolleve zyrtare ose aktiviteteve të tjera zyrtare, me kusht që keta laboratorë të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

(a) veprojnë dhe janë të akredituar në përputhje me standardin EN ISO/IEC 17025 për përdorimin e një ose më shumë metodave që janë të ngjashme dhe përfaqësojnë metoda të tjera që ata përdorin; dhe

(b) përdorin rregullisht dhe në mënyrë të konsiderueshme metodat për të cilat kanë marrë akreditimin e parashikuar në shkronjën a) të këtij neni, me përjashtim të fushës që rregullohet sipas parashikimeve të shkronjës e) pika 2 e nenit 2 të këtij ligji, kur nuk ekziston një metodë e vërtetuar për zbulimin e dëmtuesve të veçantë të bimëve të parashikuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 32 të këtij ligji.

Neni 40

Përjashtime të përkohshme nga detyrimi i akreditimit të detyrueshëm për laboratorët zyrtarë

1. Me përjashtim të shkronjës a) të pikës 5, të nenit 35 të këtij ligji, autoritetet kompetente mund të caktojnë përkohësisht si laborator zyrtar, një laborator zyrtar ekzistues në pajtim sipas kërkesave të pikës 1, të nenit 35 të këtij ligji për përdorimin e metodës së analizave, testeve ose diagnozave laboratorike për të cilat nuk ka marrë akreditimin e parashikuar në shkronjën e) të pikës 4, të nenit 35 të këtij ligji:

(a) nëse përdorimi i kësaj metode është një kërkesë e re e legjislacionit;

(b) kur ndryshimet në një metodë që është në përdorim kërkon një akreditim të ri ose një zgjerim të fushës për të cilën është akredituar laborator zyrtar; ose

(c) në rastet kur nevoja për përdorimin e një metode vjen si rezultat i një situatë emergjente ose rrisht të shfaqur për shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve, mirëqenien e kafshëve ose, OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe mjedisit.

2. Caktimi i përkohshëm i parashikuar në pikën 1 të këtij neni do t'i nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

a) laborator zyrtar është i akredituar në përputhje me standardin EN ISO/IEC 17025 për përdorimin e një metode të ngjashme me atë që nuk përfshihet në objektin e akreditimit të tij;

(b) zbaton një sistem të sigurimit të cilësisë për të garantuar rezultate të sakta dhe të besueshme në përdorimin e një metode për të cilën nuk është aktualisht i akredituar;

(c) analizat, testet ose diagnozat kryhen nën mbikëqyrjen e autoriteteve kompetente ose laboratorit kombëtar të referencës për atë metodë.

3. Caktimi i përkohshëm sipas pikës 1 një të këtij neni, nuk mund të jetë më i gjatë sesa 1 (një) vit. Ai mund të rinovohet një herë për një periudhë tjetër 1 (një) vjeçare.

4. Laboratorët zyrtarë të caktuar sipas pikës 1 të këtij neni duhet të jenë në territorin e Republikës së Shqipërisë

Kreu V

Kontrollet zyrtare për kafshët dhe mallrat që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë

Neni 41

Kontrollet zyrtare për kafshët dhe mallrat që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë

Kontrollet zyrtare për kafshët dhe mallrat që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë kryhen mbi bazën e rrishtit. Kontrollet zyrtare për kafshët dhe mallrat e parashikuara nga nenet 45 dhe 46 të këtij ligji kryhen në përputhje me nenet 45 deri në 62 të këtij ligji.

Seksioni I

Kafshët dhe mallrat përveç atyre që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare në pikat e kontrollit kufitar sipas seksionit II të këtij Kapitulli

Neni 42

Kontrollet Zyrtare të kafshëve dhe mallrave përveç atyre që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare në pikat e kontrollit kufitar sipas seksionit II të këtij Kapitulli

1. Për të verifikuar zbatimin e legjislacionit të parashikuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, kontrollet zyrtare kryhen rregullisht, mbi bazë rrishtit dhe me një frekuencë të përshtatshme, për kafshët dhe mallrat që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për të cilat nuk zbatohen nenet 45 dhe 46 të këtij ligji.

2. Për kafshët dhe mallrat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, frekuenca e përshtatshme e kontrolleve zyrtare përcaktohet me urdhër të ministrit, duke marrë parasysh:

(a) rrishtet që paraqiten për shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve, mirëqenien e kafshëve, OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu për mjedisin, të lidhura me lloje të ndryshme kafshësh dhe mallrash;

(b) çdo informacion që tregon mundësinë që konsumatorët mund të mashtrohen, veçanërisht në lidhje me natyrën, identitetin, vetitë, përbërjen, sasinë, qëndrueshmërinë, vendin e origjinës ose vendin e prejardhjes, metodën e përpunimit ose prodhimit të mallrave;

(c) historikun e përmbushjes së kërkesave të parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, të zbatueshëm për kafshët ose mallrat e përcaktuara:

(i) të shtetit dhe përcaktimit të origjinës ose vendit të prodhimit, nëse nevojitet;

(ii) të eksportuesit;

(iii) të operatorit përgjegjës për ngarkesën;

(ç) kontrollet që janë kryer ndërkohë mbi kafshët dhe mallrat në fjalë; dhe

(d) garancitë që autoritetet kompetente të vendit të origjinës kanë dhënë për kafshët dhe mallrat në lidhje me përputhshmërinë me kërkesat e parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji ose me kërkesa që janë pranuar të jenë të paktën ekuivalente me to.

3. Kontrollet zyrtare të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kryhen në një vend të përshtatshëm brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë:

(a) pikën e hyrjes në Republikën e Shqipërisë;

(b) Pikën e kontrollit kufitar;

(c) pikën e lëshimit në qarkullim të lirë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

(ç) magazinat dhe ambientet e operatorit përgjegjës për ngarkesën;

(d) vendin e destinacionit

4. Pavarësisht për sa parashikohet në pikat 1 dhe 3 të këtij neni, kontrollet zyrtare, të kategorive të mëposhtme, në pikat e kontrollit kufitar dhe në pikat e tjera të hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë kryhen sa herë që ka arsye për të besuar se hyrja e tyre në këtë territor mund të paraqesë një risk për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose, OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, si dhe për mjedisin:

(a) të mjeteve të transportit edhe kur janë bosh; dhe

(b) paketimin, duke përfshirë paletat.

5. Kontrollet zyrtare mund të kryhen edhe për mallrat që janë pjese e një prej procedurave doganore si lëshimi në qarkullim të lirë, procedurat e veçanta, eksporti ose magazinimi i

përkohshëm siç përcaktohet në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë, në rast se sipas legjislacionit, nevojitet një shtim i përkohshëm i kontrolleve zyrtare dhe masave emergjente të mallrave të caktuara që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 43

Llojet e kontrolleve zyrtare mbi kafshët dhe mallrat përveç atyre që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare në pikat e kontrollit kufitar sipas Seksionit II të këtij Kapitulli

1. Kur kontrollet zyrtare kryhen në përputhje me nenin 42 pika 1 të këtij ligji, ato:
 - (a) përfshijnë gjithmonë kontrollin e dokumentacionit; dhe
 - (b) përfshijnë kontrollet e identitetit dhe kontrollet fizike në varësi të rriskut që paraqesin për shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve, mirëqenien e kafshëve ose, për sa i përket OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu për mjedisin.
2. Kontrollet fizike të parashikuara në shkronjën (b) të pikës 1 të këtij neni, kryhen në kushte të përshtatshme që lejojnë kryerjen e duhur të hetimeve.
3. Kur kontrollet e dokumentacionit, kontrollet e identitetit ose kontrollet fizike të parashikuara në pikën 1 të këtij neni tregojnë se kafshët dhe mallrat nuk janë në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 1 pika 2, atëherë zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 64 pika 1), 3) dhe 5), nenet 65 , 66 dhe 67, neni 69 pika (1) dhe (2), neni 70 pika 1) dhe 2), nenet 109 dhe 110.
4. Minsitri me udhëzim miraton rastet dhe kushtet kur IPKPKK mund t'u kërkojnë operatorëve të njoftojnë mbërritjen e mallrave të caktuara që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 44

Mostrat e marra në kafshë dhe mallra përveç atyre që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare në pikat e kontrollit kufitar sipas Seksionit II të këtij Kreu

1. Kur merren mostra nga kafshët dhe mallrat, inspektori i IPKPKK, pa cenuar zbatimin e neneve 32 deri në 40 të këtij ligji:
 - (a) informon operatorët në fjalë dhe, sipas rastit, autoritetet doganore; dhe
 - (b) vendos nëse kafshët ose mallrat duhet të bllokohen deri në daljen e rezultateve të analizës, testit ose diagnozës së kryer, ose nëse ato mund lihen të lirë me kusht që të sigurohet gjurmueshmëria e kafshëve ose mallrave.
2. Ministri me udhëzim miraton:

(a) procedurat e nevojshme për të siguruar gjurmueshmërinë e kafshëve ose mallrave të parashikuara në shkronjën (b) të pikës 1 të këtij neni; dhe

(b) dokumentet që duhet të shoqërojnë kafshët ose mallrat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kur mostrat janë marrë ngainspektori i IPKPKK.

Seksion II

Kontrollet zyrtare në pikat e kontrollit kufitar për kafshët dhe mallrat

Neni 45

Kafshët dhe mallrat që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare në pikat e kontrollit kufitar

1. Për të verifikuar zbatimin e legjislacionit të parashikuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, kontrollet zyrtare kryhen në pikën e kontrollit kufitar të mbërritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, për çdo ngarkesë të kategorive të mëposhtme të kafshëve dhe mallrave:

(a) kafshë;

(b) produkte me origjinë shtazore, produkte embrionale, nënprodukte shtazore, bar i thatë, kashtë dhe produkte ushqimore që përmbajnë produkte me origjinë bimore dhe produkte të përpunuara me origjinë shtazore ("produkte të përbëra")

(c) bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera të përmendura në listat e përcaktuara në përputhje me legjislacionin për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve;

(ç) mallra nga vende të caktuara për të sipas përcaktimeve në shkronjën b) të pikës 2 të këtij neni, mbi domosdoshmërinë e marrjes së një mase që parashikon një rritje të përkohshme të kontrolleve zyrtare në hyrjen e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë për shkak të një rrisku të njohur ose të shfaqur ose për shkak se ka prova të mjaftueshme që mund të ketë një shkelje serioze e legjislacionit të parashikuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji;

(d) kafshë dhe mallra që janë subjekt i një mase emergjente të parashikuar në aktet ligjore të miratuara në përputhje me legjislacionin për ushqimin, shëndetin e kafshëve dhe për masat mbrojtëse ndaj dëmtuesve të bimëve, që kërkojnë që ngarkesat e këtyre kafshëve ose mallrave, të identifikuar me anë të kodeve të Nomenklaturës së Kombinuar, ti nënshtrohen kontrolleve zyrtare në hyrjen e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë;

(dh) kafshët dhe mallrat, kushtet dhe kriteret e futjes të të cilëve në territorin e Republikës së Shqipërisë përcaktohet me aktet nënligjore të miratuara në përputhje me nenin 98 ose 100 të këtij ligji ose me legjislacionin e parashikuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, të cilat kërkojnë që verifikimi i zbatimit të këtyre kushteve ose kriterëve të kryhet kur kafshët ose mallrat hynë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ministri me udhëzime miraton:

(a) listat që përcaktojnë të gjitha kafshët dhe mallrat e parashikuara në shkronjat a) dhe b) të pikës 1 të këtij neni, duke përcaktuar kodet e tyre të Nomenklaturës së Kombinuar; dhe

(b) listën e mallrave që i përkasin kategorisë së përmendur në shkronjën ç) të pikës 1 të këtij neni, duke përcaktuar kodet e tyre të Nomenklaturës së Kombinuar, dhe të përditësojë atë sipas nevojës për rrisqet e mësipërme.

3. ngarkesat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, mund të përfshijnë produktet e përbëra, barin e thatë, kashtën, produktet e tjera të kufizuara rreptësisht në produkte që paraqesin një rrisht të identifikuar rishtazi ose një rrisht të shtuar për shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve ose, për sa i përket OMGJ-produkteve për mbrojtjen e bimëve, si dhe mjedisin. Përfshirja e tyre në kontrollet zyrtare që kryhen në pikën e kontrollit kufitar të mbërritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë miratohet me udhëzim të ministrit.

4. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në masat ose kushtet e parashikuara në shkronjat ç), d) dhe dh) të pikës 1 të këtij neni, ky nen do të zbatohet edhe për ngarkesat e kategorive të kafshëve dhe mallrave të referuara në shkronjën a), b) dhe c) të pikës 1 të këtij neni kur janë të karakterit jotregtar.

5. Operatorët përgjegjës për ngarkesën garantojnë paraqitjen për kontrolle zyrtare në pikën e kontrollit kufitar të caktuar të kafshëve dhe mallrave që i përkasin kategorive të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 46

Kafshët dhe mallrat e përjashtuara nga kontrollet zyrtare në pikat e kontrollit kufitar

Ministri me udhëzim miraton rregullat që përcaktojnë rastet dhe kushtet kur kategoritë e kafshëve dhe mallrave të mëposhtme përjashtohen nga zbatimi i nenit 45 të këtij ligji dhe kur ky përjashtim është i justifikuar për:

(a) mallrat e dërguara si mostra tregtare ose si artikuj ekspozimi për ekspozita, të cilat nuk janë të destinuara të dalin në treg;

(b) kafshët dhe mallrat e destinuara për qëllime shkencore;

(c) mallrat në bordin e mjeteve të transportit që operojnë në rrugë ndërkombëtare, të cilat nuk shkarkohen dhe janë të destinuara për konsum nga ekuipazhi dhe pasagjerët;

(ç) mallrat që janë pjesë e bagazhit personal të pasagjerëve dhe janë të destinuara për konsum ose përdorim personal;

(d) dërgesat e vogla të mallrave që i dërgohen personave fizikë dhe që nuk janë të destinuara të dalin në treg

(dh) kafshët shtëpiake siç përcaktohet në legjislacionin për shëndetin e kafshëve;

(e) mallrat që i janë nënshtruar trajtimit specifik dhe nuk i tejkalojnë sasinë që do të përcaktohen në këto akte;

(ë) kategoritë e kafshëve ose mallrave që paraqesin një rrisht të ulët ose nuk paraqesin rrisht specifik dhe për të cilat kontrollet në pikat e kontrollit kufitar nuk janë të nevojshme.

Neni 47

Kontrollet zyrtare në pikat e kontrollit kufitar

1. Për të verifikuar zbatimin e kërkesave të parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, kontrollet zyrtare kryhen për ngarkesat e kategorive të kafshëve dhe mallrave të parashikuara në nenin 45 pika 1 të këtij ligji me mbërritjen e ngarkesës në pikën e kontrollit kufitar. Këto kontrolle zyrtare përfshijnë kontrolle të dokumentacionit, të identitetit dhe kontrolle fizike.

2. Kontrollet fizike kryhen për:

(a) kafshët, me përjashtim të kafshëve të ujit ose mishit dhe të brendshmëve e mishit të ngrënë, nga një veterinar zyrtar, i cili mund të asistohet nga një personel i trajnuar në fushën e veterinarisë në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, dhe i caktuar nga IPKPKK për këtë qëllim;

(b) kafshët e ujit, produktet me origjinë shtazore të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjën a) të këtij paragrafi, produktet embrionale ose nënprodukte shtazore, nga një veterinar zyrtar, i cili mund të asistohet nga një personel i trajnuar në fushën e veterinarisë në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, dhe i caktuar nga IPKPKK për këtë qëllim;

(c) bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, nga një zyrtar përgjegjës për shëndetin e bimëve.

3. IPKPKK kryen sistematikisht kontrollet zyrtare në pikat e inspektimit kufitar për ngarkesat e kafshëve që transportohen dhe mjeteve të transportit për të verifikuar zbatimin e kërkesave në lidhje me mirëqenien e kafshëve të parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji. IPKPIK harton procedura për t'i dhënë përparësi kontrolleve zyrtare të kafshëve që transportohen dhe për të reduktuar vonesat gjatë këtyre kontrolleve.

4. Ministri me udhëzim miraton masat praktike për mënyrën e paraqitjes të ngarkesave të kategorive të kafshëve dhe mallrave të parashikuara në nenin 45 pika (1), njësitë të transportit ose nënsubjektet e tij që mund të përbëjnë një dërgesë individuale dhe numrin maksimal të

njësive të transportit apo nënsubjekteve të secilës ngarkesë, duke marrë parasysh nevojën për të siguruar trajtimin e shpejtë dhe efikas të ngarkesave dhe kontrollet zyrtare që do të kryhen, nëse nevojitet, si dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare.

5. Ministri me udhëzim miraton rregullat që vendosin kërkesa specifike për trajnimin e personelit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni për kryerjen e kontrolleve fizike në pikat e kontrollit kufitar.

Neni 48

Certifikatat dhe dokumentet që shoqërojnë dërgesat dhe dërgesat e ndara

1. Certifikatat ose dokumentet origjinale zyrtare ose ekuivalentët elektronikë, që kërkohen nga rregullat e pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji, për të shoqëruar ngarkesat e kategorive të kafshëve dhe mallrave të parashikuara në nenin 45 pika 1 të këtij ligji, i paraqiten dhe mbahen nga inspektori i IPKPKK i pikës së kontrollit kufitar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga pika 2 e nenit 2 të këtij ligji.

2. Inspektori i IPKPKK i pikës së kontrollit kufitar i lëshon operatorit përgjegjës për ngarkesën, një kopje të njehsuar të certifikatave ose dokumenteve zyrtare të përmendura në pikën 1 të këtij neni në format letre ose elektronike ose nëse ngarkesa është e ndarë, lëshon kopje individuale të njehësuar në format letre ose elektronike për secilën certificate ose document.

3. Ngarkesat nuk ndahen derisa të kryhen kontrollet zyrtare dhe të finalizohet Dokumenti Shëndetësor i Përbashkët i Hyrjes, këtu e në vijim DSHPH, i parashikuar në nenin 54 të këtij ligji, në përputhje me nenin 54 pika 5 dhe nenin 55 të këtij ligji.

4. Ministri me udhëzim miraton rregullat që përcaktojnë rastet dhe kushtet kur është detyrueshme që DSHPH të shoqërojë ngarkesat e kategorive të kafshëve dhe mallrave, të parashikuara në nenin 55 pika 1 të këtij ligji, deri në vendin e destinacionit.

Neni 49

Rregulla specifike për kontrollet zyrtare në pikat e kontrollit kufitar

1. Ministri me udhëzim miraton rregullat për:

a) rastet dhe kushtet sipas të cilave inspektori i IPKPKK në një pike kontrolli kufitar mund të autorizojnë transportin e mëtejshëm të ngarkesave të kategorive të kafshëve dhe mallrave të përmendura në nenin 45 pika 1) në vendin e destinacionit përfundimtar, në pritje të disponueshmërisë së rezultateve të kontrolleve fizike, kur kontrolle të tilla kërkohen.

b) afatet kohore dhe masat për kryerjen e kontrolleve të dokumentacionit dhe, kur është e nevojshme, kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike të kategorive të kafshëve dhe mallrave që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare të parashikuara në nenin 45 pika 1 të këtij ligji, të cilat hyjnë në territorin e Republikës së Shqipëria nëpërmjet transportit detar ose ajror, kur këto kafshë ose mallra zhvendosen nga një anije ose avion dhe transportohen nën rregjimin e mbikëqyrjes doganore në një anije ose avion tjetër në të njëjtin port ose aeroport në përgatitje për udhëtime të mëtejshme ('dërgesa të transbortuara');

c) rastet dhe kushtet në të cilat kontrollet e identitetit dhe kontrollet fizike të ngarkesave të transbortuara dhe kafshëve që mbërrijnë nga ajri ose deti dhe që qëndrojnë në të njëjtin mjet transporti për udhëtime të tjera mund të kryhen në një pikë kontrolli kufitar të ndryshëm nga pika kufitare kur ka mbërritur në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ç) rastet dhe kushtet kur mund të autorizohet transiti i ngarkesave të kategorive të kafshëve dhe mallrave të parashikuara në nenin 45 pika 1 të këtij ligji dhe disa kontrolle zyrtare që do të kryhen në pikat e kontrollit kufitar për ngarkesa të tilla, duke përfshirë rastet dhe kushtet për ruajtjen e mallrave në magazina doganore të miratuara për këtë qëllim ose në zona të lira;

d) rastet dhe kushtet në të cilat bëhen përjashtime nga rregullat për kontrollet e identitetit dhe kontrollet fizike për dërgesat e transbortuara dhe tranzitin e ngarkesave të mallrave të parashikuara në shkronjën c) të nenit 45 pika 1) të këtij ligji.

2. Ministri me udhëzim miraton rregullat për të përcaktuar rastet dhe kushtet në të cilat zbatohen përjashtimet nga rregullat për kontrollet e dokumentacionit në lidhje me ngarkesat e transbortuara dhe tranzitin e ngarkesave të mallrave të parashikuara në shkronjën c) të nenit 45 pika 1) të këtij ligji.

Neni 50

Detajet mbi kontrollin e dokumentacionit, kontrollin e identitetit dhe kontrollin fizik

Për të garantuar zbatimin e njëtrajtshëm të neneve 47, 48 dhe 49 të këtij ligji, ministri me udhëzim miraton rregulla të detajuara për veprimet që do të kryhen gjatë dhe pas kontrolleve të dokumentacionit, kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike të të parashikuara në këto nene për të garantuar kryerjen me efikasitet të këtyre kontrolleve zyrtare.

Neni 51

Kontrollet zyrtare që nuk kryhen në pikat e kontrollit kufitar

1. Ministri me udhëzim miraton rregulla që përcaktojnë rastet dhe kushtet në të cilat:

a) kontrollet e identitetit dhe kontrollet fizike të ngarkesave të kategorive të kafshëve dhe mallrave të përmendura në nenin 45 pika 1 të këtij ligji, mund të kryhen nga autoritetet kompetente në pikat e kontrollit që janë të ndryshme nga pikat e kontrollit kufitar, me kusht

që ato pika kontrolli të jenë në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 62 pika 3 të këtij ligji dhe në aktet nënligjore të miratuara në përputhje me nenin 62 pika 4 të këtij ligji;

b) detyrat specifike të kontrollit mund të kryhen nga autoritetet doganore ose autoritete të tjera publike, për aq kohë që këto detyra nuk janë ndërkohë nën fushën e përgjegjësisë së këtyre autoriteteve, për:

i) dërgesat e parashikuara në nenin 63 pika 2 të këtij ligji;

(ii) bagazhet personale të pasagjerëve;

(iii) mallrat e blera nëpërmjet kontratave në distancë, duke përfshirë nëpërmjet telefonit ose internetit;

(iv) kafshët shtëpiake që plotësojnë kushtet e përcaktuara në legjislacionin kombëtar për lëvizjen jo-tregtare të kafshëve shtëpiake

(c) kontrollet e dokumentacionit të ngarkesave të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të parashikuara në shkronjën (c) të nenit 45 pika 1, të këtij ligji, mund të kryhen në distancë nga një pikë e kontrollit kufitar.

2. Shkronja b) pika 3 e nenit 54, shkronja a) pika 2 e nenit 57, pika 1e nenit 58, shkronjat a dhe d) pika 1 të nenit 58 dhe nenet 60 e 61 të këtij ligji zbatohet edhe për pikat e kontrollit të përmendura në shkronjën a) të pikës 1 të këtij neni.

Neni 52

Frekuenca e kontrolleve të dokumentacionit, kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike

1. Të gjitha ngarkesat e kategorive të kafshëve dhe mallrave të parashikuara në nenin 45 pika 1 të këtij ligji i nënshtrohen kontrolleve të dokumentacionit.

2. Kontrollet e identitetit dhe kontrollet fizike kryhen në ngarkesat e kategorive të kafshëve dhe mallrave të parashikuara në nenin 45 pika 1 të këtij ligji sipas një frekuencë që varet nga rrisku që paraqet çdo kafshë, mall ose kategori kafshësh ose mallrash për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose, për sa i përket OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu për mjedisin.

3. Ministri me udhëzim miraton rregullat për zbatimin uniform të normës së duhur të frekuencës, të parashikuar në pikën 2 të këtij neni. Këto rregulla garantojnë që kjo frekuencë të jetë më lartë se një frekuencë zero dhe përcaktojnë:

a) kriteret dhe procedurat për përcaktimin dhe modifikimin e normave të frekuencës së kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike që kryhen në ngarkesat e kategorive të

kafshëve dhe mallrave të parashikuaranë nenin 45 pika 1, shkronjat a), b) dhe c) të këtij ligji dhe t'i përshtatë ato në nivelin e rrikut që lidhet me këto kategori, duke pasur parasysh:

(i) informacionin e mbledhur nga sistemet e kontrollit të shteteve të tjera në përputhje me nenin 97 të këtij ligji;

(ii) rezultatin e kontrolleve të kryera nga ekspertët e Komisionit Evropian;

(iii) historikun e të dhënave të operatorëve në lidhje me zbatimin e legjislacionit të parashikuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji;

(iv) të dhënat dhe informacionet e mbledhura nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit për kontrollet zyrtare të parashikuar në nenin 103 të këtij ligji;

(v) vlerësimet shkencore të disponueshme; dhe

(vi) çdo informacion tjetër në lidhje me rriskun që lidhet me kategoritë e kafshëve dhe mallrave;

b) kushtet në të cilat Republika e Shqipërisë mund të rrisë normat e frekuencës së kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike të përcaktuara në përputhje me shkronjën a) të pikës 3 të këtij neni, për të llogaritur faktorët lokal të rriskut;

c) procedurat për të garantuar që normat e frekuencës së kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike të përcaktuara në përputhje me shkronjën a) të pikës 3 të këtij neni, zbatohen në kohë dhe në mënyrë të unifikuar.

4. Ministri me udhëzim miraton rregullat për:

a) frekuencën e kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike për kategoritë e mallrave të parashikuara në nenin 45, pika 1, shkronja d) të këtij ligji; dhe

b) frekuencën e kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike për kategoritë e kafshëve dhe mallrave të përmendura në nenin 45, pika 1, shkronjat e) dhe f) të këtij ligji, për aq kohë sa kjo nuk parashikohet në aktet e përmendura në të.

Neni 53

Vendimet për dërgesat

1. Një vendim duhet të merret nga autoritetet kompetente për çdo ngarkesë të kategorive të kafshëve dhe mallrave të parashikuara në nenin 45 pika 1 të këtij ligji, pas kryerjes së kontrolleve zyrtare, duke përfshirë kontrollet e dokumentacionit dhe kur është e nevojshme, kontrollet e identitetit dhe kontrollet fizike, për të përcaktuar nëse ngarkesa është në përputhje me legjislacionin e parashikuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji dhe, sipas rastit, me procedurën doganore në fuqi.

2. Vendimet për dërgesat merren nga:

a) veterineri zyrtar kur kanë të bëjnë me kafshë, produkte me origjinë shtazore, produkte embrionale ose nënprodukte shtazore; ose

b) zyrtari përgjegjës për shëndetin e bimëve, kur bëhet fjalë për bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera.

3. Në ndryshim nga shkronja a e pikës 2 të këtij neni, IPKPKK mund të vendosin që vendimi për dërgesat e produkteve të peshkimit, molusqeve të gjalla bivalve, ekinodermave të gjalla, tunikave të gjalla dhe gastropodëve të gjallë detarë të destinuara për konsum njerëzor, të merret nga një staf i trajnuar në mënyrën e duhur dhe që është caktuar posaçërisht nga IPKPKK në bashkëpunim me IPKZ për këtë qëllim.

Neni 54

Përdorimi i Dokumentit Shëndetësor të Përbashkët të Hyrjes, DSHPH, nga operatorët dhe nga IPKPKK

1. Për çdo ngarkesë të kategorive të kafshëve dhe mallrave të përmendura në nenin 45 pika 1 të këtij ligji, operatori përgjegjës për ngarkesën plotëson pjesën përkatëse të DSHPH, dhe ofron informacionin e nevojshëm për identifikimin e menjëhershëm dhe të plotë të dërgesës dhe destinacionin e saj.

2. Referencat në këtë ligj për DSHPH përfshijnë një referencë në ekuivalentin e tij elektronik.

3. DSHPH përdoret nga:

(a) operatorët përgjegjës për ngarkesat e kategorive të kafshëve dhe mallrave të përmendura në nenin 45 pika 1 të këtij ligji, me qëllim të njoftimit paraprak të inspektorit të IPKPKK në pikën e kontrollit kufitar për mbërritjen e këtyre ngarkesave; dhe

(b) inspektorët e IPKPKK të pikës së kontrollit kufitar, me qëllim që të:

(i) regjistrojnë rezultatin e kontroleve zyrtare të kryera dhe çdo vendim të marrë në vijim të tij, duke përfshirë vendimin për të refuzuar një ngarkesë;

(ii) komunikojë informacionin e përmendur në shkronjën (i) nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit të kontroleve zyrtare.

4. Operatorët përgjegjës për ngarkesën njoftojnë paraprakisht në përputhje me pikën (a) të pikës 3 të këtij neni, duke plotësuar dhe dorëzuar pjesën përkatëse të DSHPH në sistemin të

menaxhimit të informacionit të kontrolleve zyrtare për transmetim tek inspektorët e IPKPKK të pikës së kontrollit kufitar përpara mbërritjes fizike të ngarkesës në Shqipëri

5. inspektorët e IPKPKK të pikës së kontrollit kufitar finalizojnë DSHPH sapo:

(a) të jenë kryer të gjitha kontrollet zyrtare të kërkuara nga neni 47 pika 1) i këtij ligji;

(b) rezultatet nga kontrollet fizike, kur kërkohen të tilla kontrolle, janë të disponueshme; dhe

(c) është marrë një vendim për ngarkesën në përputhje me nenin 53 të këtij ligji dhe është regjistruar në DSHPH.

Article 55

Përdorimi i DSHPH nga autoritetet doganore

1. Vendosja dhe trajtimi i ngarkesave të kategorive të kafshëve dhe mallrave të përmendura në nenin 45 pika 1 të këtij ligji sipas një procedurë doganore, duke përfshirë hyrjen ose trajtimin në magazina doganore ose zona të lira, i nënshtrohet paraqitjes së DSHPH nga operatori përgjegjës për dërgesën tek autoritetet doganore, pa cënuar përjashtimet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji dhe rregullat e parashikuara në nenet 51 dhe 52 të këtij ligji. Në këtë fazë, DSHPH duhet të jetë finalizuar në mënyrë të rregullt nga inspektori i IPKPKK në pikën e kontrollit kufitar.

2. Autoritetet doganore:

(a) nuk lejojnë vendosjen e ngarkesës nën një procedurë doganore të ndryshme nga ajo e vendosur nga inspektori i IPKPKK në pikën e kontrollit kufitar; dhe

(b) duke respektuar përjashtimet e përmendura në nenin 46 të këtij ligji dhe rregullat e parashikuara në nenet 51 dhe 52 të këtij ligji, lejojnë futjen për një qarkullim të lirë të një ngarkese vetëm nëse paraqitet me një DSHPH i plotësuar në mënyrë të rregullt, e cila konfirmon se ngarkesa është në përputhje me rregullat në fuqi sipas nenit 2 pika 2 të këtij ligji.

3. Kur bëhet një deklaratë doganore për një ngarkesë të kategorive të kafshëve ose mallrave të përmendura në nenin 45 pika 1 të këtij ligji dhe DSHPH nuk paraqitet, autoritetet doganore bllokojnë ngarkesën dhe njoftojnë menjëherë inspektorin e IPKPKK e pikës së kontrollit kufitar. Inspektori i IPKPKK në pikën e kontrollit kufitar merr masat e nevojshme në përputhje me nenin 64 pika 6 të këtij ligji

Neni 56

Formati, afati kohor dhe rregullat specifike për përdorimin e DSHPH

Ministri me udhëzim miraton rregullat për:

(a) formatin e DSHPH dhe udhëzimet për paraqitjen dhe përdorimin e tij, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare përkatëse; dhe

b) kërkesat minimale kohore për njoftimin paraprak të ngarkesave nga operatorët përgjegjës për ngarkesën, siç parashikohet në nenin 54, pika 3 shkronja a) të këtij ligji, për t'u mundësuar inspektorit të IPKPKK në pikën e kontrollit kufitar kryerjen e kontrolleve zyrtare në mënyrë të shpejte dhe efikase.

Neni 57

Caktimi i pikave të kontrollit kufitar

Ministri me urdhër cakton pikat e kontrollit kufitar për kryerjen e kontrolleve zyrtare në një ose më shumë nga kategoritë e kafshëve dhe mallrave të përmendura në nenin 45 pika 1 të këtij ligji, në përputhje me kërkesat minimale të referuara në nenin 62 të këtij ligji.

Neni 58

Publikimi i pikave të kontrollit kufitar

1. Listat e përditësuara të pikave të kontrollit kufitar të parashikuara në nenin 57 të këtij ligji duhet të jenë të disponueshme në faqen zyrtare të IPKPKK, duke dhënë informacionin e mëposhtëm për secilën pikë të kontrollit kufitar:

(a) të dhënat e kontaktit;

(b) orarin që operon;

(c) vendndodhjen e saktë dhe nëse është një pikë hyrëse detare, ajrore, hekurudhore ose rrugore; dhe

(ç) kategoritë e kafshëve dhe mallrave të parashikuara në nenin 45 pika 1 të këtij ligji të cilat përfshihen në fushën e përcaktimit të këtij PKK.

2. Ministri me udhëzim, miraton rregulla për formatin, kategoritë, shkurtimeve e emërtimeve dhe informacione të tjera që do të përdoren në listat e pikave të kontrollit kufitar.

Neni 59

Revokimi i miratimeve dhe ripërcaktimi i subjekteve ekzistuese të kontrollit kufitar

1. Miratimi i pikave të inspektimit kufitar në përputhje me nenin 57 të këtij ligji dhe përcaktimi i pikave të hyrjes në përputhje me legjislacionin për rritjen e përkohshme të

kontrolleve zyrtare dhe masat emergjente që rregullojnë hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të mallrave të caktuara nga vende të caktuara mund të revokohet.

2. Republika e Shqipërisë mund të ripërcakton pikat e inspektimit kufitar, pikat e përcaktuara të hyrjes, pikat e hyrjes dhe pikat e para të hyrjes të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, si pika të kontrollit kufitar në përputhje me nenin 57 pika 1 të këtij ligji, me kusht që të plotësohen kërkesat minimale që parashikon neni 62 i këtij ligji.

3. Neni 57 pikat 2, 3 dhe 5 të këtij ligji nuk zbatohen për ripërcaktimin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 60

Revokimi i përcaktimit të pikës së kontrollit kufitar

1. Kur pikat e kontrollit kufitar pushojnë së përmbushuri kërkesat e parashikuara në nenin 62, ministri me urdhër:

a) revokon përcaktimin e parashikuar në nenin 57 të këtij ligji për të gjitha ose për disa kategori kafshësh dhe mallrash për të cilat është bërë përcaktimi; dhe

(b) heq ato pika të kontrollit kufitar nga listat e parashikuara në nenin 58 pika 1 të ligjit, për kategoritë e kafshëve dhe mallrave për të cilat është revokuar përcaktimi.

2. Ministria, me kërkesë, njofton Komisionin Evropian dhe autoritetet kompetente të vendeve të tjera, për revokimin e përcaktimit të një pike të kontrollit kufitar, në përputhje me pikën 1, si dhe për arsyet që qëndrojnë pas një revokimi të tillë.

3. Ministri me udhëzim miraton rastet dhe procedurat me të cilat, pikat e kontrollit kufitar për të cilat revokimi i caktimit është bërë vetëm pjesërisht, në përputhje me shkronjën (a) të pikës 1 të këtij neni mund të ricaktohet në ndryshim nga neni 59 i këtij ligji.

4. Ky nen nuk cënon kompetencën e ministrit për të vendosur mbi tërheqjen e caktimit të pikave të kontrollit kufitar për arsye të tjera nga ato të përmendura në këtë ligj.

Neni 61

Pezullimi i caktimit të pikave të kontrollit kufitar

1. Ministri me urdhër pezullon caktimin e një pike të kontrollit kufitar dhe urdhëron ndalimin e veprimtarisë të saj, për të gjitha ose për disa kategori kafshësh dhe mallrash për të cilat është bërë caktimi, në rastet kur veprimtari të tilla mund të përbëjnë një rrisk për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose, për sa i përket OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu mjedisit. Në rastet kur kemi të bëjmë me një rrisk serioz, pezullimi do të ketë efekt të menjëhershëm.

2. Pezullimi i caktimit të një pike të kontrollit kufitar reflektohet në listat që parashikon neni 58 pika 1 e këtij ligji.
3. Pezullimi shfuqizohet me urdhër të ministrit sapo të konstatohet se rrisku i parashikuar në pikën 1 nuk ekziston më.
4. Ky nen nuk çënon kompetencën e ministrit për të vendosur mbi pezullimin e caktimit të pikave të kontrollit kufitar për arsye të tjera nga ato të përmendura në këtë ligj.

Neni 62

Kërkesat minimale për pikat e kontrollit kufitar

1. Pikat e kontrollit kufitar do të vendosen në afërsi të pikës së hyrjes në Shqipëri dhe ose në një vend të caktuar nga autoritetet doganore në përputhje me legjislacionin kombëtar doganor ose në një zonë të lirë.
2. Ministri me udhëzim miraton rastet dhe kushtet në të cilat një pikë e kontrollit kufitar mund të vendoset në një distancë të ndryshme nga ajo në afërsi të pikës së hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë në rastet e kufizimeve të veçanta gjeografike.
3. Pikat e kontrollit kufitar duhet të kenë:
 - (a) një numër të mjaftueshëm stafi të kualifikuar;
 - (b) ambiente ose objekte të tjera të përshtatshme për natyrën dhe vëllimin e kategorive të kafshëve dhe mallrave që trajtojnë;
 - (c) pajisje dhe ambiente ose objekte të tjera për të lejuar kryerjen e kontrolleve zyrtare për secilën nga kategoritë e kafshëve dhe mallrave për të cilat është caktuar pika e kontrollit kufitar;
 - (ç) masat të përcaktuara për të siguruar, sipas rastit, akses në çdo pajisje, objekt dhe shërbim tjetër të nevojshëm për të zbatuar masat e marra në përputhje me nenet 63, 64 dhe 65 të këtij ligji, në rastet e dyshimit për shkelje, ngarkesat që rezultojnë më shkelje ose ngarkesa që paraqesin risk;
 - (d) masat emergjente për të siguruar funksionimin normal të kontrolleve zyrtare dhe zbatimin efektiv të masave të marra në përputhje me nenet 63, 64 dhe 65 të këtij ligji, në rastet e ngjarjeve të paparashikuara dhe të papritura.
 - (dh) teknologjinë dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin efikas të sistemit të informacionit për monitorimin e zbatimit të kontrolleve zyrtare dhe, sipas rastit, të sistemeve të tjera të

menaxhimit të informacionit të kompjuterizuar të nevojshëm për trajtimin dhe shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit;

(e) akses në shërbimet e laboratorëve zyrtarë të aftë për të ofruar rezultate analitike, testuese dhe diagnostikuese brenda afateve të duhura dhe të pajisura me mjetet e teknologjisë së informacionit të nevojshme për të siguruar futjen e rezultateve të analizave, testeve ose diagnozave të kryera në sistemin të menaxhimit të informacionit për kontrollet zyrtare, sipas rastit;

(ë) masat e duhura për trajtimin e nevojshëm të kategorive të ndryshme të kafshëve dhe mallrave dhe për të parandaluar rreziqet që mund të rezultojnë nga kontaminimi i kryqëzuar; dhe

(f) masat për të respektuar standardet përkatëse të biosigurisë për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë

4. Ministri me udhëzime përcakton rregulla të detajuara për kërkesat sipas pikës 3 të këtij neni duke marrë parasysh veçoritë specifike dhe nevojat logjistike që lidhen me kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe me zbatimin e masave të marra në në përputhje me nenin 64 pika 3 dhe 6 dhe nenin 65 të këtij ligji në lidhje me kategoritë e ndryshme të kafshëve dhe mallrave të parashikuara në nenin 45 pika 1 të këtij ligji.

5. Ministri me udhëzim miraton rastet dhe kushtet në të cilat pikat e kontrollit kufitar të përcaktuara për importin e trungjeve të papërpunuara dhe të drurit të sharruar dhe të copëtuar mund të përjashtohen nga një ose më shumë detyrime të parashikuara në pikën 3 të këtij neni duke marrë parasysh nevojat e autoriteteve kompetente të ngarkuara me kontrollet zyrtare që veprojnë nën kufizime gjeografike specifike, duke garantuar njëkohësisht efektivitetin e nevojshëm të kontrolleve.

Seksioni III

Veprime në rast dyshimi për mospërpuethshmëri dhe mospërpuethshmëri të kafshëve dhe mallrave që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë

Neni 63

Dyshimi për mospërpuethshmëri dhe kontrolle zyrtare të intensifikuara

1. Në rast dyshimi për mospërpuethshmëri të ngarkesave të kategorive të kafshëve dhe mallrave të parashikuara në nenin 42 pika 1 dhe 45 pika 1 të këtij ligji me rregullat e parashikuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, inspektori i IPKPKK kryhen kontrollet zyrtare me qëllim që të vërtetojnë ose të eliminonin këtë dyshim.

2. Ngarkesat e kafshëve dhe mallrave që nuk deklarohen nga operatorët që përbëhen nga kategori të kafshëve dhe mallrave të parashikuara në nenin 45 pika 1 të këtij ligji, do t'i

nënshtrohen kontrolleve zyrtare nga inspektori i IPKPKK kur ka arsye të besohet se këto kategori kafshësh ose mallrash janë të pranishme në ngarkesë.

3. Ngarkesat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni vendosen në bllokim zyrtar në pritje të rezultatit të kontrolleve zyrtare të parashikuara në pikat 1 dhe 2.

Aty ku është e përshtatshme, këto ngarkesa izoloohen ose karantinohen dhe kafshët strehohen, ushqehen, i jepet ujë dhe trajtohen sipas nevojës, në pritje të rezultatit të kontrolleve zyrtare.

4. Kur inspektori i IPKPKK ka arsye për të dyshuar për praktika jo të rregullta ose mashtruese nga një operator përgjegjës për ngarkesën ose nga kontrollet zyrtare ka arsye për të besuar se rregullat e përmendura në nenin 2 pika 2 të këtij ligji janë shkelur rëndë ose në mënyrë të përsëritur, përveç masave të parashikuara në nenin 64 pika 3 të këtij ligji, kur është e përshtatshme, intensifikohen kontrollet zyrtare mbi ngarkesat me origjinë ose përdorim të njëjtë.

5. IPKPKK njofton vendet e origjinës për vendimin për të kryer kontrolle zyrtare të intensifikuara, siç parashikohet në pikën 4 të këtij neni, duke treguar arsyet për vendimin e tyre.

6. Ministri përcakton me udhëzim rregullat për procedurat për kryerjen e koordinuar nga autoritetet kompetente të kontrolleve zyrtare të intensifikuara të parashikuara në pikën 4 dhe 5 të këtij neni.

Neni 64

Masat që merren në rastet e mospërpuethshmërisë në ngarkesat që hyjnë në Republikën e Shqipërisë

1. Çdo ngarkesë kafshësh ose mallrash që hyn në Republikën e Shqipërisë, e cila nuk është në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, vendoset në bllokim zyrtar dhe refuzohet të hyjë në Shqipëri.

Inspektori i IPKPKK izolon ose karantinon, sipas rastit, çdo ngarkesë dhe kafshët që i përkasin asaj do të mbahen, kujdesen ose trajtohen në kushte të përshtatshme, në pritje të një vendimi të mtejshëm. Nëse është e mundur, merret parasysh edhe interesi i ofrimit të kujdesit të veçantë për disa lloje mallrash.

2. Ministri me udhëzim miraton rregullat për masat praktike të izolimit dhe karantinës, të parashikuara në nënparagrafin e dytë të pikës 1 të këtij neni.

3. Inspektori i IPKPKK, në lidhje me ngarkesën e përmendur në pikën 1 të këtij neni, urdhëron menjëherë operatorin përgjegjës për dërgesën që:

(a) të asgjesojë ngarkesën;

(b) të ridërgojë ngarkesën jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me nenin 70 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji; ose

(c) ngarkesa t'i nënshtrohet një trajtimi të veçantë në përputhje me nenin 69 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji ose çdo masë tjetër të nevojshme për të garantuar zbatimin e rregullave të përmendura në nenin 2 pika 2 të këtij ligji dhe, sipas rastit, të dërgoj ngarkesën për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat ishte synuar fillimisht.

Çdo veprim i parashikuar në shkronjat a), b) dhe c) të pikës 3 të këtij neni kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, dhe veçanërisht përsa i përket ngarkesave të kafshëve të gjalla, duke patur si qëllim të ruanë kafshët nga çdo dhimbje, shqetësim ose vuajtje që është e parandalueshme.

Kur ngarkesa përbëhet nga bimë, produkte bimore ose objekte të tjera, shkronjat a), b) dhe c) të pikës 3 të këtij neni zbatohen ose për ngarkesën ose për lotet e saj.

Para se të urdhërojë operatorin të ndërmarrë veprime në përputhje me shkronjat a), b) dhe c) të pikës 3 të këtij neni, inspektori i IPKPKK dëgjon shpjegimet e operatorit në fjalë, përveç rasteve kur është i nevojshëm një veprim i menjëhershëm për t'iu përgjigjur një rrisku për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose, për sa i përket OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu mjedisit.

4. Kur inspektori i IPKPKK urdhëron operatorin të ndërmarrë një ose më shumë nga veprimet e përcaktuara në shkronjat a), b) ose c) të pikës 3 të këtij neni, ky inspektor, në mënyrë përjashtimore, mund të autorizojë që veprimi të ndërmerret vetëm për një pjesë të ngarkesës, me kusht që shkatërrimi i pjesshëm, ridërgimi, trajtimi i posaçëm ose masa tjetër:

(a) është i tillë që garanton përpuethshmërinë;

(b) nuk përbën rrezik për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve ose për mirëqenien e kafshëve ose, në lidhje me OMGJ-të dhe produktet për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu për mjedisin; dhe

(c) nuk pengon funksionimin e kontrollit zyrtar.

5. Inspektori i IPKPKK në pikën e kontrollit kufitar njofton menjëherë për çdo vendim për refuzimin e hyrjes së një ngarkese siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni dhe çdo urdhër të lëshuar në përputhje me pikat 3 dhe 6 të këtij neni dhe me nenin 65 të këtij ligji:

a. IPKPKK dhe IPKZ;

(b) autoritetet doganore;

(c) autoritetet kompetente të vendit të origjinës; dhe

(d) operatorin përgjegjës për ngarkesën.

Ky njoftim do të kryhet nëpërmjet sistemit elektronik për menaxhimin e informacionit të kontrolleve zyrtare.

6. Nëse një ngarkesë e kategorive të kafshëve ose mallrave të përmendura në nenin 45 pika 1 të këtij ligji nuk paraqitet për kontrollet zyrtare të parashikuara për të, ose nuk paraqitet në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 48 pikat 1 dhe 3 dhe nenit 54 pikat 1, 3 dhe 4 të këtij ligji, ose me rregullat e parashikuara të nenit 46, nenit 47 pika 4, nenit 49, nenit 51 pika 1 dhe nenit 56 të këtij ligji, autoritetet kompetente urdhërojnë që kjo ngarkesë të bllokohet ose të tërhiqet dhe të vendoset menjëherë në ndalim zyrtar. Për këto dërgesa zbatohen pikat 1, 3 dhe 5 të këtij neni.

7. Masat e përmendura në këtë nen zbatohen me shpenzimet e operatorit përgjegjës për ngarkesën.

Neni 65

Masat që merren për kafshët apo mallrat që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë nga shtete që paraqesin rrisht

Kur kontrollet zyrtare tregojnë se një ngarkesë kafshësh ose mallrash paraqet rrezik për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose, për sa i përket OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu për mjedisin, ngarkesa izolohet ose karantinohet dhe kafshët që i përkasin ngarkesës do të mbahen, përkujdesen ose trajtohet në kushte të përshtatshme në pritje të ndonjë vendimi të mëtejshëm.

Inspektori i IPKPKK në pikën e kontrollit kufitar e mbajnë ngarkesën në fjalë nën ndalim zyrtar dhe, menjëherë urdhërojnë operatorin përgjegjës për atë ngarkesë që:

(a) të asgjësojë ngarkesën në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, duke marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose mjedisin, si dhe për kafshët e gjalla, duke përfshirë veçanërisht rregullat për ti ruajtur kafshët nga çdo dhimbje, shqetësim ose vuajtje që është e mënjanueshme; ose

(b) ngarkesa t'i nënshtrohet një trajtimi të veçantë, në përputhje me nenin 69 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji.

Masat e përmendura në këtë nen zbatohen me shpenzimet e operatorit përgjegjës për ngarkesën.

Neni 66

Ndjekja e vendimeve të marra në lidhje me rastet e mospërputhshmërisë së ngarkesave që hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga vende të tjera

1. Inspektori i IPKPKK në pikat e kontrollit kufitar shpall të pavlefshme certifikatat zyrtare dhe sipas rastit dokumentet e tjera përkatëse që shoqërojnë ngarkesat të cilat i janë nënshtruar masave sipas nenit 64 pikat 3 dhe 6 dhe nenit 65 të këtij ligji.

2. Inspektori i IPKPKK mbikëqyr zbatimin e masave të urdhëruara në përputhje me nenin 64 pika 3 dhe 6 dhe nenin 65 të këtij ligji për të garantuar që ngarkesa të mos shkaktojë efekte të dëmshme për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose mjedisin, gjatë ose në pritje të zbatimit të këtyre masave.

Neni 67

Moszbatimi i masave të vendosura nga ana e operatorëve

1. Operatori përgjegjës për ngarkesën zbaton menjëherë të gjitha masat e vendosura nga inspektori IPKPKK në përputhje me nenin 64 pikat 3 dhe 6 dhe nenin 65 të këtij ligji dhe maksimumi brenda 60 ditëve nga dita kur inspektori IPKPKK ka njoftuar operatorin përkatës për vendimin e tij në përputhje me nenin 64 pika 5 të këtij ligji. Inspektori IPKPKK mund të përcaktojë një periudhë më të shkurtër se periudha prej 60 ditësh.

2. Nëse, pas përfundimit të periudhës së përmendur në pikën 1 të këtij neni, nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ana e operatorit, inspektori IPKPKK urdhëron:

(a) që ngarkesa të asgjësohet ose t'i nënshtrohet ndonjë mase tjetër të përshtatshme;

(b) në rastet e parashikuara në nenin 65 të këtij ligji, që ngarkesa të asgjësohet në objekte të përshtatshme të vendosura sa më afër pikës së kontrollit kufitar, duke marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose mjedisin.

3. Inspektori IPKPKK mund të zgjasë periudhën e përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni për kohën e nevojshme për marrjen e rezultateve të ekspertizës së dytë të parashikuar në nenin 33 të këtij ligji, me kusht që kjo të mos ketë efekte të dëmshme për njerëzit, kafshët dhe shëndetin e bimëve, mirëqenien e kafshëve ose, për sa i përket OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu mjedisit.

4. Masat e përmendura në këtë nen zbatohen me shpenzimet e operatorit përgjegjës për ngarkesën.

Neni 68

Zbatimi i unifikuar i neneve 64, 65 dhe 66

Ministri me udhëzime miraton rregulla për të garantuar zbatim të unifikuar në të gjitha pikat e kontrollit kufitar të përmendura në nenin 57 pika 1 të këtij ligji dhe pikat e kontrollit të

përmendura në nenin 51, pika 1, shkronja a) e këtij ligji, vendimet dhe masat e marra dhe urdhrat e lëshuara nga autoritetet kompetente në përputhje me nenet 64, 65 dhe 66 të këtij ligji, të cilat duhet të ndiqen nga inspektori i IPKPKK kur reagojnë ndaj situatave të zakonshme ose të përsëritura të shkeljeve ose rrishtut.

Neni 69

Trajtimi i veçantë i ngarkesave

1. Trajtimi i veçantë i ngarkesave të parashikuar në shkronjën c të nenit 64 pika 3 dhe në shkronjën b të nenit 65 të këtij ligji, sipas rastit, përfshinë:

(a) trajtimin ose përpunimin, duke përfshirë dekontaminimin, sipas rastit, por duke përjashtuar hollimin, në mënyrë që ngarkesa të jetë në përputhje me kërkesat e rregullave të parashikuara në nenin 2 pika 2, ose me kërkesat e një shteti tjetër të ri-dërgimit (kthimit); ose

(b) trajtimi në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme për konsum të sigurt të kafshëve ose njerëzve ose për qëllime të ndryshme nga konsumimi i kafshëve ose njerëzve.

2. Trajtimi i veçantë i parashikuar në pikën 1 të këtij neni:

(a) kryhet në mënyrë efektive dhe garanton eliminimin e çdo rreziku për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose, në lidhje me OMGJ-të dhe produktet për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu për mjedisin;

(b) dokumentohet dhe kryhet nën kontrollin e IPKZ; dhe

(c) respekton kërkesat e përcaktuara në rregullat e parashikuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji.

3. Ministri me udhëzim miraton kërkesat dhe kushtet në përputhje me të cilat kryhet trajtimi i veçantë i parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 70

Ri-dërgimi i ngarkesave

1. Inspektori i IPKPKK në pikat e kontrollit kufitar do të lejojë ridërgimin e ngarkesave që i nënshtrohen përmbushjes së kushteve të mëposhtme:

(a) destinacioni është dakordësuar me operatorin përgjegjës për ngarkesën;

(b) operatori përgjegjës për ngarkesën ka informuar inspektorin e IPKPKK me shkrim se autoriteti kompetent i vendit të origjinës ose, nëse është ndryshe, vendi i destinacionit është informuar për arsyet dhe rrethanat për refuzimin e hyrjes në Shqipëri të ngarkesës së kafshëve ose mallrave në fjalë;

(c) kur vendi i destinacionit nuk është vendi i origjinës, operatori ka marrë miratimin e autoritetit kompetent të atij vendi të destinacionit dhe ky autoritet kompetent ka njoftuar inspektorin e IPKPKK në Shqipëri se është i përgatitur të pranojë ngarkesën; dhe

(ç) në rastin e dërgesave të kafshëve, ridërgimi është në përputhje me kërkesat për mirëqenien e kafshëve.

2. Kushtet e përcaktuara në shkronjat b dhe c të pikës 1 të këtij neni nuk zbatohen për ngarkesat e kategorive të mallrave të përmendura në nenin 45 pika 1 shkronja c të këtij ligji.

Seksioni IV

Miratimi i kontrolleve të para-eksportit

Neni 71

Miratimi i kontrolleve të para-eksportit të kryera nga Republika e Shqipërisë

1. Në rastin e eksportit në vendet e Bashkimit Evropian, Komisioni Evropian mund të miratojë, me kërkesë të Republikës së Shqipërisë, kontrolle specifike të paraeksportit që kryhen në ngarkesat e kafshëve dhe mallrave përpara eksportit në shtetet evropiane, me qëllim verifikimin që dërgesat e eksportuara përmbushin kërkesat e rregullave të parashikuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji. Një miratim i tillë zbatohet vetëm për ngarkesat me origjinë nga Shqipëria dhe mund të jepet për një ose më shumë kategori kafshësh ose mallrash.

2. Ministria është përgjegjëse për kontaktet me autoritetet e vendeve të Bashkimit Evropian BE-se dhe garanton që çdo ngarkesë që kontrollohet të shoqërohet me certifikatë zyrtare të vlefshme .

Seksioni VI

Masa të veçanta

Neni 72

Rregullat për kontrolle zyrtare specifike dhe për masat që merren në vijim të kryerjes së këtyre kontrolleve

1. Ministri me udhëzim miraton rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare specifike dhe masat në rastet e shkeljeve, duke marrë parasysh veçoritë e kategorive të mëposhtme të kafshëve dhe mallrave ose masat dhe mjetet e transportit të tyre për:

(a) ngarkesat e produkteve të freskëta të peshkimit të zbarkuara drejtpërdrejt në portet e përcaktuara nga një anije peshkimi që mban flamurin e një shteti tjetër;

(b) ngarkesat e kafshë të egër pa hequr lëkurën, me gëzof;

- c) ngarkesat e kategorive të mallrave të përmendura në nenin 45, pika 1, shkronja b të këtij ligji, të cilat dorëzohen, me ose pa magazinim në magazina doganore të miratuara posaçërisht ose në zona të lira, në anijet që dalin nga Shqipëria dhe të destinuara për furnizim ose konsum nga ekuipazhi dhe pasagjerët;
- (ç) materiali i paketimit prej druri;
- (d) ushqimin që shoqëron kafshët dhe i destinuara për ushqimin e këtyre kafshëve;
- (dh) kafshët dhe mallrat e blera nëpërmjet kontratave në distancë dhe të dorëzuara nga një shtet tjetër në një adresë në Shqipëri, dhe kërkesat e njoftimit të nevojshme për të lejuar kryerjen e duhur të kontrolleve zyrtare;
- (e) produktet bimore të cilat, për shkak të destinacionit të tyre të mëvonshëm, mund të rrisin rriskun e përhapjes së sëmundjeve infektive ose ngjitëse të kafshëve;
- ë) ngarkesat e kategorive të kafshëve dhe mallrave të përmendura në nenin 45, pika 1, shkronjat a, b dhe c të këtij ligji, me origjinë nga Shqipëria dhe kthehen në Shqipëri pas refuzimit të hyrjes nga një shtet tjetër;
- (f) mallrat që hyjnë në Shqipëri me shumicë nga një shtet tjetër, pavarësisht nëse të gjitha kanë origjinë nga ai shtet;
- (g) kafshët dhe mallrat e përjashtuara nga neni 45 në përputhje me nenin 46 të këtij ligji.

2. Ministri me udhëzim miraton:

- a) kushtet për monitorimin e transportit dhe mbërritjes së ngarkesave të kafshëve dhe mallrave të caktuara, nga pika e kontrollit kufitar të mbërritjes deri në përcaktimin e vendit të destinacionit.
- (b) modelin e certifikatave zyrtare dhe rregullave për lëshimin e këtyre certifikatave; dhe
- c) formatin e dokumenteve që shoqërojnë kategoritë e kafshëve ose mallrave të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Kreu VI

Financimi i kontrolleve zyrtare dhe i aktiviteteve të tjera zyrtare

Neni 73

Rregulla të përgjithshme

1. Buxheti i shtetit alokon burime të mjaftueshme financiare për sigurimin e stafit dhe burimeve të tjera të nevojshme për autoritetet kompetente për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare.

2. Ky kre zbatohet edhe në rastin e delegimit të detyrave të caktuara të kontrollit zyrtar dhe aktiviteteve të tjera zyrtare në përputhje me nenet 26 dhe 29 të këtij ligji.

Neni 74

Tarifat ose pagesat e detyrueshme

1. IPKPKK mbledh pagesat ose tarifat për kontrollet zyrtare të kryera në lidhje me veprimtaritë e parashikuara në Kreun II të Shtojcës III dhe për kafshët dhe mallrat e përmendura në nenin 45 pika 1, shkronjat (a), (b) dhe (c) të këtij ligji, në pikat e kontrollit kufitar ose në pikat e kontrollit të parashikuar në nenin 51 pika 1, germa (a) të këtij ligji, ose;

- a) në nivelin e kostos së llogaritur në përputhje me nenin 77 pika 1 të këtij ligji; ose
- (b) në vlerën e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. IPKZ mbledh pagesat ose tarifat për të rikuperuar kostot që ato kanë në lidhje me:

(a) kontrollet zyrtare të kryera mbi kafshët dhe mallrat e përmendura në nenin 45, pika 1, shkronjat ç, d dhe dh të këtij ligji;

(b) kontrollet zyrtare të kryera me kërkesë të operatorit, për të marrë miratimin e biznesit të stabilimenteve të ushqimit për kafshë.

(c) kontrollet zyrtare që nuk ishin planifikuar fillimisht dhe të cilat:

(i) janë bërë të nevojshme pas konstatimit të një rasti shkeljeje nga i njëjti operator, gjatë një kontrolli zyrtar të kryer në përputhje me këtë ligj; dhe

(ii) kryhen për të vlerësuar shkallën dhe ndikimin e rastit të shkeljes ose për të verifikuar që shkelja është korrigjuar.

3. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni, shuma e pagesave ose tarifave në lidhje me veprimtaritë e përcaktuara në Kreun II të Shtojcës III, mbi baza objektive dhe jodiskriminuese, mund të reduktohet, duke marrë parasysh:

(a) interesat e operatorëve me xhiro të ulët;

(b) metodat tradicionale të përdorura për prodhim, përpunim dhe shpërndarje;

(c) nevojat e operatorëve të vendosur në rajone që i nënshtrohen kufizimeve gjeografike specifike; dhe

ç) të dhënat mbi historikun e operatorëve për respektimin e rregullave përkatëse të parashikuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, të konstatuar nga kontrollet zyrtare.

4. Këshilli i Ministrave mund të vendosë që pagesat dhe tarifat e llogaritura në përputhje me nenin 77, pika 1, shkronja b të mos mbledhen nën një limit të caktuar të shumës që e bën

joekonomike mbledhjen e kësaj pagese ose tarife, duke marrë parasysh koston e mbledhjes dhe të ardhurat e përgjithshme të pritura nga pagesat dhe tarifat

5. Ky nen nuk zbatohet për kontrollet zyrtare të kryera për të verifikuar zbatimin e rregullave të parashikuara në shkronjat (f) dhe (g) të nenit 2 pika 2 të këtij ligji.

Neni 75

Pagesa ose tarifa te tjera

Autoritetet kompetente mund të mbledhin pagesa ose tarifa për të mbuluar kostot e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare të ndryshme nga ato pagesa ose tarifa të parashikuara në nenin 74 të këtij ligji, përveç rasteve kur ndalohet nga dispozitat legislative të zbatueshme në fushat që rregullohen nga rregullat e parashikuara në nenin 2 pika 2 e këtij ligji.

Neni 76

Kostot

Pagesat ose tarifat që mbledhen në përputhje me nenin 74 pika 1, shkronja (a) dhe nenin 74 pika 2 të këtij ligji, përcaktohen në bazë të kostove të mëposhtme, për aq sa këto rezultojnë nga kontrollet zyrtare në fjalë:

(a) pagat e personelit, duke përfshirë personelin mbështetës dhe administrativ, i përfshirë në kryerjen e kontrolleve zyrtare, shpenzimet e sigurimeve shoqërore, pensionet dhe sigurimet shëndetësore e tyre;

(b) koston e objekteve dhe pajisjeve, duke përfshirë kostot e mirëmbajtjes dhe sigurimit dhe kostot e tjera shoqëruese;

(c) koston e materialeve të konsumit dhe pajisjeve;

(ç) koston e shërbimeve që u ngarkohen autoriteteve kompetente nga trupat e deleguara për kontrollet zyrtare të deleguara këtyre trupave të deleguara;

(d) koston e trajnimit të personelit të përmendur në shkronjën (a) të këtij neni, me përjashtim të trajnimit të nevojshëm për të marrë kualifikimin e nevojshëm për t'u punësuar nga autoritetet kompetente;

(dh) koston e udhëtimit të personelit të përmendur në shkronjën (a) të këtij neni, si dhe shpenzimet përkatëse të fjetjes dhe ushqimit;

(e) koston e marrjes së mostrave dhe të analizave laboratorike, testimit dhe diagnostikimit të përcaktuar nga laboratorët zyrtarë për këto detyra.

Llogaritja e tarifave ose pagesave

1. Pagesat ose tarifat e mbledhura në përputhje me nenin 74 pika 1 shkronja a) dhe nenin 74 pika 2 të këtij ligji përcaktohen në përputhje me një nga metodat e mëposhtme të llogaritjes ose një kombinim të tyre:

(a) në një tarifë fikse në bazë të kostove të përgjithshme të kontrolleve zyrtare të përballuara nga autoritetet kompetente për një periudhë të caktuar kohore, dhe të aplikuara për të gjithë operatorët, pavarësisht nëse është kryer ndonjë kontroll zyrtar gjatë periudhës së referencës në lidhje me çdo operator subjekt i tarifës; në përcaktimin e nivelit të tarifave që do të mblidhet për çdo sektor, aktivitet dhe kategori operatorësh, autoritetet kompetente marrin parasysh ndikimin që lloji dhe madhësia e aktivitetit në fjalë, si dhe ndikimin që kanë faktorët e rrisqeve mbi shpërndarjen e kostove të përgjithshme të këtyre kontrolleve zyrtare; ose

(b) në bazë të llogaritjes së kostove aktuale të çdo kontrolli zyrtar individual, dhe të aplikuara për operatorët që i nënshtrohen këtij kontrolli zyrtar.

2. Për llogaritjen e pagesave ose tarifave të parashikuara në nenin 74 pika 1, shkronja a) dhe nenin 74 pika 2 të këtij ligji, merren parasysh shpenzimet e udhëtimit, të parashikuara në nenin 76, shkronja dh) të këtij ligji në një mënyrë që të mos ketë diskriminim ndërmjet operatorëve në bazë të distancës së vendndodhjes së tyre nga ajo e autoriteteve kompetente.

3. Kur pagesat ose tarifat llogariten në përputhje me shkronjën a) të pikës 1 të këtij neni, pagesat ose tarifat e mbledhura nga autoritetet kompetente nuk duhet të kalojnë kostot e përgjithshme të akumuluar për kontrollet zyrtare të kryera gjatë periudhës kohore të përmendur në të.

4. Kur pagesat ose tarifat llogariten në përputhje me shkronjën (b) të pikës 1 të këtij neni, ato nuk duhet të kalojnë koston reale të kontrollit zyrtar të kryer.

Mbledhja dhe aplikimi i pagesave ose tarifave

1. Një operator ngarkohet me një pagesë ose tarifë për një kontroll zyrtar dhe për një aktivitet tjetër zyrtar të kryer në bazë të një ankese, nëse ky kontroll sjell konfirmimin e mospërputhshmërisë.

2. Pagesat ose tarifat e mbledhura në përputhje me nenet 74 dhe 75 të këtij ligji nuk rimbursohen drejtpërdrejt ose tërthorazi, përveç rasteve kur mblidhen në mënyrë të padrejtë.

3. Ministri me urdhër mund të vendosë që pagesat ose tarifat të mblidhen nga autoritete të ndryshme nga autoritetet kompetente ose nga trupat e deleguara.

Neni 79
Pagesa e tarifave

1. Autoritetet kompetente sigurojnë që operatorët të marrin, sipas kërkesës, dëshminë e pagesës së tarifave ose pagesave, në rast se operatorët nuk kanë akses tjetër në një provë të tillë.
2. Tarifat ose pagesat e mbledhura në përputhje me nenin 74 pika 1 të këtij ligji paguhet për ngarkesën, nga operatori përgjegjës ose përfaqësuesi i tij.

Neni 80
Transparenca

1. Një nivel i lartë transparence sigurohet për:
 - (a) tarifat ose pagesat e parashikuara në nenin 74 pika 1 shkronja a), nenin 74 pika 2 dhe nenin 75 të këtij ligji, përkatësisht për:
 - (i) metodën dhe të dhënat e përdorura për të vendosur këto tarifa ose pagesa;
 - (ii) vlerën e tarifave ose pagesave, të aplikuara për secilën kategori operatorësh dhe për secilën kategori të kontrolleve zyrtare ose aktiviteteve të tjera zyrtare;
 - (iii) zbërthimin e kostove, sipas nenit 76 të këtij ligji;
 - (b) identitetin e autoriteteve ose organeve përgjegjëse për mbledhjen e tarifave ose pagesave.
2. Çdo autoritet kompetent vendos në dispozicion të publikut informacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni për çdo periudhë referimi dhe kostot e autoritetit kompetent për të cilat kërkohet një tarifë ose pagesë në përputhje me nenin 74 pika 1, shkronja a), nenin 74 pika 2 dhe nenin 75 të këtij ligji.
3. Për metodat e përgjithshme të përdorura për llogaritjen e tarifave ose pagesave të parashikuara në nenin 74 pika 1 shkronja (a), nenin 74 pika 2 dhe nenin 75 të këtij ligji, duhet të konsultohen palët e interesuara përkatëse.

KREU VII

Certifikimi zyrtar

Neni 81
Kërkesat e përgjithshme në lidhje me certifikimin zyrtar

1. Certifikimi zyrtar rezulton në lëshimin e:
 - a) certifikatave zyrtare; ose
 - b) vërtetimeve zyrtare, në rastet e parashikuara në rregullat e parashikuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji.

2. Kur autoritetet kompetente delegojnë detyra të caktuara në lidhje me lëshimin e certifikatave zyrtare ose vërtetimeve zyrtare, ose për mbikëqyrjen zyrtare të përmendur në nenin 86 pika 1 të këtij ligji, ky delegim duhet të jetë në përputhje me nenet 26 deri në 31 të këtij ligji.

Neni 82

Certifikatat zyrtare

Nenet 83, 84 dhe 85 të këtij ligji zbatohen:

(a) kur rregullat e referuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji kërkojnë lëshimin e një certifikate zyrtare; dhe

(b) për certifikatat zyrtare që janë të nevojshme për qëllime të eksportimit të ngarkesave të kafshëve dhe mallrave në vende të tjera.

Neni 83

Nënshkrimi dhe lëshimi i certifikatave zyrtare

1. Certifikatat zyrtare lëshohen nga autoritetet kompetente.

2. Autoritetet kompetente caktojnë zyrtarët certifikues, të cilët janë të autorizuar të nënshkruajnë certifikatat zyrtare dhe sigurojnë që këta zyrtarë:

a) janë të paanshëm, të lirë nga çdo konflikt interesi, dhe në veçanti nuk janë në një situatë që mund të ndikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi në paanshmërinë e sjelljes së tyre profesionale në lidhje me atë që vërtetohet; dhe

(b) kanë marrë trajnimin e duhur për rregullat me të cilat vërtetohet pajtueshmëria nëpërmjet një certifikate zyrtare dhe për vlerësimin teknik të pajtueshmërisë me këto rregulla si dhe me rregullat përkatëse të përcaktuara në këtë ligj.

3. Certifikatat zyrtare nënshkruhen nga zyrtari certifikues dhe lëshohen mbi bazën e një prej arsyeve të mëposhtme:

a) njohurive të drejtpërdrejta nga zyrtari certifikues për faktet dhe të dhënat e përditësuara të rëndësishme për certifikimin që është marrë nëpërmjet:

(i) një kontrolli zyrtar; ose

(ii) marrjes së një certifikate tjetër zyrtare të lëshuar nga autoritetet kompetente;

b) fakteve dhe të dhënave relevante për certifikimin, njohuritë e të cilave janë konstatuar nga një person tjetër i autorizuar për këtë qëllim nga dhe që vepron nën kontrollin e autoriteteve kompetente, me kusht që zyrtari certifikues të mund të verifikojë saktësinë e këtyre fakteve dhe të dhënave;

(c) fakteve dhe të dhënave relevante për certifikimin, të cilat janë marrë nga sistemet e kontrollit të vetë operatorëve, të plotësuara dhe të konfirmuara me rezultatet nga kontrollet e

rregullta zyrtare, ku zyrtari certifikues është i bindur se janë plotësuar kushtet për lëshimin e certifikatës zyrtare.

4. Certifikatat zyrtare nënshkruhen nga zyrtari certifikues dhe lëshohen vetëm në bazë të shkronjës a të pikës 3 të këtij neni, kur këtë e kërkojnë rregullat e përmendura në nenin 2 pika 2 të këtij ligji.

Neni 84

Garancitë e besueshmërisë për certifikatat zyrtare

1. Certifikatat zyrtare:

- (a) mbajnë një kod unik;
- (b) nuk nënshkruhen nga zyrtari certifikues, kur janë bosh ose të paplota;
- (c) hartohen në gjuhën shqipe si dhe në një ose më shumë nga gjuhët zyrtare të vendeve të përfshira në tregti, të kuptueshme nga zyrtari certifikues dhe, sipas rastit, në një nga gjuhët zyrtare të vendit të destinacionit;
- (ç) janë autentike dhe të sakta;
- (d) lejojnë identifikimin e personit që i ka nënshkruar dhe datën e lëshimit; dhe
- (dh) lejojnë verifikimin e lehtë të lidhjeve ndërmjet certifikatës, autoritetit lëshues dhe ngarkesës, lotit ose kafshës individuale ose mallit të mbuluar nga certifikata.

2. Autoritetet kompetente marrin të gjitha masat e duhura për të parandaluar lëshimin e certifikatave zyrtare false ose mashtruese ose abuzimin me certifikatat zyrtare.

Neni 85

Kompetencat zbatuese lidhur me certifikatat zyrtare

Ministri me udhëzim miraton rregullat për zbatimin uniform të neneve 83 dhe 84 të këtij ligji, lidhur me:

- a) certifikatat zyrtare model dhe rregullat për lëshimin e këtyre certifikatave, kur kërkesat nuk janë të përcaktuara në rregullat e përmendura në nenin 2 pika 2 të këtij ligji;
- b) mekanizmat dhe masat teknike për të siguruar lëshimin e certifikatave zyrtare të sakta dhe të besueshme dhe për të parandaluar rrezikun e mashtrimit;
- c) procedurat që duhen ndjekur në rastin e tërheqjeve të certifikatave zyrtare dhe për lëshimin e certifikatave zëvendësuese;
- ç) rregullat për prodhimin e kopjeve të njësuara të certifikatave zyrtare;
- d) formatin e dokumenteve që duhet të shoqërojnë kafshët dhe mallrat, pasi të jenë kryer kontrollet zyrtare;

dh) rregullat për lëshimin e certifikatave elektronike dhe për përdorimin e nënshkrimeve elektronike.

Neni 86

Vërtetimet zyrtare

1. Kur ky ligj ose rregullat e referuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji kërkojnë lëshimin e vërtetimeve zyrtare nga operatorët nën mbikëqyrjen zyrtare të autoriteteve kompetente, ose nga vetë autoritetet kompetente, zbatohen pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni.
2. Vërtetimet zyrtare:
 - a) janë autentike dhe të sakta;
 - b) hartohen në gjuhën shqipe si dhe në një ose më shumë nga gjuhët zyrtare të vendeve të përfshira në tregti, të kuptueshme nga zyrtari certifikues dhe, sipas rastit, në një nga gjuhët zyrtare të vendit të destinacionit;
 - c) kur ato lidhen me një ngarkesë ose një lot, lejojnë verifikimin e lidhjes midis vërtetimit zyrtar dhe asaj dërgese ose loti.
3. Autoritetet kompetente sigurojnë që personeli që kryen kontrolle zyrtare të mbikëqyrë lëshimin e vërtetimeve zyrtare ose, kur vërtetimet zyrtare lëshohen nga autoritetet kompetente, personeli i përfshirë në lëshimin e atyre vërtetimeve zyrtare:
 - a) janë të paanshëm, të lirë nga çdo konflikt interesi dhe në veçanti nuk janë në një situatë që mund të ndikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi në paanshmërinë e sjelljes së tyre profesionale në lidhje me atë që vërtetohet nga vërtetimet zyrtare; dhe
 - b) kanë marrë trajnimin e duhur mbi:
 - (i) rregullat me të cilat vërtetohet pajtueshmëria nga vërtetimet zyrtare dhe për vlerësimin teknik të pajtueshmërisë me këto rregulla;
 - (ii) rregullat përkatëse të përcaktuara në këtë ligj.
4. Autoritetet kompetente kryejnë kontrolle të rregullta zyrtare për të verifikuar që:
 - a) operatorët që lëshojnë certifikata përmbushin kushtet e përcaktuara në rregullat e përmendura në nenin 2 pika 2; dhe
 - b) vërtetimi lëshohet në bazë të fakteve dhe të dhënave përkatëse, të cilat janë të sakta dhe të verifikueshme.

Neni 87

Caktimi i laboratorëve kombëtarë referencë

1. Ministri me urdhër cakton një ose më shumë laboratorë kombëtarë reference për secilin laborator reference të Bashkimit Evropian. Ministri mund të caktojë një laborator kombëtar referencë edhe në rastet kur nuk ekziston një laborator reference përkatës në Bashkimin Evropian.
2. Kërkesat e përcaktuara në shkronjën (d) të pikës 4 të nenit 35, pikës 5 të nenit 35, nenit 37 dhe pikës 1 të nenit 40, shkronjat (a) dhe (b) të pikës 2 të nenit 40-dhe pikës 3 të nenit 40,

zbatohen për laboratorët kombëtarë referencë.

Përfundimisht nga shkronja (d) e pikës 4 të nenit 35, për fushën e rregulluar nga rregullat e përcaktuara në shkronjën (e) të pikës 2 të nenit 2, ministri mund të caktojë laboratorë zyrtarë, mbi bazën e një përfundimi të miratuar sipas nenit 39, si laboratorë kombëtarë referencë, pavarësisht nëse ata plotësojnë ose jo kushtin e përcaktuar në shkronjën (d) të pikës 4 të nenit 35.

3. Laboratorët kombëtarë të referencës:

- (a) janë të paanshëm, të lirë nga çdo konflikt interesi dhe, në veçanti, nuk janë në një situatë që mund të ndikojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në paanshmërinë e sjelljes së tyre profesionale në përmbushjen e detyrave si laborator referencë kombëtare;
- (b) kanë, ose të kenë akses kontraktual, në staf të kualifikuar dhe me trajnim të përshtatshëm në teknika analitike, testuese dhe diagnostikuese në fushën e tyre të kompetencës, si dhe në staf mbështetës sipas nevojës;
- (c) posedojnë, ose kanë akses në, infrastrukturën, pajisjet dhe produktet e nevojshme për të kryer detyrat që u janë caktuar;
- (ç) sigurojnë që stafi i tyre dhe çdo staf i angazhuar me kontratë kanë njohuri të mira mbi standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Zhvillimet më të fundit në kërkimin shkencor në nivel kombëtar, të Bashkimit Evropian dhe ndërkombëtar merren parasysh në punën e tyre;
- (d) janë të pajisur me, ose kanë akses në, pajisjet e nevojshme për të përmbushur detyrat e tyre në situata emergjente; dhe
- (dh) kur është e aplikueshme, janë të pajisur për të respektuar standardet përkatëse të biosigurisë.

4. Autoriteti Kompetent Qëndror:

- (a) publikon në faqen zyrtare të internetit emrin dhe adresën e çdo laborator kombëtar referencë;
- (b) bën të disponueshme për publikun informacionin e përmendur në shkronjën (a); dhe
- (c) përditëson informacionin e dhënë në shkronjën (a) sa herë që është e nevojshme.

5. Nëse ka më shumë se një laborator kombëtar referencë për një laborator referencë të Bashkimit Evropian, autoriteti kompetent qëndror siguron që këta laboratorë të bashkëpunojnë ngushtësisht, për të garantuar koordinim efikas ndërmjet tyre, me laboratorët kombëtarë të tjerë dhe me laboratorin referencë të BE-së.

6. Ministri me udhëzim miraton kërkesat për laboratorët kombëtarë të referencës, përveç atyre të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 88

Detyrat dhe përgjegjësitë e laboratorëve kombëtarë të referencës

1. Laboratorët kombëtarë të referencës, në fushën e tyre të kompetencës:

- (a) bashkëpunojnë me laboratorët e referencës së Bashkimit Evropian dhe marrin pjesë në kurse trajnimi dhe në teste krahasuese ndër-laboratorike të organizuara nga këta laboratorë;
- (b) koordinojnë aktivitetet e laboratorëve zyrtarë të caktuar në përputhje me nenin 35-pika

(1), me synimin për të harmonizuar dhe përmirësuar metodat e analizës laboratorike, testimin ose diagnostikimin dhe përdorimin e tyre;

(c) kur është e përshtatshme, organizojnë teste krahasuese ndër-laboratorike ose teste aftësie midis laboratorëve zyrtarë, sigurojnë ndjekjen e duhur të këtyre testeve dhe informojnë autoritetet kompetente mbi rezultatet e tyre dhe vijimin;

(ç) sigurojnë shpërndarjen te autoritetet kompetente dhe laboratorët zyrtarë të informacionit të dhënë nga laboratorit i referencës së Bashkimit Evropian;

(d) ofrojnë, brenda fushës së misionit të tyre, asistencë shkencore dhe teknike për autoritetet kompetente për zbatimin e PKSHK të përmendura në nenin 89 dhe të programeve të koordinuara të kontrollit të miratuara në përputhje me nenin 92;

(dh) kur është e zbatueshme, validojnë reagentët dhe seritë e reagentëve, hartojnë dhe përditësojnë listat e substancave dhe reagentëve referencë të disponueshëm, si dhe të prodhuesve dhe furnizuesve të tyre;

(e) kur është e nevojshme, zhvillojnë kurse trajnimi për stafin e laboratorëve zyrtarë të caktuar sipas nenit 35 pika (1); dhe

(ë) ndihmojnë në mënyrë aktive autoritetin kompetent përkatës, në diagnostikimin e shpërthimeve të sëmundjeve ushqimore, zoonotike apo sëmundjeve të kafshëve ose dëmtuesve të bimëve, dhe në rastet e mospërputhshmërisë së dërgesave, duke kryer diagnoza konfirmuese, karakterizime dhe studime epizootike ose taksonomike mbi izolatet e patogjenëve ose mostrat e dëmtuesve.

2. Ministri miraton urdhëra për caktimin e detyrave dhe përgjegjësi për laboratorët kombëtarë të referencës, përveç atyre të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

TITULLI III

PLANIFIKIMI DHE RAPORTIMI

Neni 89

Planet kombëtare shumëvjeçare të kontrollit (PKSHK) dhe organi i ngarkuar për PKSHK

1. Kontrollët zyrtarë të rregulluara nga ky ligj kryhen nga autoritetet kompetente në bazë të një PKSHK, përgatitja dhe zbatimi i të cilit koordinohet për të gjithë territorin. PKSHK miratohet me urdhër të ministrit.

2. Ministri me urdhër cakton një autoritet të vetëm, i cili ngarkohet të:

(a) koordinojë të gjitha autoritetet kompetente përgjegjëse për kontrollët zyrtarë për përgatitjen e PKSHK;

- (b) sigurojë që PKSHK është koherent;
- (c) mbledhë informacion mbi zbatimin e PKSHK në funksion të paraqitjes së raportit vjetor të përmendur në nenin 93 të këtij ligji dhe rishikimin dhe përditësimin e tij, sipas nevojës, në përputhje me nenin 91 pika 2 të këtij ligji.

Neni 90

Përmbajtja e PKSHK-ve

1. PKSHK-të përgatiten në mënyrë që të sigurohet që kontrollet zyrtare janë planifikuar në të gjitha fushat që rregullohen nga rregullat e përmendura në nenin 2 pika 2 të këtij ligji dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji dhe rregullat e parashikuara në nenet 16 deri në 25 të këtij ligji.
2. PKSHK-të përmbajnë informacion të përgjithshëm mbi strukturën dhe organizimin e sistemeve të kontrollit zyrtar në Republikën e Shqipërisë në secilën prej fushave të mbuluara dhe përmbajnë minimalisht informacion në lidhje me:
 - (a) objektivat strategjike të PKSHK dhe se si prioritizimi i kontrolleve zyrtare dhe shpërndarja e burimeve reflektojnë këto objektiva;
 - (b) kategorizimin e riskut të kontrolleve zyrtare;
 - (c) caktimin e autoriteteve kompetente, në nivel qendror, rajonal dhe vendor dhe detyrat e tyre, si dhe burimet në dispozicion të këtyre autoriteteve;
 - (ç) kur është e përshtatshme, delegimin e detyrave tek trupat e deleguara;
 - (d) organizimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të kontrolleve zyrtare në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, përfshirë kontrollet zyrtare në stabilimentet individuale;
 - (dh) sistemet e kontrollit të zbatuara në sektorë të ndryshëm dhe koordinimin ndërmjet shërbimeve të ndryshme të autoriteteve kompetente përgjegjëse për kontrollet zyrtare, në këta sektorë;
 - (e) procedurat dhe masat e vendosura për të siguruar respektimin e detyrimeve të autoriteteve kompetente të parashikuara në nenin 5 pika 1 të këtij ligji;
 - (ë) trajnimin e personelit të autoriteteve kompetente;
 - (f) dokumentimin e procedurave, sipas parashikimeve në nenin 12 pika 1 të këtij ligji;
 - (g) organizimin e përgjithshëm dhe funksionimin të planeve të emergjencës, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji.

Neni 91

Përgatitja, përditësimi dhe rishikimi i PKSHK-ve

1. PKSHK i parashikuar në pikën 1 të nenit 89 të këtij ligji, të vihet në dispozicion të publikut, me përjashtim të atyre pjesëve të planit, zbulimi i të cilave mund të dëmtojë efektivitetin e kontrolleve zyrtare.

2. PKSHK përditësohet rregullisht për ta përshtatur atë me ndryshimet në rregullat e përmendura në nenin 2 pika 2 të këtij ligji dhe duhet të rishikohet për të marrë parasysh të paktën faktorët e mëposhtëm:

- (a) shfaqjen e sëmundjeve të reja, dëmtuesve të bimëve ose rreziqeve të tjera për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose, në rastin e OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, rreziqet për mjedisin;
- (b) ndryshime të rëndësishme në strukturën, drejtimin ose funksionimin e autoriteteve kompetente;
- (c) rezultatin e kontrolleve zyrtare;
- ç) rezultatet e auditimeve të kryera nga Komisioni Evropian;
- (d) gjetjet shkencore; dhe
- (dh) rezultatin e kontrolleve zyrtare të kryera nga autoritetet kompetente të vendeve të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 92

Programet e koordinuara të kontrollit dhe mbledhja e informacionit dhe e të dhënave

1. Për të kryer një vlerësim të synuar të gjendjes së zbatimit të rregullave të parashikuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji ose për të përcaktuar përhapjen e disa rreziqeve në të gjithë territorin e vendit, Ministri, miraton udhëzime në lidhje me:

- (a) zbatimin e programeve të koordinuara të kontrollit me kohëzgjatje të kufizuar në një nga fushat që rregullohen nga rregullat e parashikuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji;
- (b) organizimin *ad hoc* të mbledhjes së të dhënave dhe informacionit në lidhje me zbatimin e një kategorie të caktuar rregullash, të përmendura në nenin 2 pika 2 të këtij ligji ose në lidhje me përhapjen e rreziqeve të caktuara.

Neni 93

Raportet vjetor

1. Brenda datës 31 gusht të çdo viti, përgatitet raporti dhe i paraqitet ministrit, në lidhje me:

- (a) çdo ndryshim të bërë në PKSHK, duke marrë parasysh faktorët e përmendur në nenin 91 pika 2 të këtij ligji;
- (b) rezultatin e kontrolleve zyrtare të kryera në vitin e kaluar në kuadër të PKSHK-së përkatëse;
- (c) llojin dhe numrin e rasteve të mospërpuethshmërisë me rregullat e përmendura në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, të evidentuara në vitin paraardhës nga autoritetet kompetente, sipas fushave;
- (ç) masat e marra për të siguruar zbatimin efektiv të PKSHK-së përkatëse, duke përfshirë masat e marra dhe rezultatet e këtyre masave, dhe

(d) një lidhje (link) me faqen e internetit të autoritetit kompetent që përmban informacion publik për tarifat ose detyrimet e referuara në nenin 80 pika 2 të këtij ligji.

2. Për të siguruar uniformitet në paraqitjen e raporteve vjetore, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ministri, miraton dhe përditëson sipas nevojës formularët model standard për dërgimin e informacionit dhe të dhënave të referuara në atë paragraf.

Neni 94

Planet e kontigjencës për ushqimin dhe ushqimin për kafshë

1. Për zbatimin e planit të përgjithshëm për menaxhimin e krizave të parashikuar në legjislacionin për ushqimin, Ministria harton plane kontigjence për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, duke përcaktuar masat që duhen zbatuar pa vonesë, në rastet kur konstatohet se ushqimi ose ushqimi për kafshë përbëjnë një rrezik serioz për shëndetin e njerëzve ose kafshëve, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet mjedisit.

2. Planet e kontigjencës për ushqimin dhe ushqimin për kafshë të parashikuara në pikën 1 të këtij neni përcaktojnë:

- (a) autoritetet kompetente që përfshihen;
- (b) kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve të përmendura në shkronjën a) të kësaj pike; dhe
- (c) mjetet dhe procedurat për ndarjen e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe palëve të tjera të interesuara, sipas rastit.

3. Planet e kontigjencës për ushqimin dhe ushqimin për kafshë rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në organizimin e autoriteteve kompetente dhe përvojën e fituar nga zbatimi i planit dhe ushtrimeve simuluese.

4. Ministri miraton udhëzime në lidhje me:

- (a) rregullat për hartimin e planeve të kontigjencës, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, në masën e nevojshme për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm dhe efektiv të planit të përgjithshëm për menaxhimin e krizave të parashikuar në legjislacionin për ushqimin; dhe
- (b) rolin e palëve të përfshira në hartimin dhe zbatimin e planeve të kontigjencës.

Neni 95

Kontrolli nga Komisioni Evropian

1. Autoritetet kompetente kontrollohen rregullisht nga ekspertët e Komisionit Evropian mbi :

- (a) verifikimin e zbatimit të rregullave të përmendura në nenin 2 pika 2 dhe ato të parashikuara në këtë ligj;

(b) verifikimin e funksionimit të sistemeve kombëtare të kontrollit në fushat që mbulohen nga rregullat e përmendura në nenin 2 pika 2 e këtij ligji si dhe ato që parashikohen në këtë ligj si dhe të autoriteteve kompetente që operojnë me to;

(c) investigimin dhe mbledhjen e të dhënave:

(i) kontrollet zyrtare dhe praktikat e zbatimit në fushat që rregullohen nga rregullat e përmendura në nenin 2 pika 2 dhe ato të parashikuara në këtë ligj;

(ii) probleme të rëndësishme ose të përsëritura me aplikimin ose zbatimin e rregullave të përmendura në nenin 2 pika 2;

(iii) situatat emergjente, problemet e shfaqura ose zhvillimet e reja në fushat që rregullohen nga rregullat e përmendura në nenin 2 pika 2 dhe ato të parashikuara në këtë ligj.

Neni 96

Detyrimet lidhur me kontrollin nga Komisioni Evropian

Autoritetet kompetente:

(a) ndërmarrin masa të përshtatshme ndjekëse për të korrigjuar çdo mangësi specifike ose sistemike të identifikuar përmes kontrolleve të kryera nga ekspertët e Komisionit Evropian në përputhje me nenin 95 pika 1;

(b) ofrojnë ndihmën e nevojshme teknike dhe vënë në dispozicion dokumentacionin e disponueshëm, përfshirë rezultatet e auditimeve të përmendura në nenin 6, me kërkesë të justifikuar, si dhe çdo mbështetje tjetër teknike që kërkojnë ekspertët e Komisionit Evropian për t'i mundësuar atyre të kryejnë kontrollet në mënyrë efikase dhe efektive; dhe

(c) ofrojnë ndihmën e nevojshme për të siguruar që ekspertët e Komisionit Evropian të kenë akses në të gjitha ambientet ose pjesët e ambienteve, kafshët dhe mallrat, si dhe në informacionin, përfshirë sistemet kompjuterike, që janë të rëndësishme për realizimin e detyrave të tyre.

KREU II

Kushtet për hyrjen në Republikën e Shqipërisë të kafshëve dhe mallrave

Neni 97

Informacion mbi sistemet e kontrollit të vendeve të tjera

1. Autoriteti Kompetent Qëndror mund t'u kërkojë vendeve që synojnë të eksportojnë kafshë dhe mallra në Republikën e Shqipërisë të japin informacionin të saktë dhe të përditësuar mbi organizimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të sistemeve të kontrollit sanitar dhe fitosanitar në territorin e tyre, në lidhje me:

- (a) çdo rregull sanitar ose fitosanitar të miratuar ose propozuar brenda territorit të tyre;
- (b) procedurat e vlerësimit të riskut dhe faktorët e marrë në konsideratë për vlerësimin e rreziqeve dhe për përcaktimin e nivelit të duhur të mbrojtjes sanitare ose fitosanitare;
- (c) çdo procedurë dhe mekanizëm kontrolli dhe inspektimi, duke përfshirë, sipas rastit, edhe për kafshët ose mallrat që vijnë nga vende të tjera ;
- (ç) mekanizmat zyrtarë të certifikimit;
- (d) sipas rastit, rezultatet e kontrolleve të kryera mbi kafshët dhe mallrat që synohen të eksportohen në Republikën e Shqipërisë; dhe
- (dh) kur është e nevojshme, informacion mbi ndryshimet e bëra në strukturën dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit, të miratuara për të përmbushur kërkesat ose rekomandimet sanitare ose fitosanitare të lëna nga kontrollet e ushtruara nga Komisioni Evropian.

2. Kërkesa për informacion e përmendur në pikën 1 të këtij neni duhet të jetë proporcionale, me natyrën e kafshëve dhe mallrave që eksportohen në Republikën e Shqipërisë dhe situatën specifike dhe strukturën në vendin eksportues.

Neni 98

Vendosja e kushteve shtesë për hyrjen e kafshëve dhe mallrave në Republikën e Shqipërisë

1. Kushtet shtesë që plotësojnë kafshët dhe mallrat që hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga vende të tjera, të cilat janë të nevojshme për të garantuar që kafshët dhe mallrat janë në përputhje me kërkesat përkatëse të përcaktuara nga rregullat e referuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, me përjashtim të nenit 2 pika 2, shkronjat (ç), (d), (e) dhe (ë) të këtij ligji ose me kërkesa të njohura si të paktën të barasvlershme me to, miratohen me udhëzim të ministrit.

2. Kushtet e referuara në pikën 1 të këtij neni identifikojnë kafshët dhe mallrat duke iu referuar kodeve të tyre nga Nomenklatura e Kombinuar dhe mund të përfshijnë:

- (a) kërkesën që disa kafshë dhe mallra hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga një vend ose rajon i një vendi, i cili figuron në një listë të hartuar nga autoriteti kompetent qendror, dhe miratuar me urdhër nga ministri, për këtë qëllim;
- (b) kërkesën që ngarkesat e disa kafshëve dhe mallrave të caktuara nga vende të tjera të dërgohen nga, dhe të merren ose të përgatiten në stabilimente, të cilat janë në përputhje me kërkesat përkatëse të përmendura në pikën 1 të këtij neni ose me kërkesat e njohura si të paktën ekuivalente me to;
- (c) kërkesën që ngarkesat e kafshëve dhe mallrave të caktuara, të shoqërohen nga një certifikatë zyrtare, një vërtetim zyrtar ose nga çdo dëshmi tjetër që dërgesat përputhen me kërkesat përkatëse të përmendura në pikën 1 të këtij neni ose me kërkesat e njohura si të paktën ekuivalente me to, duke përfshirë rezultatet e analizave të kryera nga një laborator i akredituar;
- (ç) detyrimin për të siguruar dëshmitë e përmendura në shkronjën c) të pikës 2 të këtij neni, në përputhje me një format të caktuar;

(d) çdo kërkesë tjetër të nevojshme për të siguruar që disa kafshë dhe mallra ofrojnë një nivel mbrojtjeje të shëndetit dhe, për sa i përket OMGJ-ve, gjithashtu të mjedisit, të ngjashëm me atë të siguruar nga kërkesat e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Rregullat për formatin dhe llojin e certifikatave zyrtare, vërtetimeve zyrtare ose provave të kërkuara në përputhje me rregullat e parashikuara në shkronjën c të pikës 2 të këtij neni miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 99

Përfshirja në listë për të lejuar importin nga vende të tjera në Republikën e Shqipërisë

1. Përfshirja e një vendi ose rajoni të tij në listën e përmendur në shkronja a, pika 2 të nenit 98 të këtij ligji, bëhet në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Ministri me udhëzim miraton kërkesën që i dërgohet për qëllimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni nga shteti në fjalë, shoqëruar me provat e duhura dhe garancitë që kafshët dhe mallrat në fjalë nga ai vend janë në përputhje me kërkesat përkatëse të parashikuara në nenin 98 pika 1 të këtij ligji ose me kërkesat e barazvlefshme me to.

3. Miratimi i kërkesës të përmendur në pikën 2 të këtij neni, bëhet duke marrë parasysh, sipas rastit:

(a) legjislacionin e vendit në sektorin në fjalë;

(b) strukturën dhe organizimin e autoriteteve kompetente të vendit dhe shërbimeve të tyre të kontrollit, kompetencat e tyre, garancitë që mund të jepen në lidhje me zbatimin dhe respektimin e legjislacionit të vendit, të zbatueshëm për sektorin në fjalë, dhe besueshmërinë të procedurave zyrtare të certifikimit;

(c) kryerjen nga autoritetet kompetente të vendit të kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera të përshtatëshme për të vlerësuar praninë e rreziqeve për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, për mirëqenien e kafshëve ose, në lidhje me OMGJ-të dhe produktet për mbrojtjen e bimëve, si edhe për mjedisin;

(ç) rregullsinë dhe shpejtësinë e informacionit të dhënë nga vendi, për praninë e rreziqeve për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, për mirëqenien e kafshëve ose, në lidhje me OMGJ-të dhe produktet për mbrojtjen e bimëve, si edhe për mjedisin;

(d) garancitë e dhëna nga vendi që:

(i) kushtet e zbatuara në stabilimentet nga të cilat eksportohen kafshët ose mallrat janë në përputhje me kërkesat e barasvlershme me ato të parashikuara në nenin 98 pika 1 të këtij ligji;

(ii) është hartuar dhe përditësohet një listë e stabilimenteve të përmendura në pikën (f) të kësaj shkronje;

(iii) stabilimentet e përmendura në pikën (f) të këtij neni janë objekt i kontrolleve të rregullta dhe efektive nga autoritetet kompetente të vendit;

(dh) konstatimet e kontrolleve të kryera nga autoriteti kompetent i atij vendi;

(e) çdo informacion ose të dhënë tjetër mbi kapacitetet e vendit për të siguruar që në Republikën e Shqipërisë të hyjnë vetëm kafshë ose mallra që ofrojnë të njëjtin ose një nivel

të barabartë mbrojtjeje me atë të parashikuar nga kërkesat përkatëse të përcaktuara në nenin 98 pika 1 të këtij ligji.

4. Ministri me urdhër heq nga lista e përmendur në shkronjën a) pika 2 të nenit 98 të këtij ligji referencën për një shtet ose rajon të një vendi, kur nuk plotësohen më kushtet për përfshirje në listë. Në këtë rast zbatohet procedura e referuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 100

Masa të veçanta për hyrjen e kafshëve dhe mallrave të caktuara në territorin e Republikës së Shqipërisë

1. Kur, në raste të tjera, përveç atyre të përmendura në ligjin për ushqimin dhe ligjin për shëndetin e kafshëve, ka prova se hyrja në Republikën e Shqipërisë e disa kafshëve ose mallrave me origjinë nga një vend tjetër, një rajon i tij ose një grup vendesh të tjera, përbën një rrezik për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve ose, për sa i përket OMGJ-ve, edhe për mjedisin, ose kur ka prova që po ndodh një mospërputhje e serioze me rregullat e përmendura në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, ministri me udhëzim miraton masat e nevojshme për të frenuar një rrezik të tillë ose për t'i dhënë fund mospërputhshmërisë së identifikuar.

2. Masat e përmendura në pikën 1 të këtij neni identifikojnë kafshët dhe mallrat duke iu referuar kodeve të tyre nga Nomenklatura e Kombinuar dhe përfshijnë:

(a) ndalimin e hyrjes në Republikën e Shqipërisë të kafshëve dhe mallrave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, me origjinë ose të dërguar nga vendet e tjera përkatëse ose rajonet e tyre;

(b) kërkesën që kafshët dhe mallrat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, me origjinë ose të dërguara nga disa vende të tjera ose rajone të tyre, t'i nënshtrohen, para dërgimit, trajtimit ose kontrolleve specifike;

(c) kërkesën që kafshët dhe mallrat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, me origjinë ose të dërguara nga disa vende të tjera ose rajone të tyre, t'i nënshtrohen trajtimit ose kontrolleve specifike, me hyrjen në Republikën e Shqipërisë;

(ç) kërkesën që ngarkesat e kafshëve dhe mallrave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, me origjinë ose të dërguara nga disa vende të tjera ose rajone të tyre, të shoqërohen nga një certifikatë zyrtare, një vërtetim zyrtar ose nga çdo dëshmi tjetër që ngarkesa është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga rregullat e përcaktuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji ose me kërkesa të njohura si të paktën të barasvlershme me to;

(d) kërkesën që provat e përmendura në pikën 2, shkronja ç) të këtij neni të sigurohen në përputhje me një format të caktuar;

(dh) masa të tjera të nevojshme për të frenuar rrezikun.

3. Për miratimin e masave të përmendura në pikën 2 të këtij neni, merren parasysh:

(a) informacionin e mbledhur në përputhje me nenin 97 të këtij ligji;

(b) çdo informacion tjetër që kanë dhënë vendet e tjera në fjalë; dhe

(c) kur është e nevojshme, rezultatet e kontrolleve të Komisionit Evropian.

4. Në bazë të arsyeve thelbësore urgjente, të justifikuara siç duhet për sa i përket shëndetit të njerëzve dhe shëndetit të kafshëve ose, për sa i përket OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu edhe për mbrojtjen e mjedisit, ministri miraton me urdhër masa, të zbatueshme menjëherë.

Neni 101

Barazvlefshmëria

1. Në fushat që rregullohen nga rregullat e referuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, me përjashtim të shkronjave (ç), (d), (e) dhe (ë) të nenit 2 pika 2, ministri, me anë të akteve nënligjore, pranon se masat e zbatuara në një vend tjetër ose në rajone të tij, janë të barasvlershme me kërkesat e përcaktuara në këto rregulla, në bazë të një shqyrtimi të plotë të informacionit dhe të dhënave të ofruara nga vendi tjetër në fjalë në përputhje me nenin 97 pika 1 e këtij ligji; dhe

2. Aktet nënligjore të përmendura në pikën 1 të këtij neni përcaktojnë masat praktike për hyrjen e kafshëve dhe mallrave në Republikën e Shqipërisë nga shteti tjetër në fjalë, ose rajone të tij, dhe përfshijnë:

(a) natyrën dhe përmbajtjen e certifikatave ose vërtetimeve zyrtare që duhet të shoqërojnë kafshët ose mallrat;

(b) kërkesat specifike të zbatueshme për hyrjen në Republikën e Shqipërisë të kafshëve ose mallrave dhe kontrollet zyrtare që do të kryhen në hyrje në Republikën e Shqipërisë;

(c) kur është e nevojshme, procedurat për hartimin dhe ndryshimin e listave të rajoneve ose stabilimenteve në vendin tjetër në fjalë, nga të cilat lejohet hyrja e kafshëve dhe mallrave në Republikën e Shqipërisë.

3. Kur nuk plotësohet më ndonjë prej kushteve për njohjen e ekuivalencës, ministri, shfuqizon pa vonesë aktet nënligjore të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

KREU III

Trajnimi i stafit të autoriteteve kompetente dhe autoriteteve të tjera

Neni 102

Trajnimi dhe shkëmbimi i stafit

1. Autoriteti kompetent qëndror organizon aktivitete trajnimi për personelin e autoriteteve kompetente, dhe sipas rastit, për personelin e autoriteteve të tjera të përfshira në hetimin e shkeljeve të mundshme të këtij ligji dhe të rregullave të përcaktuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji.

2. Aktivitetet e trajnimit të përmendura në pikën 1 të këtij neni mundësojnë zhvillimin e një qasjeje të harmonizuar ndaj kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare. Ato përfshijnë, sipas rastit, trajnim për:

- (a) këtë ligj dhe rregullat e përcaktuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji;
- (b) metodat dhe teknikat e kontrollit, të zbatueshme për kontrollet zyrtare dhe për aktivitetet e tjera zyrtare të autoriteteve kompetente;
- (c) metodat dhe teknikat e prodhimit, përpunimit dhe marketingut.
3. Veprimtaritë e trajnimit të përmendura në pikën 1 të këtij neni mund të jenë të hapura dhe për personelin e autoriteteve kompetente të vendeve të tjera dhe mund të organizohen jashtë Republikës së Shqipërisë.
4. Autoritetet kompetente sigurojnë që njohuritë e marra nga aktivitetet e trajnimit të përmendura në pikën 1 të këtij neni, të qarkullohen sipas nevojës dhe të përdoren në mënyrë të përshtatshme në aktivitetet e trajnimit të personelit të përmendura në nenin 5 pika 4 të këtij ligji.
- Aktivitetet e trajnimit që synojnë përhapjen e njohurive të tilla përfshihen në programet e trajnimit të referuara në nenin 5 pika 4 të këtij ligji.
5. Autoriteti kompetent mund të organizojë, në bashkëpunim me vende të tjera, programe për shkëmbimin e personelit të autoriteteve kompetente që kryejnë kontrolle zyrtare ose aktivitete të tjera zyrtare ndërmjet dy ose më shumë vendeve.
- Një shkëmbim i tillë mund të bëhet përmes dërgimit të përkohshëm të personelit të autoriteteve kompetente nga vende të tjera ose përmes shkëmbimit të personelit të tillë ndërmjet autoriteteve kompetente përkatëse.
6. Rregullat për organizimin e veprimtarive të trajnimit të përmendura në pikën 1 të këtij neni dhe të programeve të përmendura në pikën 5 të këtij neni, miratohen me urdhër nga ministri.

KREU IV

Sistemi i menaxhimit të informacionit

Neni 103

Sistemi i menaxhimit të informacionit për kontrollet zyrtare

1. Ministria, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, krijon dhe menaxhon një sistem elektronik të menaxhimit të informacioni për kontrollet zyrtare (SMIKZ) për funksionimin e integruar të mekanizmave dhe mjeteve përmes të cilave menaxhohen, trajtohen dhe shkëmbehen automatikisht të dhënat, informacionet dhe dokumentet në lidhje me kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtar.

2. Përpunimi i të dhënave personale nga autoritetet kompetente nëpërmjet SMIKZ dhe ndonjë prej përbërësve të tij kryhet vetëm për qëllime të kryerjes së kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e referuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji.

Neni 104

Funksionalitetet e përgjithshme të SMIKZ

Sistemi i menaxhimit të informacionit për kontrollet zyrtare:

(a) lejon trajtimin dhe shkëmbimin e kompjuterizuar të informacionit, të dhënave dhe dokumenteve të nevojshme për kryerjen e kontrolleve zyrtare, që rezultojnë nga kryerja e kontrolleve zyrtare ose regjistrimi i kryerjes ose rezultatit të kontrolleve zyrtare në të gjitha rastet kur ky ligj, rregullat e përcaktuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji ose aktet nënligjore të parashikuara në nenet 18 deri në 25 të këtij ligji parashikojnë shkëmbimin ndërmjet autoriteteve kompetente dhe sipas rastit me autoritetet e tjera dhe operatorët, të këtyre informacioneve, të dhënave dhe dokumenteve;

(c) siguron një mjet për mbledhjen dhe menaxhimin e raporteve mbi kontrollet zyrtare të dërguara në Ministri nga autoritetet kompetente;

(ç) lejon prodhimin, trajtimin dhe transmetimin, përfshirë në formë elektronike, nëse është e aplikueshme, të regjistrimit të udhëtimit, të të dhënave të marra nga sistemi i navigimit, të certifikatave zyrtare dhe të DSHPH të referuara në nenin 54 të këtij ligji; dhe

(d) integron, nëse është e aplikueshme, sistemet ekzistuese të kompjuterizuara të menaxhuara nga autoritetet kompetente dhe të përdorura për shkëmbimin e shpejtë të të dhënave, informacionit dhe dokumenteve në lidhje me rreziqet për shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve, kafshëve dhe shëndetin e bimëve, të përcaktuara nga legjislacioni për ushqimin, legjislacioni për shëndetin e kafshëve dhe legjislacionin për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve dhe siguron lidhjet e duhura ndërmjet këtyre sistemeve dhe komponentëve të tjerë të tij.

Neni 105

Përdorimi i SMIKZ në rastin e kafshëve dhe mallrave që i nënshtrohen disa kontrolleve zyrtare

1. Në rastin e kafshëve ose mallrave, lëvizja ose vendosja në treg brenda territorit të Republikës së Shqipërisë e të cilave u nënshtrohet kërkesave ose procedurave specifike të përcaktuara nga rregullat e referuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, SMIKZ i mundëson autoriteteve kompetente në vendin e dërgimit dhe autoriteteve të tjera kompetente përgjegjëse për kryerjen e kontrolleve zyrtare mbi ato kafshë ose mallra për të shkëmbyer, në kohë reale, të dhëna, informacione dhe dokumente në lidhje me kafshët ose mallrat që zhvendosen nga vendi i dërgimit në vendin e destinacionit dhe mbi kontrollet zyrtare të kryera.

Paragrafi i parë i kësaj pike nuk zbatohet për mallrat që i nënshtrohen rregullave të përcaktuara në shkronjat (e) dhe (ë), pika 2 të nenit 2 të këtij ligji.

2. Në rastin e kafshëve dhe mallrave të eksportuara, për të cilat zbatohen rregullat në lidhje me lëshimin e certifikatës së eksportit, SMIKZ do t'u mundësojë autoriteteve kompetente vendase dhe autoriteteve të tjera kompetente përgjegjëse për kryerjen e kontrolleve zyrtare të shkëmbejnë në kohë reale të dhënat, informacionet dhe dokumentet në lidhje me këto kafshë dhe mallra dhe rezultatin e kontrolleve të kryera mbi ato kafshë dhe mallra.

3. Në rastin e kafshëve ose mallrave që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare të përmendura në nenet 42 deri në 62 të këtij ligji, SMIKZ ose sistem tjetër i zbatueshëm:

(a) i mundëson autoriteteve kompetente në pikat e kontrollit kufitar dhe autoriteteve të tjera kompetente përgjegjëse për kryerjen e kontrolleve zyrtare mbi ato kafshë ose mallra të shkëmbejnë në kohë reale të dhëna, informacione dhe dokumente në lidhje me ato kafshë dhe mallra dhe mbi kontrollet e kryera mbi ato kafshë ose mallra;

(b) i mundëson autoriteteve kompetente në pikat e kontrollit kufitar të ndajnë dhe shkëmbejnë të dhëna, informacione dhe dokumente përkatëse me autoritetet doganore dhe autoritetet e tjera përgjegjëse për kryerjen e kontrolleve mbi kafshët ose mallrat që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë nga vende të tjera, si dhe me operatorët e përfshirë në procedurat e hyrjes, në përputhje me rregullat e miratuara në bazë të nenit 15 pika 4 dhe rregullave të tjera përkatëse; dhe

(c) mbështet dhe zbaton procedurat e referuara në nenin 52 pika 3 dhe në nenin 63 pika 6 të këtij ligji.

4. SMIKZ, për qëllim të këtij neni, do të integrohet në sistemin TRACES të Bashkimit Evropian përpara anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. *Neni 106 (134)*

Funksionimi i sistemit të menaxhimit të informacionit të kontrollit zyrtar

Këshilli i Ministrave miraton rregullat për funksionimin e sistemit të menaxhimit të informacionit të kontrollit zyrtar, të cilat parashikojnë:

(a) specifikimet teknike të sistemit dhe përbërësve të tij, duke përfshirë mekanizmin elektronik ose të tjerë të shkëmbimit të të dhënave për shkëmbimet me sistemet ekzistuese kombëtare, identifikimin e standardeve të aplikueshme, përcaktimin e strukturave të mesazheve, fjalorët e të dhënave, shkëmbimin e protokolleve dhe procedurave;

(b) rregullat specifike për funksionimin e sistemit dhe të përbërësve të tij për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e shkëmbimit të informacionit;

(c) rregullat specifike për funksionimin dhe përdorimin e sistemit dhe të përbërësve të tij, duke përfshirë rregullat për përditësimin dhe krijimin e lidhjeve të nevojshme ndërmjet sistemeve të referuara në nenin 104 shkronja e dhe në nenin 105 pika 4 të këtij ligji;

(ç) masat e emergjencës që do të zbatohen në rast të mosdisponueshmërisë së ndonjë prej funksioneve të sistemit;

(d) nëse është e aplikueshme, rastet dhe kushtet në të cilat vendeve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare të interesuara mund t'u jepet akses i pjesshëm në funksionalitetet e sistemit dhe rregullimet praktike të një aksesit të tillë;

(dh) rastet dhe kushtet e përdorimit të sistemit për transmetimin e të dhënave, informacioneve dhe dokumenteve;

(e) nëse është e aplikueshme, rregullat në lidhje me një sistem elektronik sipas të cilit certifikatat elektronike të lëshuara nga autoritetet kompetente të vendeve të tjera duhet të pranohen nga autoritetet kompetente; dhe

(ë) rastet kur dhe kushtet në të cilat mund t'u jepen përjashtime nga përdorimi i sistemit për përdoruesit e rastësishëm.

Neni 107

Mbrojtja e të dhënave

1. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale dhe përmes sistemit elektronik të informacionit bëhet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Në lidhje me përgjegjësitë e tyre për të transmetuar informacionin përkatës në sistemin elektronik të informacionit dhe përpunimin e çdo të dhëne personale që mund të rezultojë nga ky aktivitet, autoriteti kompetent që administron sistemin është autoriteti kontrollues siç përcaktohet në legjislacionin e referuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti kompetent mund të kufizojë të drejtat dhe detyrimet e përpunimit të të dhënave personale sipas nevojës për të mbrojtur interesin sipas legjislacionit të referuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 108

Siguria e të dhënave

Autoriteti kompetent që ka në administrim sistemin sigurojnë që SMIKZ të jetë në përputhje me legjislacionin për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave.

TITULLI IV (VII)

MASA DETYRUESE

KREU I

Veprimet e autoriteteve kompetente dhe penaltitetet

Neni 109

Detyrimet e përgjithshme të autoriteteve kompetente në lidhje me masat detyruese

1. Kur veprojnë në përputhje me këtë kapitull, autoritetet kompetente i japin përparësi veprimeve që duhet të ndërmerren për të eliminuar ose frenuar rreziqet për shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mirëqenien e kafshëve ose, për sa i përket OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, edhe për mjedisin.
2. Në rast dyshimi për mospërputhje, autoritetet kompetente kryejnë një hetim për të konfirmuar ose eliminuar atë dyshim.
3. Kur është e nevojshme, veprimet e ndërmarra në përputhje me pikën 2 të këtij neni përfshijnë:
 - (a) kryerjen e kontroleve zyrtare të intensifikuara mbi kafshët, mallrat dhe operatorët, për një periudhë të përshtatshme;
 - (b) ndalimin zyrtar, sipas rastit, të kafshëve dhe mallrave dhe të çdo substance ose produkti të paautorizuar.

Neni 110

Veprimet në rast të konstatimit të mospërputhshmërisë

1. Kur konstatohet mospërputhshmëri, autoritetet kompetente ndërmarrin:
 - a) çdo veprim të nevojshëm për të përcaktuar origjinën dhe masën e mospërputhjes dhe për të përcaktuar përgjegjësitë e operatorit; dhe
 - (b) masat e nevojshme për të siguruar që operatori në fjalë të korrigjojë mospërputhshmërinë dhe parandalojë ekzistencën e mëtejshme të mospërputhshmërisë.
- Kur vendosin se cilat masa të marrin, autoritetet kompetente marrin parasysh natyrën e mospërputhjes dhe të dhënat e ofruara nga operatori në lidhje me pajtueshmërinë.
2. Kur veprojnë në përputhje me pikën 1 të këtij neni, autoritetet kompetente marrin çdo masë që ata e gjykojnë të përshtatshme për të siguruar respektimin e rregullave të përmendura në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në sa vijon:
 - (a) urdhërojnë ose kryejnë trajtime për kafshët;
 - (b) urdhërojnë shkarkimin, transferimin në një mjet tjetër transporti, mbajtjen dhe kujdesin e kafshëve, periudhat e karantinës, shtyrjen e therjes së kafshëve dhe, nëse është e nevojshme, urdhërojnë që të kërkohet asistencë veterinarë;
 - (c) urdhërojnë trajtime për mallrat, ndryshimin e etiketave ose informacionit korrigjues që duhet t'u jepet konsumatorëve;

- (ç) kufizojnë ose ndalojnë vendosjen në treg, lëvizjen, hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë ose eksportin e kafshëve dhe mallrave, dhe ndalojnë kthimin e tyre në vendin e nisjes ose urdhërojnë kthimin e tyre në vendin e nisjes;
- (d) urdhërojnë operatorin të rrisë frekuencën e kontrolleve të veta;
- (dh) urdhërojnë që disa aktivitete të operatorit në fjalë t'i nënshtrohen kontrolleve zyrtare të shtuara ose sistematike;
- (e) urdhërojnë tërheqjen , largimin dhe shkatërrimin e mallrave, duke autorizuar, kur është e përshtatshme, përdorimin e mallrave për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat ato ishin përcaktuar fillimisht;
- (ë) urdhërojnë izolimin ose mbylljen, për një periudhë të përshtatshme kohore, të të gjithë ose një pjese të biznesit të operatorit në fjalë, ose të stabilimenteve, pronave ose ambienteve të tjera të tij;
- (f) urdhërojnë ndërprerjen për një periudhë të përshtatshme kohore të të gjitha ose të një pjese të aktiviteteve të operatorit në fjalë dhe, sipas rastit, të faqeve të internetit që ai operon ose përdor;
- (g) urdhërojnë pezullimin ose tërheqjen e regjistrimit ose miratimit të stabilimentit, impiantit, pronës ose mjetit të transportit përkatës, të autorizimit të një transportuesi ose të patentës së shoferit;
- (gj) urdhërojnë therjen ose vrasjen e kafshëve me kusht që kjo të jetë masa më e përshtatshme për të mbrojtur shëndetin e njerëzve si dhe shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve.

3. Autoritetet kompetente i ofrojnë operatorit në fjalë, ose përfaqësuesit të tij:

- (a) njoftimin me shkrim të vendimit të tyre në lidhje me veprimin ose masën që do të ndërmerret në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni, së bashku me arsyet e këtij vendimi; dhe
- (b) informacion mbi çdo të drejtë ankimi kundër vendimeve të tilla dhe mbi procedurën e zbatueshme dhe afatet kohore në lidhje me këtë të drejtë ankimi.

4. Të gjitha shpenzimet e bëra sipas këtij neni përballohen nga operatorët përgjegjës.

5. Në rast të lëshimit të certifikatave zyrtare të rreme ose mashtruese ose në rast të keqpërdorimit të certifikatave zyrtare, autoritetet kompetente, marrin masat e duhura, duke përfshirë:

- a) pezullimin e përkohshëm nga detyrat e tij të zyrtarit certifikues;
- b) tërheqjen e autorizimit për të nënshkruar certifikata zyrtare;
- c) çdo masë tjetër për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve të parashikuara në nenin 84 pika 2 të këtij ligji.

Neni 111 **Raportimi i shkeljeve**

1. Autoritetet kompetente kanë mekanizma efektivë për të mundësuar raportimin e shkeljeve aktuale apo të mundshme të këtij ligji.

2. Mekanizmat e përmendur në pikën 1 të këtij neni përfshijnë të paktën:

a) procedurat për marrjen e raporteve të shkeljeve dhe ndjekjen e tyre;

b) Sigurimin e mbrojtjes së duhur për personat që raportojnë një shkelje nga hakmarrja, diskriminimi ose forma të tjera të trajtimit të padrejtë; dhe

c) mbrojtjen e të dhënave personale të personit që raporton një shkelje në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU II

Masat detyruese

Neni 112

Ndërprerja serioze në sistemin e kontrollit

1. Kur autoritetet kompetente kanë prova për ndërprerjeve serioze në sistemin e kontrollit dhe një ndërprerje e tillë mund të përbëjë një rrezik të përgjithshëm për shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, mirëqenien e kafshëve ose, për sa i përket OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu për mjedisin, ose të rezultojë në një shkelje të rregullave të referuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, ato miratojnë një ose më shumë nga masat e mëposhtme, që do të zbatohen deri në eliminimin e këtij ndërprerjeje:

a) ndalimin për të vendosur në treg ose për të transportuar, lëvizur ose trajtuar në ndonjë mënyrë tjetër kafshë ose mallra të lidhura me ndërprerjen në sistemin e kontrollit;

b) kushte të veçanta për aktivitetet, kafshët ose mallrat e përmendura në shkronjën a) të kësaj pike;

c) pezullimi i funksionimit të kontrolleve zyrtare në pikat e kontrollit kufitar ose pika të tjera kontrolli që ndikohen nga ndërprerja në sistemin e kontrollit zyrtar ose tërheqjen e këtyre pikave të kontrollit kufitar ose pikave të tjera të kontrollit;

ç) masa të tjera të përshtatshme, të përkohshme, të nevojshme për të frenuar atë rrezik derisa të eliminohet ndërprerja në sistemin e kontrollit.

2. Masat e përmendura në pikën 1 të këtij neni miratohen vetëm kur autoriteti kompetent përkatës nuk ka korrigjuar situatën me kërkesë dhe brenda afatit të përshtatshëm të caktuar nga autoriteti kompetent qëndror.

3. Mbi bazën e arsyeve urgjente e thelbësore të justifikuara siç duhet, në lidhje me shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve ose, përsa i përket OMGJ-ve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, gjithashtu edhe për mbrojtjen e mjedisit, ministri me udhëzim miraton rregulla të zbatueshme menjëherë.

Neni 113

Mbrojtja e të dhënave

Legjislacioni për përpunimin e të dhënave personale zbatohet në përputhje me këtë ligj.

KREU III

KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE

Neni 114

Kundërvajtje administrative

Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme të dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë:

1. 100000 deri në 300000 lekë, në rastet kur nuk siguron akses në pajisje, mjete transporti, mjedise dhe vende të tjera nën kontrollin e operatorit të biznesit, sisteme kompjuterike, kafshë dhe mallra, dokumente dhe informacione të tjera relevante, në përputhje me kërkesat e nenit 15 pika 1 të këtij ligji;
2. 200000 deri në 500000 lekë, në rastet kur nuk mundëson zbatimin e kontrolleve zyrtare, duke përfshirë marrjen e mostrave, duke vënë në dispozicion një sasi të mjaftueshme të mostrës falas për analizë;
3. 500000 deri në 700000 lekë, në rastet kur nuk zbaton masat e përcaktuara në përputhje me nenin 110 të këtij ligji;
4. 500000 deri në 700000 lekë, në rastet kur nuk zbaton të gjitha masat e përcaktuara në përputhje me nenin 64 të këtij ligji;
5. 1000000 deri në 2000000 lekë, në rastet kur kryen aktivitetin në njësi të paregjistruar ose të pamiraturar ose nëse nuk është në listën e operatorëve sipas nenit 10 të këtij ligji.

Neni 115

Procedurat e kundërvajtjes administrative

1. Të drejtën e dhënies së masës administrative, siç është përcaktuar në nenin 114, të këtij ligji, e ka inspektori i autoriteteve kompetente, sipas fushës së përgjegjësisë.

2. Procedura për marrjen e vendimit përfundimtar për dënimin administrativ bëhet në përputhje me legjislacionin për inspektimin.
3. Ankimi lidhur me masat administrative bëhet sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin.
4. Ekzekutimi bëhet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.
5. Gjrobat arkëtohen në buxhetin e shtetit.

KREU IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 116 Dispozitë kalimtare

1. Institucionet përgjegjëse do të mbajnë funksionet për fushat e përcaktuara në nenin 2 pika 2 të këtij ligji, deri në organizimin dhe funksionimin e autoriteteve kompetente, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji.
2. Deri në funksionimin e plotë të sistemit elektronik të menaxhimit të informacionit të kontrollit zyrtar, ky informacion do të vijoj të menaxhohet në formë shkresore.

Neni 117 **Akte nënligjore në zbatim të këtij ligji**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që brenda dy vjetëve nga fillimi i efekteve të këtij ligji, për miratimin e akteve nënligjore, në zbatim të neneve 4 pika 7, 23 pika 2, 64, 74 pika 1 dhe 106.
2. Ngarkohet ministri, që brenda dy vjetëve nga fillimi i efekteve të këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 9 pika 3, 15 pika 4, 16 pikat 7 e 8, 17 pikat 2 e 3, 23 pika 2, 18 pikat 2 e 3, 19 pikat 8 e 9, 20 pikat 2 e 3, 21 pikat 2 e 3, 22 pikat 3 e 4, 24 pika 3, 25 pikat 2, 3 e 4, 28, 32 pika 6, 35 pika 1, 39, 42 pika 2, 43 pika 4, 44 pika 2, 45 pikat 2 e 3, 46, 47 pikat 4 e 5, 48 pika 4, 49 pika 1 e 2, 50, 51 pika 1, 52 pika 3 e 4, 56, 57, 58 pika 2, 60 pikat 1 e 3, 61 pika 1, 62 pikat 2, 4, e 5, 63 pika 6, 64 pika 2, 68, 69 pika 3, 72 pikat 12, 78 pika 3, 85, 87 pikat 1 e 6, 88 pika 2, 89 pikat 1 e 2, 92 pika 1, 93 pika 2, 94 pika 2, 98 pikat 1 e 3, 99 pika 2, 100 pikat 1 e 4, 101 pikat 1 e 3, 102 pika 6 dhe 112 pika 3.

Neni 118

Shfuqizimet

1. Në ligjin Nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar:
 - a) neni 16 “Mbikqyrja e sigurisë ushqimore të importit”, shfuqizohet.
 - b) Neni 17 “Kontrolli në doganë i ushqimeve të importuara”, shfuqizohet.
 - c) Neni 18 “Certifikatat e importit” shfuqizohet.

- ç) Neni 19 “Licencimi dhe regjistrimi i operatorëve, i stabilimenteve ushqimore”, pika 4 shfuqizohet.
- d) Neni 20 “Ndalimi i veprimtarisë së operatorëve të biznesit ushqimor” shfuqizohet.
- dh) Neni 26 “Kërkesat për sistemin e vetëkontrollit” pika 3 shfuqizohet.
- e) Kreu XI “Kontrolli zyrtar i ushqimeve” shfuqizohet përveç nenit 38 “Kontrolli zyrtar i ushqimeve” paragrafi i tretë.
- ë) Kreu XII “Laboratorët e autorizuar të kontrollit dhe laboratorët e referencës” shfuqizohet.
- f) Neni 51 “Importi dhe eksporti i ushqimit për kafshë” shfuqizohet përveç pikës 1.
- g) Neni 57 “Kontrolli zyrtar i ushqimit për kafshë” shfuqizohet.
- gj) Neni 58 “Marrja e mostrave për analizimin laboratorik të ushqimit për kafshë” shfuqizohet.
- h) Neni 59 “Laboratorët e autorizuar të kontrollit dhe të referencës” shfuqizohet.

Neni 119

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin nga data 1.8.2027.

K R Y E T A R I

SHTOJCA I
TRAJNIMI I STAFIT TË AUTORITETEVE KOMPETENTE

KAPITULLI I

Lënda e trajnimit të stafit që kryen kontrole zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare

1. Metodatat dhe teknikat e ndryshme të kontrollit, si inspektimi, verifikimi, skanimi, skanimi i targetuar, marrja e mostrave, analiza laboratorike, testimi dhe diagnoza.
2. Procedurat e kontrollit.
3. Rregullat e përmendura në nenin 2 pika 2.
4. Vlerësimi i mosrespektimit të rregullave të përmendura në nenin 2 pika 2.
5. Rreziqet në prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen e kafshëve dhe mallrave.
6. Faza të ndryshme të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes, dhe rreziqet e mundshme për shëndetin e njeriut, dhe kur është e përshtatshme, për shëndetin e kafshëve dhe bimëve, për mirëqenien e kafshëve dhe për mjedisin.
7. Vlerësimi i zbatimit të procedurave HACCP dhe praktikave të mira bujqësore.
8. Sistemet e menaxhimit, si programet e sigurimit të cilësisë që menaxhohen nga operatorët dhe vlerësimi i tyre sa i përket kërkesave të rregullave të përmendura në nenin 2 pika 2.
9. Sistemet zyrtare të certifikimit.
10. Masa emergjente për rastet e jashtëzakonshme, përfshirë komunikimin midis autoriteteve kompetente.
11. Procedurat ligjore dhe pasojat e kontroleve zyrtare.
12. Shqyrtimi i materialeve të shkruara, dokumentacionit dhe regjistrave të tjerë, përfshirë ato që lidhen me testimet krahasuese ndër-laboratorike, akreditimin dhe vlerësimin e rrezikut, që mund të jenë relevante për vlerësimin e respektimit të rregullave të përmendura në nenin 2 pika 2, kjo mund të përfshijë edhe aspektet financiare dhe tregtare.
13. Procedurat e kontrollit dhe kërkesat për hyrjen në Republikën e Shqipërisë të kafshëve dhe mallrave që vijnë nga vende të tjera.
14. Çdo fushë tjetër e nevojshme për të siguruar që kontrolllet zyrtare të kryhen në përputhje me këtë ligj.

KAPITULLI II

Fushat për procedurat e kontrollit

1. Organizimi i autoriteteve kompetente dhe marrëdhënia midis autoriteteve kompetente qendrore dhe autoriteteve të cilave u kanë deleguar detyra për kryerjen e kontrolleve zyrtare ose aktiviteteve të tjera zyrtare.
2. Marrëdhënia midis autoriteteve kompetente dhe trupave të deleguara ose personave fizikë, të cilëve u kanë deleguar detyra lidhur me kontrollet zyrtare ose aktivitetet e tjera zyrtare.
3. Një deklaratë mbi objektivat që duhet të arrihen.
4. Detyrat, përgjegjësitë dhe obligimet e stafit.
5. Procedurat e marrjes së mostrave, metodat dhe teknikat e kontrollit, përfshirë analizat laboratorike, testimet dhe diagnozat, interpretimin e rezultateve dhe vendimet e pasuara.
6. Programet e skanimit dhe skanimit të targetuar.
7. Ndihma e ndërsjellë në rast se kontrollet zyrtare kërkojnë veprim nga më shumë se një autoritet kompetent.
8. Veprimet që duhet të ndërmerren pas kontrolleve zyrtare.
9. Bashkëpunimi me shërbime dhe departamente të tjera që mund të kenë përgjegjësi relevante ose me operatorët.
10. Verifikimi i përshtatshmërisë së metodave të marrjes së mostrave dhe të analizave laboratorike, testimeve dhe diagnozave.
11. Çdo aktivitet tjetër ose informacion i nevojshëm për funksionimin efektiv të kontrolleve zyrtare.

SHTOJCA II

KARAKTERIZIMI I METODAVE TË ANALIZËS

1. Metodatat e analizës dhe rezultatet e matjeve duhet të karakterizohen sipas kritereve të mëposhtme:
 - (a) saktësia (vërtetësia dhe precizioni),
 - (b) zbatueshmëria (matrica dhe diapazoni i përqendrimit),
 - (c) kufiri i zbulimit,
 - (d) kufiri i matjes,
 - (e) precizioni,
 - (f) ripërsëritshmëria,
 - (g) riprodhueshmëria,
 - (h) rikuperimi,
 - (i) selektiviteti,
 - (j) ndjeshmëria,
 - (k) lineariteti,
 - (l) pasiguria e matjes,
 - (m) kritere të tjera që mund të zgjidhen sipas nevojës.
2. Vlerat e precizionit të përmendura në pikën merren ose nga një provë bashkëpunuese e kryer në përputhje me një protokoll ndërkombëtar të njohur për provat bashkëpunuese (p.sh. ISO 5725 “Saktësia (vërtetësia dhe precizioni) e metodave dhe rezultateve të matjes”), ose, në rast se janë përcaktuar kriteret e performancës për metodatat analitike, bazohen në teste të përputhshmërisë me kriteret. Vlerat e ripërsëritshmërisë dhe riprodhueshmërisë shprehen në një formë të njohur ndërkombëtarisht (p.sh. intervalet e besueshmërisë 95 % sipas ISO 5725 “Saktësia (vërtetësia dhe precizioni) e metodave dhe rezultateve të matjes”). Rezultatet nga prova bashkëpunuese publikohen ose janë të disponueshme lirshëm.
3. Metodatat e analizës që zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme për grupe të ndryshme mallrash duhet të preferohen mbi metodatat që zbatohen vetëm për mallra individuale.
4. Në situata ku metodatat e analizës mund të vërtetohen vetëm brenda një laboratorit të vetëm, këto metoda duhet të vërtetohen në përputhje me protokollet ose udhëzimet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht ose, kur janë përcaktuar kriteret e performancës për metodatat analitike, të bazohen në teste për përputhshmërinë me këto kritere.
5. Metodatat e analizës të miratuara sipas këtij ligji përpunohen në formatin standard për metodatat e analizës të rekomanduar nga ISO.